

BIBLIOTEKA  
SHËTETIT

814-32

291

PETRAQ ZOTO

# KUMBIMI



I NJE  
KRISME

TREGIME

814-32

291

PETRAQ ZOTO

# KUMBIMI I NJË KRISME

Tregime



SHËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NË PRANVERËN E HERSHME

Vangjo Leli u gdhi i sëmurë. Balli i digjej zjarr, kurrizin ia përshkonin mornica të ftohta. Hera-herës dalldisej në kllapi e atëherë i bëhej se e rrëmbenin valë të trubullta e të furishme, por, për çudi, zemrën e ndiente të qetë. Pastaj, në vend që ta përplasnin diku, siç kishin marrë rrokullimën, dallgët zhurmëmëdha e përkundnin sikur donin ta merrnin me të mirë. Papritur uji kthjellohej e valëzat kaltëroshe pllaquriteshin pas këmbëve të tij.

Tërë mëngjesin po luhatej në përfytyrime të mjegullta e aq të ndryshme që këmbeshin aty për aty. Në një çast qartësie dëgjoi një çuçurisje pranë vatrës.

«Ku e kam dëgjuar këtë zë? I kujt është ky zë?» përpiqej ta gjente me mend pa i hapur sytë. Rrinte ashtu si në gjumë, se nuk ia kishte qejfi të tërhiqte vëmendjen e biseduesve, meqenëse provonte bezdi të madhe tek fliste nga pozitat e të sëmurit që të gjithë e shohin si fëmijë a si të rëgjuar, gjë që është edhe më keq.

I zuri veshi se zëri i njohur fliste pikërisht për të dhe kërkëria e ndihmoi të kapte tërë sa thuheshin.

— Po djali ç'paska kështu? — pyeti zëri.

— Sonte s'fjeti tërë natën e natës. Duket se ka marrë një të ftohtë të mirë — u përgjigj babai i Vangjos.

— Ç'të bëjnë. Gjithë ditë kala qafë çupat e botës nëpër lumë!

— Si the?

— S'e ditke, a? E kam parë vetë xhesa herë. I kapërcën çupat me kurriz në lumin e madh.

— Pizevengu!

— Djalurçinë hesapi, i zien gjaku dhe, ku je, o lumë!

— Pizevengu!

Një heshtje e shkurtër. Dëgjohej shkoqur tringëllima e tespiheve prej qelibari të Ganos, zërin e të cilit tanimë Vangjoja e kishte përcaktuar.

— Djali s'ka faj, Loni. Këta po e prishin rininë, e sheh ti apo jo. U japin të drejta, i lënë të harbojnë poshtë e përpjetë sa të duan e si të duan dhe kjo po dihet përse...

— Hm!...

— U bëhet vonë atyre! Ti e di si e ke rritur. Ja, merr një sëmundje kësisoj dhe të rruat pastaj... Po do zoti e shërohet shpejt.

«Si e vërtit, qeni!» tha me vete Vangjoja shumë i fyer që i përdhosej ai përfytyrim i lidhur me ndjenja të ngrohta e të ëmbla...

— Vangjo, shelgu s'qenka, do ta ketë marrë lumi — tha Rita. Shelgu që bënte punën e urës, s'ishte më aty. Uji që i pastër e aq i tejdukshëm, saqë fiçorët në shtratin e lumit ngjanin me ca mozaikë plot reflektime të buta, që krijonte valëzimi i ujit në sipërfaqe.

Vangjoja brodhi sytë tatëpjetë rrjedhës së lumit

dhe, si u bind që aty rrotull nuk kishte asnjë mënyrë tjetër kalimi, hoqi opingat e çorapet e i përveshi pantallonat deri në gju. Rita ndoqi shembullin e tij. Me gishtat e ngrirë nga të ftohtët mundohej më kot të zgjidhte këpucët me qafa. Vangjos iu dhims e tha si me shaka:

— Hajde të të marr në kurriz kalakic!

— Vërtet?... S'e ke keq!

Ai nuk e priste këtë pranim, ndaj dhe ia kishte thënë me shaka. Pak më vonë, kur çapitej në ujën brisk të ftohtë, ndjeu t'i rrihte zemra me forcë. Valëzat si hithra ia përcëllonin këmbët. Dy-tri kaçurrela të butë e një frymëmarrje të ngrohtë i ndiente në qafë si një fllad përkëdhelës. Çapitej ngadalë, shumë i vëmendshëm. Rita i tendoste këmbët anash e përpigjej ta mbante frymën pezull; kështu i dukej se bëhej më e lehtë.

Ja bregu. Vangjoja u kthye me shpinë nga bregu që vajza të kërcente. Ajo kërceu, por s'e mbajti dot ekuilibrin e u kap me duar pas qafës së tij. Të hutuar u panë sy ndër sy. Vajza qeshi e kërkoi të falur. Ai u ul e rrekej të fshinte këmbët e skuqura me shami, por ajo u qull menjëherë. Gati në mënyrë të pavetëdijshme Rita hoqi shallin e ia zgjati atij.

— Fshiji me këtë.

— Je në vete?

— Fshiji. Tani u nxeha e s'ka ç'më duhet. Le që...

Një psherëtimë e lehtë e të atit ia largoi përftyrimin e këndshëm. Dy burrat që tymosnin duhan pranë vatrës, e kishin ndërruar bisedën.

S'e dije ti? Dje e mësova edhe unë. Kështu, o, posi. E dëndën brenda të gjorin. Paratë, o shpirtin. «S'kam, ato që kisha jua dhashë», thoshte. Po kush ia vinte veshin se! Paratë, o shpirtin! Për të pasur,

ka, është i krimbur në verdhushka ai, po s'i rrëfen. Fundi i fundit përse t'i rrëfejë? Borxhin s'ua ka, de!

— Jo, more! Demek kështu...

— Ku të pyesin këta, ore! Të ka rënë bretku gjer e ke vënë atë çikë mall e gjë, ke harxhuar qimet e kokës, e sheh ti apo jo, po po një t'iu shkrepur ndonjërit dhe, le që malli të shkon xhaba, për dhjamë qeni, po pëson edhe dreqin. Në paç gjë, Loni, ua bëj dermanin, murosi, e sheh ti apo jo...

— S'kam nga ato unë.

— Ti e di. Unë, si mik, të dua të mirën, pa të them.

— Faleminderit, po...

— Unë për veten time, or mik, si lepuri rri, natë a ditë qoftë. A, në të gënjen mendja me këtë beribatin ty...

— Ama, llaf!

— S'u zihet besë këtyre, qena që hanë të zotin këta. Trubullojnë ujin këta. Dhe e trubullojnë atje ku është i cekët që të duket më i thellë. E sheh ti apo jo!

Një rufisje e fortë. Tespihet venin e vinin.

Vangjo Leli rrinte i ngrehur. Bisedë me interes kjo dhe deshi të mos i shpëtonte asnjë fjalë. Ia cingëriste nervat ai zakoni i pështirë i Ganos që, kur vinte fjala për ndonjë gjë, e cila kishte të bënte me interesin e tij, në çdo pauzë fërshëllente nëpër dhembë sikur rufiste kafenë.

Vangjon s'po e mbante vendi. I bëhej se në dhomë kishte diçka të ndyrë e të qelbur që kutërbonte. Ia shtonte inatin edhe i ati. Përse ia zgjatte këtij masakrai? Nuk e njihte vallë? Apo edhe ai...

Ky qe vetëm një dyshim i vogël, të cilin ai po e ndiqte zemërdredhur.

— Epo, luftë është kjo — tha papritur i ati.

— Po... ti e ke mirë; lufta, e shikon ti apo jo, s'ka mbaruar akoma — e pasoi Ganoja. — Ama dëgjo këtu, kur vjen lumi, vala e parë rrëmben ç'gjen përpara. Më tej, kush ka mend, di edhe t'i ruhet.

— Lufta si luftë.

Vangjo Lelin sikur e kafshoi diçka në zemër. Nuk e kishte kapërcyer dot hendekun në kohën e luftës, nuk kishte dalë partizan. I ati që shkaktari kryesor dhe ai i kishte vënë një pikëpyetje dhe mëria e mbante disi larg tij.

Kur që bërë gati të shkonte në mal, i ati i ishte afruar i hakërruar:

— Ç'ke ndër mend të bësh ti, more?

— Hiç, ja...

— Ç'është kjo «Hiç, ja»? Po tët ëmë pse e ke bërë të qajë?

— Unë do të vete partizan!

— Bre, bre!

— Do të bëhem partizan, thashë!

Pohimi që i prerë e i ati aty për aty e kishte ndërruar taktikën.

— Dëgjo, bir, s'je bërë për partizan ti. Si të rritesh edhe ca, po, mund të dalësh.

— S'qenkam bërë! Po Gaqi me Tirkën?

— U mori koka erë atyre. Ç'varesh nga ata ti? Ata mund të hidhen në një pellg me ujë, do të hidhesh ti? Pastaj ata, mor djalë, s'kanë me nder as brekë... Ata ku është t'i veshin e t'i ushqejnë badiava... Kurse ne xheç kemi, edhe për vete, edhe për partizanët. Edhe ne i ndihmojmë... Po ti, ti je i vogël!...

Nuk që e mundur ta kujtonte këtë e të mos rrëqethej nga inati. Që s'e kishte lënë i ati, kjo që një

pengesë që s'e justifikonte aspak. As që kishte qenë i vogël... Dhe tani, në punët e terrenit, për të cilat ish-partizanët thoshin vetë se nuk qenë më pak të lehta se lufta në mal, ai ishte dhënë i tëri me mish e me shpirt, s'e kursente veten e s'ndiente të lodhur.

Biseda pranë vatrës që ndërruar rishtazi. Ajo po vërtitej në strumbullarin e saj. Se çdo bidesë e ka një strumbullar.

— Kështu po. Robtohu ti, xhan i vëllait, sfilitu natë e ditë për atë mall e gjë, papo vjen një djalurçinë si po ky karafili yt dhe...

«Këtu e paske, skile! He, djalurçinë, thotë. Se nuk të ndriti e s'ka për të të ndritur kurrë më!» tha me vete Vangjo Leli.

...Atë ditë kur shkonte me Ritën në fshatin përtej lumit, që drekëherë. Bari sapo kishte mugulluar anës së mezhdave. Tek-tuk verdhonte ndonjë agulice. Një fshatar kishte nxjerrë dhentë në një kodër dhe, ndërsa ato çepkatnin fijet e porsambira të barit, apo ndonjë mbeturinë të thatë, ai këndonte. Dy të rinjtë baritnin pranë e pranë. Djaloshit i kishte ardhur gjuha e jepte e merrte për t'i bërë të qartë asaj se si duhej vepruar për detyrën që u kishin ngarkuar. Mirë do të që të ishin të dy në një vend, por kjo varez nga tjetërkush. Ecnin e bisedonin e s'e vunë re që kishin arritur në fshat.

— Vangjo Leli e Rita! Mama, Vangjo Leli e Rita!  
— thirrën të gëzuar dy fëmijë.

Një grua doli te pragu i derës.

— Hyni e merrni një zjarr. Pranvera erdhi, po akoma është ftohtë e të than thëllimi. Fëmijët tani, siç e shihni, ju njohin e përgjërohen për ju.

Të rinjtë s'e bënë të gjatë. Në dhomë gjetën ngrohtësi e gëzim, po varfëria nxirrte krye kudo:



Kutërbonte erë armeje e preshi, veshjet e fëmijëve  
arnë mbi arnë.

— Të lirë jemi, zotër të vetes jemi. Zemrën e  
kemi llagar e të ngrohtë, trurin të freskët e krahët të  
fortë. Kur i ke këto, të tjerat nuk vonojnë. Dhe ne  
do t'i sigurojmë e do t'i kemi me të tepërt — tha  
Vangjo Leli sikur fliste në mbledhje.

— Këto hëpërhtë i kanë ata që i kishin — tha  
gruaja.

— Do t'ua marrim.

— Po t'ua gjejmë e po të na i lënë. Se ata dinë  
edhe të shtiren, edhe të fshehin. Ec e ia gjej këmbët  
Ganos, llafi që vjen.

— Ganos?!

— E, e, si të duket ai, s'ta mbush syrin? Finok i  
madh ai lumëzi. Hiqet i këputur më keq se ne. Thotë  
se e shkatërroi lufta. «Ne, që xheç kishim, e patëm  
më pisk. Ecë e jakë partizanët, pa edhe ata... të tjerët.  
Nxir nga shtëpia e mos fut asgjë, domosdo që bëhesh  
grijë.» Kështu thotë.

— Dhe s'ka, thua ti?

— Ai?! E po mirë!

Djalin s'e nxinte vendi e u ngrit. Ashtu bëri  
edhe shoqja e tij. Deri diku ecën në heshtje, secili  
duke u menduar.

— Grua e varfër, po sa e mençur e sa e mirë  
— tha Rita. — Si të mos përpiqesh për njerëz të  
tillë, Vangjo! Nuk është e mundur të kursehesh,  
shpirtin të japësh, është pak. Është kërkesë e natyr-  
shme, e kërkon koha që ne të bëjmë çmos për ta.

Djaloshi ngazëlleu. Kënaqej sa s'bëhej kur dë-  
gjonte fjalë prej revolucionareje në gojën e saj.

Më tej u ndanë. Kishin vajtur në atë fshat me  
një detyrë të posaçme: Në tërë rrethin bëhej aksion

për t'ua marrë drithin e tepërt të pasurve. Vangjo Leli ishte caktuar te Ganiu, Rita te një tjetër. Vangjoja e njihte këtë Ganon. I ati kishte të shkuar me të.

Aksioni që pregatitur me kujdes e që vendosur që të kryhej kudo njëherësh për të mënjeluar shpërdorimet e fshehjet. Megjithatë, kur vajti Vangjo Leli te Ganiu, vuri re se ky e kishte nuhatur këtë punë.

— Ty të paska rënë llotaria, mor djalë? Po hajde, hajde, urdhëro! E sheh ti apo jo, na paskan dërguar Vangjon e xha Lonit tonë. Ne me tët atë... ja, ashtu, na janë puqur huqet. Se kemi qenë tërë jetën njerëz të punës, as të sherrit, as të ulafit. Ndjaj dhe s'ia kemi varur kokën asnjëri. E sheh ti apo jo..

Vangjoja u bëri bisht këtyre bisedave, të cilat sikur ia lidhnin duart. Kur e ftuan të ulej e të pinte një kafe a një raki, ai tha me seriozitet:

— Unë kam ardhur me punë. Dua të di sa bereqet të tepërt keni. Të më tregoni drejt, ka familje që vuajnë për bukë.

— Po tek yt atë do të vejë njeri për këtë punë? Djali e pa me inat.

— Se njësoj jemi, o djali i xha Lonit. Na dinë buall dynjaja, e sheh ti apo jo. Një takëm, or bir, janë të paasëll, kanë vuajtur e do të vuajnë ata, se qesen e kanë të vogël, oreksin të madh e punën të paktë. Këta, që the ti, kërkojnë hise edhe atje ku ty e mua s'na shkon ndër mend kurrën e kurrës. Po njeriut i dhimbset për njerinë dhe... mirë bëni edhe ju që çalltisni për ta...

Pastaj e shpuri te hambarët.

— Na sillni një pishë, moj gra! Hambarë të mëdhenj, o djali i xha Lonit, ama shkoi e vate ajo

kohë kur i mbushnim rrëcë. Lufta na gërreu, na bitisi fare. Tani bie miu e thyen kokën.

Vangjo Leli i kontrolloi me radhë hambarët. Njëri kishte përfundi ca grurë, i dyti thekër, i treti misër ca më tepër se të parët.

— Ku e keni tjetrin?

— Këta është gjithsej. Na sos a s'na sos gjer në të ri, e sheh ti apo jo. Po ndonjë teneqe me thekër e ca misër e japim edhe ne, se e di unë që ka edhe më keq. Më pas shohim e bëjmë. Qeveria s'do të na lërë të vdesim... ç'qar do të ketë nga kjo?

— Ku e keni tjetrin?

Ganiu rufiti buzët.

— O djali i xha Lonit, unë drejt po të flas, bre, e sheh ti.

— Mos m'u përdridh e mos të të shkojë mendja se mund të na hedhësh. Bie keq në hundëza, po të përpiqesh të më heqësh për hunde mua. Atë emrin e babait tim lëre mënjanë, se s'të pi ujë ky marifet! Ku e ke bereqetin tjetër? Nga ti duam 20 kv.

— Sa, sa?!

— 20 kv rrumbullak!

— Fiuuu! Me gjithë mend e ke? E sheh ti apo jo...

— E shoh! — ia preu shkurt Vangjo Leli.

— Hm... e sheh... «Ka Balashi dhjamë», i thonë kësaj. Po kur e therën...

Vangjoja s'e dëgjoi deri në fund. Iu fut punës vetë. Kërkoj nëpër qilaret, në bodrum, në plevicat e në ahuret, po as shenjë bereqeti nuk gjeti e ziente nga inati. Që Ganiu kishte fshehur, për këtë s'kishte pikë dyshimi. Kur e pa që po mundohej e s'gjente gjë, disa herë u mat të hiqte nga krahu automatikun e ta kërçenonte haptazi. Me këtë mendim në kokë u ndal në trem e ia nguli sytë një sërë me dru që arrinte gjer

në tavan. Sëra zinte më tepër se gjysmën e tremjit të madh e sapo qe nisur.

— Gratë i duan tërë gjërat për kollaj e i vumë këtu drutë që të mos u përcëllohet surrati nga të ftohtët duke dalë jashtë...

Vangjo Leli e shikoi ngultazi në sy. Ganiu iu vodh vështrimin të tij shpues. Qerpikët i fërgëlluan e mezi e mbajti një tjetër rufisje. I riu dyshoi. Përse gjithë ata dru në trem? Që të mos u përcëllohej hunda grave? Po të qe ashtu, drutë duhej të qenë harxhuar...

Dyshimi i rritej sa më tepër e mendonte dredhinë. Kur zuri t'i hiqte kopaçet me rrëmbim, Ganiu i shtoi lajkat e, si e pa që asgjë nuk e shpëtonte, belbëzoi:

— Epo, atje... ti, or djalë, bëj si të ta thotë zemra... Ne të vjedhur s'e kemi. Atje...

Dhe kështu drithi i fshehur u zbulua.

— Kandarin! — thirri Vangjoja.

Ganiu u drodh.

— Kandarin, thashë!

Atë natë, i gëzuar që e kishte kryer me sukses detyrën, që kishte triumfuar mbi dredhitë e Ganiut, nuk pyeti as për shiun e ftohtë, as për errësirën e natës. Në shtëpinë e Ganiut nuk mund të rrinte kurrësesi. Shtëpitë e tjera të fshatit kishin rënë në heshtje, edhe ajo ku kishte vajtur Rita.

«Ajo do të ketë mbaruar më parë e diku ka vajtur për të kaluar natën. Mua më vonoi shumë ai skilja i dreqit! Në mëngjes duhet t'i vij prapë.»

E kapërceu përsëri lumin e shkoi në fshatin e tij. Nuk e merrte dot me mend se të nesërmen do të sëmurej kaq papritur.

... Biseda pranë vatrës mbështillej gjithë më tepër.

— Bëra çmos, o mik, po s'm'u nda e s'm'u nda. Ma bëri xhumbë e, të qe ndonjë tjetër, jo yt bir, për emër të zotit do të bëja të madhen. Tashti në dorën tënde.

— Ç'të të bëj unë?

— Llaf është ky, o Loni? Ç'të të bëj, thotë! T'ia mbushësh mendjen që t'i vërë kapak sa s'është vonë.

— Si ia mbushkam mendjen?

— Se është e përpjetë, e sheh ti apo jo, pa ndryshe... Prandaj u ngrita e erdha te ti... Ta dish që nuk prishemi, e mira me të mirë shpërblehet.

— Hm...

— Është a s'është yt bir, xhanëm?

Heshtje e nderë. Njëri me frymëmarrje të shpeshtuar nga ato që po i thuheshin kaq hapur, tjetri i shqetësuar, po i përmbajtur. Pas pak Ganiu shtoi qetë-qetë:

— Më dëgjo këtu, Loni. Të ishte puna veç për bereqetin, copë të bëhej, po, kur të qepen këta, e sheh ti apo jo, të vënë krrusmën.

Loni ngriti supet.

— Thuaji tët biri t'i vërë gunën, pa e di vetë unë... Bëhen hovarda me mallin e botës, kopukët!

— Një takëm s'kanë asnjë kafshatë bukë.

— Si, ore, si?

— Ka njerëz që mezi mbajnë frymën, thashë. Unë kujtoja yërtet se im bir ishte një kopuk që e shkante kohën kot së koti si zorzop, po ai u paska marrë anën fukarenjve e çalltis për ta...

— Yt bir? As ai vetë nuk e di kujt ia ka marrë anën. I do vënë kufiri te thana atij. Në e lënç kështu, azat, Loni, do ta humbasësh djalën e do të humbasësh

edhe vetë me gjithsej. Do të kesh kokëçarje, Loni, se yt bir... e sheh ti apo jo, bën punë me zarar ky karafil. Po nesër s'të pyet njeri se s'e urdhëroke dot e askush s'ka për të zënë besë se ai bën pa pëlqimin tënd. Djemtë i hanë mollçinat, pleqve u mpihen dhëmbët.

Loni merrte frymë gjithë më me zor. Tjetri pëshpëriti:

— Po hapen shumë këta, po i shtojnë zullumet. Kur miza e dheut lëshon krahë, atëherë i vjen ngordhja.

Froni ku rrinte babai i Vangjos kërciti.

— A, a! — ia bëri Loni me një zë që s'i ngjiste aspak zërit të tij zakonisht të qetë.

— Edhe ti!... Po më shtiresh si shenjt tashti!

— A, a! — përsëriti Loni.

Një rufisje tjetër e nxituar. Mbase Ganiu po bëhej gati ta vërtiste disi ndryshe për ta mbuluar atë mendim shumë aqik, që shprehu; tani sikur po habitet që e kishte thënë atë fjalë, po shtirej edhe i habitur me kundërshtimin e tjetrit.

Vangjoja e flaku tutje velenxën e kërceu drejt më këmbë. Aty në mur, mbi kokë e mbante automatikun. E rrëmbeu e ia drejtoi Ganiu.

— Ngordhja neve? Kështu? Ty po, reaksionar i fëlliqur!

Loni u hodh i trembur.

— Sëmundja, Loni... Mos ia vër re... e sheh ti apo jo. Djalë... hiqe atë... këtë, hiqe... s'bëhen shaka të këtilla...

I kishte vënë duart përpara fytyrës sikur të donte të mbrohej me to. Vangjos se pse i ranë në sy gishtërinjtë e tij të zverdhur nga tymi i duhanit.

Përmes tyre i pa fytyrën e llahtaritur. Ganiu shikon-  
te herë automatikun e herë djaloshin e dridhej.

— Baba, nuk jam në ethe. Mos i dëgjo dërdë-  
llitjet e këtij qelbaniku. Si guxon ti, si guxon të vish  
të vjellësh vrer në shtëpinë tonë? Shporru menjë-  
herë e mos e kapërce më këtë prag!

Edhe i ati bëri shenjë me dorë e me kokë si t'i  
thoshte «tyt». Praptazi, gjithë duke u dredhur, Ganiu  
s'pa nga iku. Vangjoja mori frymë i lehtësuar.

— Ti a e njohe, të paktën? A sheh qartë tani?  
— i tha t'et.

Sytë e hutuar të Lonit u njomën e u bënë të gja-  
llë e të ndritshëm. Ata sy Vangjo Lelit iu dukën si  
ato pemët që çelin vonë, po përnjëherësh, kur pran-  
vera sheshohet këmbëkryq.

Në oborr pikonin strehët. Shkrinin vatrat e fun-  
dit të dëborës.

## DJALË NËNE

Në të perënduar të diellit u kthjem në shtëpi. Nëna hyri brenda, unë ndenja në oborr. Dielli i madh e i kuq po i afrohej grykës së malit. Sa më shumë i afrohej tokës, aq më i madh e më i kuq bëhej. Gryka u ndez me një të purpurt verbues sikur dielli të kishte vendosur ta shkrinte para se të takohej me të. Pastaj rruzulli i kuq u fsheh ngadalë si me përtesë pas një bregoreje e purpuri iu vërvit qiellit.

Më ngelën sytë në atë vend. Çuditesha me vete se si dielli gjithë ditën e ditës na shihte që lart duke na dërguar dritë e ngrohtësi e pastaj ulej e zhdukej ngadalë prapa malit sikur të qe lodhur e donte të pushonte. Ç'që kjo punë kështu? Do të më pëlqente që ai të rrinte vazhdimisht lart e të mos ia linte kurrë radhën natës së errët.

Mbështetur në trinën e gardhit papritur vura re se kishte arritur nata e padëshiruar. Shtëpitë, rruga, mali u zhytën në errësirë e s'pipëtinin fare. Çatia e konturet e shtëpisë gjithashtu. Po të mos qe ajo drita drithëruese e kandilit, e tërë shtëpia jonë do të humbiste në atë padukësi aspak të këndshme. Lart në qiell disa yje xixëllonin sa për të thënë. Në detin



e madh të errësirës ata më dukeshin shumë të guximshëm.

Nëna më dha për darkë nja dy piperka të pjekura në zjarr dhe një domate. Domatja ishte e madhe, e kuqe, ta hante syri. E preva më katërsh dhe e hëngru me shumë shije. Edhe piperkat më shijuan. Nëna më shihte në sy e në gojë e më nxiste të haja edhe ca. Ajo kënaqej së tepërmi kur unë haja shumë, po këtë radhë mua më hahej vërtet dhe s'qe fjala për t'i bërë qejfin. Pa mbaruar akoma së ngrëni, m'u rënduan qepallat.

— Fli, bir. U lodhe sot, djali i nënës. Fli, se edhe nesër do të ngrihemi shpejt — tha.

Atë ditë të dy me nënën kishim korrur për një fshatar të pasur. Ishim pajtuar të punonim tek ai tërë javën.


Nëna m'i lidhi me leckë të pastra gishtrinjtë që i kisha prerë me drapër e më tha edhe një herë të bija për të fjetur. Unë po kotesha në fronin e vogël. Ajo e ngriti sofrën e më kapi për dore si fëmijë a thua ashtu do të më shpinte në shtrat. Dora tjetër e saj u mbështet në kokën time e atje mbeti një çast.

— Të janë bërë leshrat kokorridhe. Ca nga pluhuri, ca nga djersa. Si të mbarojmë së korruri, do të ta laj kokën me finjë.

Leshrat e mia kishin edhe çekllasa gruri e rrodhe. Ajo po m'i hiqte një nga një e mua gjumi më bëhej më i ëmbël. Befas u dëgjuan ca krisma. Unë hapa sytë i trembur, nëna më shtrëngoi pas vetes e u ndeh për të dëgjuar më mirë. Krismat i thëthiu errësira. Qetësia që erdhi pas tyre qe më e ftohtë, më ndrydhëse.

— Ç'qenë ato krisma, nënë?

— Pa ç'qenë! Kohë krismath është.



U ngrita me përtesë, hoqa pantallonat e i vara në një gozhdë prapa derës së vjetër, dikur lyer me një bojë të kuqërremtë. Nëna nxori nga musandra një batanije të kojtur, shtroi me dorë jastëkun me lëpushka dhe më mbuloi.

Në çast fjeta sërish. Po, qe një gjumë i lehtë e i ëmbël, gjumë disi i çuditshëm. Ndihesha, si të thash, as fjetur, as zgjuar. Nëna se me çfarë merrej. Herë kërciste dera, herë zhurmonte një lugë që trazonte në kusi, herë diçka tjetër. Këto zhurma të vogla shtëpie e lezetonin gjumin tim. Më bëhej se e shihja luhatjen e flakës së kandilit e të hijes së nënës që vej e vinte nëpër dhomë. Hija e saj zmadhohej e zvogëlohej në muret e dhomës. Ndonjëherë, duke marrë përmasa të stërmëdha, koka i arrinte në trarët e nxirë të çatisë e atje humbiste sikur e rrëmbente errësira e natës që përgjonte gjithandej.

Drita u shua e në dhomë u dynd menjëherë errësira. Ndjeva hapat e nënës që po vinte në minder. Ajo u shtri pranë meje, pasi murmuriti më parë një lutje për shëndetin e të mirën time. Ndjeva dorën e saj të ashpër që ma fërkoj butë kokën e m'i ledhatoi lehtë faqet, ballin, sytë.

— M'u rrite, bir. Burrë u bëre, pëllumbi i nënës!  
— pëshpëriti e psherëtiu.

E dija ç'deshën të thoshin ato fjalë, përkëdhelitë, psherëtimat. Në sy ajo nuk më thoshte më pëllumb, se e kishte vënë re që kjo s'më pëlqente. Tanimë unë isha rritur, pesëmbëdhjetë vjet nuk janë pak, po për të, sigurisht, pëllumb do të mbetesha tërë jetën. I vogël, i brishtë, i ëmbël... Ajo ra copë për të më rritur. Prej vitesh e shihja, e kuptoja ç'i duhej të bënte a sa vuante për të mbajtur frymën e për të më rritur mua. Babai kishte vdekur. Unë s'e mbaja mend

fare. Kur e pyesja për të, nëna më përgjigjej shkurt:  
«Aq e kishte të thënë!» ose: «Ashtu e kishte të shkruar!»

Por unë e dija se ajo vetë nuk pajtohej me këtë. Në përkëdhelitë e saj, në shikimet e saj, në përkujdesjet e saj ishte edhe babai. Ajo rronte për mua, gëzimi e jeta e saj isha unë. Edhe këtë e dija. E kisha vënë re që s'vinte gjë në gojë kur nuk mjaftonte për të dy. Kisha vënë re kaq gjëra të tjera, të vogla e të mëdha, e isha i bindur se drithërohej për mua. Dita-ditës kurrizi i hidhej shportë, mbledhej e po bëhej grusht, po kurrë s'ankohej. Vetëm natën, kur s'e kontrollonte veten, rënkonte shpesh.

I dija këto, prandaj s'më bënte zemra t'ia kundërshtoja përkëdhelitë që tanimë më fyenin, se isha rritur e s'më kishin hije më.

Befas dora e nënës u ndal si e trembur. Ajo mbajti frymën.

— Nënë! — erdhi një zë i mbytur që jashtë.

Nëna u ngrit shesh e u ndeh edhe më.

— Nënë!

Ajo u kthye nga unë rrëmbimthi. Pastaj e largoi batanijen e vajti te dritarja.

— Nënë!

Zëri që jashtë dëgjohej më mirë tani. Ishte i ulët, i dhimbshëm, po kishte një shqiptim të natyrshëm. Nëna e hapi derën. Dikush zvaritej me mundim e rënkonte:

— Jam partizan, nënë, mos ki frikë.

Këto fjalë u shqiptuan po aq ngadalë e butë sa edhe «nënë». Më doli gjumi krejt. M'u kujtuan krismat e u hodha në këmbë. Nga dëra e hapur feksnin nja dy yje xixëlluese.

— Jam plagosur, nënë!

— Të keqen nëna!

U rrëqetha nga të folurit e të dyve. Vrapova pas nënës dhe e ndihmuam partizanin e plagosur të futej brenda. Nëna mbylli derën e shpejtoi të ndizte kandilin.

— Ata që mund të vijnë s'janë tanët.

Nëna e kuptoi e i vuri batanijen dritares. Në dritën e kandilit secili shikoi për hesap të vet, unë e nëna të porsaardhurin, ai ne e pastaj dhomën. Me sa duket partizani mbeti i kënaqur nga hetimi i parë.

U habita kur e pashë në dritë partizanin e plagosur. Fytyrëhequr, me sy të thelluar e i zbetë, mbase nga lodhja e plaga. Ai ishte a s'ishte nja dy vjet më i madh se unë, por jo më i shëndetshëm. Nëna pshe-rëtiu.

E ulëm me kujdes në minder. Pantallonat i ishin skuqur afër gjurit. Duket atje e kishte marrë plumbi.

— Shtrihu! — tha nëna.

Ai u bind. Nëna ia ngriti ngadalë njëren anë të pantallonave, atë të skuqurën me gjak. Fytyra e saj e rreshkët mbeti për një çast e ngrirë, pastaj s'e përfilli as plagën që akoma kullonte, as keqardhjen e saj.

— Ah që s'kemi ca duhan, — tha nëna.

— Merr ca hi! — më urdhëroi mua.

Po më habiste. E vogël në shtat, e dobët, sa e fortë tregohej në atë çast! Ia lidhi plagën ngadalë e trashë.

— Të dhemb tani?

Ai s'foli. Mjekimi e kishte kapitur. Nëna vajti te dollapi e solli një tas me qumësht. E dija që ai tas ishte tërë ç'jepte dhia jonë dhe se nëna e ziente që në mbrëmje për të ngrënë mëngjes unë.

— Ndhimoi të ngrihet — më tha ajo. — Je i lo-

dhur e ke humbur goxha gjak, ngrehu, ha të marrësh fuqi! — i tha partizanit.

Ai u ngrit, po tha se nuk i hahej. Mbase nuk kishte fuqi të përtypej.

Atëherë pije vetëm qumështin. Të jep forcë.

Ai e dëgjoi dhe e piu me një frymë. Pastaj u shtri prapë e i mbylli sytë. Ishte i zbetë. Kujtuam se fjete e s'i folëm. Ai vërtet s'u ndje nja një gjysmë ore. Pas kësaj befas u hodh e hapi sytë. Na pa ne, zbrazti frymën, buzëqeshi. Dukej si një fëmijë i mbarë që ngrihet në mëngjes nga gjumi duke qeshur. Më erdhi mirë që ai buzëqeshi. Kjo tregonte se disi qe lehtësuar.

— Si e ke emrin? — pyeti nëna ime.

— Ridvan.

Ai ktheu kokën nga unë.

— Im bir quhet Lilo — tha nëna që e kishte kapur atë shikim.

Nëna s'ia ndante sytë. E shikonte me përgjërim.

— Ke nënë.

— Kam.

— Si të ka lënë t'i ikësh nga pëqiri!

Ai qeshi. Unë do të isha fyer, kurse ai qeshi me çiltërsi. Thashë me vete se ai qeshi ngaqë s'kishte pse të fyhej e të turpërohej që nëna ime po e trajtonte si fëmijë. Ai ishte partizan. Dëshmi më të saktë se kjo për rritjen e tij s'kishte.

Nëna e kishte zakon t'i pyeste për njerëzit e shtëpisë partizanët që bujtin te ne. Kjo qe thjesht mirësjellje, që ajo e bënte për t'ua hequr drojtjen apo të përlijte veten që qe disi ndryshe nga ato nëna, të cilat i kishin lënë djemtë e tyre të dilnin malit? Anoja nga ky dyshim. Një herë, kur qëlloi te ne një partizan i vogël, ajo, pasi e pyeti si zakonisht e pasi

mësoi se ai kishte në shtëpi vetëm nënën e një motër të vogël, u kthye nga unë e në sy sikur i lexohej një farë frike. Pastaj iu drejtua atij me këto fjalë: «Ç'në-në qenka jot ëmë, ti je fare kërthi!»

Tanimë ne ishim familjarizuar me partizanët e me qëllimin e tyre. Por, tek i shihte ashtu, të lodhur e të pangrënë, të dobësuar e shpesh me sy të skuqur nga pagjumësia e nga plagët, ajo gjithë hiqte me vete: «Ç'nëna qenkan ato!» e unë s'arrija ta kuptoja nëse i qortonte shoqet e saj, apo ua kishte zili. Një gjë e kisha pikasur qartë: Në këto raste, ajo kthehej nga unë e m'i ngulte sytë. Flakëronte një dridhmë në atë vështrim e pastaj nëna më shtrëngonte në gji.

— Ç'njerëz të tjerë ke në shtëpi, o bir?

— Plot kam — tha Ridvani. — Dy vëllezër e tri motra.

— Ti je më i vogli?

— I dyti. Një motër, Sala, është më e madhe, të tjerat nën dhjetë vjeç.

Nëna ime vuri duart në kraharor.

— Po babanë?

— E kam, e kam, veçse jo në shtëpi.

Ridvani mori frymë thellë e tundi kokën.

— Është në internim. Punonte në fabrikën e miellit e kishte lidhje me komunistët. E kapën fashistët, e burgosën dhe e internuan.

— Si ia bën jot ëmë?

— Punon. Edhe ajo, edhe Sala. Në dyert e botës, domosdo, dhe mirë s'kanë, se të këputur jemi.

— Eh! — ia bëri nëna. — Sa kohë ke në mal?

— Gjashtë muaj.

— Vete ndonjëherë?

— Kam vajtur dy herë me detyrë.

— Ç'thotë kur të sheh?

— Ç'të thotë? Më puth e qan e qesh njëherësh.

— E gjora! Dhe i bën zemra të të ndajë nga gjiri prapë.

— Zemër e ndjenja ka e dhëmbje ndien, domosdo, po dashuria për lirinë, nënë, është e madhe, e fortë. Po të dridheni ju për ne e të mos na lëshoni nga prehri, kush do të luftojë? Kësh do t'i shporrë naziballistët? Vetë ata s'shkulen që këtej.

Nëna u ngrit e se ku vajti. Unë e ndoqa me sy. Ajo s'kishte ndonjë punë dhe kot u vërtit. Me sa duket ishte prekur nga fjalët e moshatarit tim e s'duronte dot. Unë e vija re gjatë bisedës se si përqëndrohej ajo e ç'keqardhje shprehnin sytë e saj të mirë për Ridvanin, për babanë e tij, për njerëzit e hallet e tyre.

— Qan kur të përcjell?

— Jo, kur më përcjell nuk qan kurrë.

— S'qan the? S'është e mundur! S'e bën veten, thuaj, e mban në zemër dhëmbjen...

Nuk isha fare në vete. Ridvani me atë plagën mbi gju, me ata fishekët, bombat e automatikun që i vuri nën jastëk, Ridvani partizan e i plagosur, me atë të folur të mprehtë si komisar, ngrihej si një vigan para meje e mua s'më mbetej veçse t'i ulja sytë i turpëruar. Pësja e këtij përfytyrimi të gjallë ma ndrydhte zemrën. Merrja frymë me zor e rrija si i ngrirë.

Nëna u ul prapë në cep të minderit. E pa partizanin, mua, përsëri partizanin. Nuk gjenin prehje sytë e saj. Dhe kisha një zjarr e fuqi që të habiste. Askush nuk e njihnte atë më mirë se unë. Ajo mua më mbante akoma për të vogël, por unë tanimë isha në gjendje t'ia kapja edhe dridhjet më të holla të shpirtit. Shqetësimi i saj kishte të bënte me partizanin,

po kishte të bënte edhe me mua. Më pa përsëri, pastaj Ridvanin, pastaj prapë mua. Psherëtiu. Ridvani hapi sytë.

— I vogël e me tërë ato halle dhe ke marrë malet!

— Po armiqtë, nënë?

— Ti je foshnje, bir.

— Foshnje, po punë bëj njëlloj si çdo partizan i rritur!

— Ashtu, ashtu, po... eh, po nëna!...

— Nëna ime? Nënë, si shumë të tjera.

«Si shumë të tjera!»

Nëna ime lëvizi nga vendi. Sigurisht i dogji ai krahasim. Ridvani nuk tha: «Si ti», por «Si shumë të tjera».

— Kur më përcolli për herë të parë, pasi më puthi, më tha të kisha mendjen e të mos bëja budallallëqe, të mos tregohesha burracak e frikaç, por edhe të mos e vija veten në rrezik vend e pa vend, kot së koti...

Ridvani e la në mes fjalën e shikimi ëndërruesiu tret diku. Fytyra koskë e lëkurë e nënës u përskuq. Më shtrëngoi dorën; dora e saj dridhej në timen.

— Të më ikësh ti! — pëshpëriti.

Diçka po ziente në mendjen e në zemrën e saj.

«Ç'nënë!» thoshte me vete, sigurisht, me atë mënyrën e pashprehur qartë të zilisë a të qortimit. «U bëre kaq, bir. Edhe ca e do të të gjej një nuse si yll. Sa ta shoh nusen në shtëpi, sa të përkund në djep një nip, pastaj... Gjer atëherë s'të ndaj, jo, jo, s'të ndaj nga vetja!»

Nëna e kishte pikasur që unë isha afruar shumë me partizanët. Ajo i nuhatte mendimet e ndjenjat e



mia ashtu siç mund ta bëjë këtë një nënë e dhembshur, që rron veç për djalin. Pikërisht për këtë arsye edhe sillej në atë mënyrë me mua, gjithë sikur unë isha fëmijë që asnjë hap nuk e bëja dot pa mbikqyrjen e saj.

Ky qëndrim më fyente. Isha në dilemë e heshtja, megjithatë, sepse, sikurse thashë, më vinte keq për të e s'ma desh zemra t'ia prishja. Po për të fyer fyhesha. Sa më tepër shkonte koha, sa më shumë partizanë vinin në shtëpinë tonë, aq më tepër e ndieja këtë fyerje. Sidomos kur kishte midis tyre të vegjël. Nëna më dhimbsej, pra, por edhe një inat i heshtur më ziente përbrenda.

Kësaj nate shqetësimi i nënës vinte duke u shtuar. Ishin vënë në lëvizje trazirat. Më shikonte mua, partizanin, mua; më shtrëngonte fshehtas dorën e më afronte pas vetes.

Nga trajtimi si fëmijë që më bënte ajo, nuk guxoja ta shihja në sy Ridvanin. Veç kësaj trazira kisha edhe vetë dhe këto lidheshin me fjalët e tij për lutfën e lirinë.

Partizani Ridvan që u kishte dhënë shtytje këtyre trazirave tona shpirtërore, dremitte. Ne rrinim në pritje. Dikur ai lëvizti e u ngrit shesh.

— Të dhemb? — pyeti nëna.

— Jo dhe aq. Vetëm se më është mpirë krejt.

— Ç'kohë! — tha nëna.

— Ne do t'i zhbijmë ata, do t'i zhbijmë domosdo! — tha Ridvani.

— I vogël, po sa besim që paske, bir!

— E di përse luftoj, nënë. Na udhëheq e na mëson Partia e vegjëlisë. Lufta jonë është luftë e vegjëlisë, kështu si ju them unë. A mos vallë duhet

të durojmë për tërë jetën robërinë e skllavërinë, të bëjmë gjithnjë një jetë sterrë të zezë?

Sytë e tij takuan të mitë. Nuk iu mbajta dot. Ai fliste. Unë dëgjoja. Dëgjoja me admirim. Ç'i mençur! Ç'i gojës! Ç'i zoti! Kur ai më shikonte në sy, më vinte turp. Më bëhej se ai qëndronte diku lart e më shikonte ashtu sikur do të më mernte në provim. Sa më i madh së unë qe ai? Dhe qëllimi a s'ishte i njëjtë për të e për mua?... Unë duhej ta kisha sheshuar me kohë këtë dallim që na ndante e tani ai s'kishte pse të më shihte që lart.

Gjaku më hidhej me vrull. Dallgëzonte zemra e gjaku i dallgëzuar shkonte në kokë me shpejtësi e shtrëngim sikur do të mbushte një çisternë. Emocioni më pengonte frymëmarrjen.

— Fli — tha nëna. — Gjumi të çlodh e të shëron.

— Kur është në kohën e përshtatshme... — tha Ridvani.

Ai u ngrit e vari këmbët jashtë minderit.

— Mua më duhet të shkoj.

— Kështu? Jak në vetë!

— Akoma është natë. Unë munda t'ua humbja gjurmët. Në mëngjes ata vijnë e bëjnë kontroll dhe e pësoni edhe ju. Veç kësaj...

Nëna pa atë e mua e u drodh.

— Të të fshehim, djalë. S'të lë të shkosh kështu. Ti erdhe zvarë. Tani plaga t'u ftoh dhe e ke më keq. Jo, bir, hiqe atë mendje.

— Isha edhe i lodhur e i pangrënë. Tani jam më ndryshe. Po të më jepni një shkop...

— Jo, jo! — ngulmoi nëna.

— Mos më pengo, moj nënë!

— Ti je yni, unë s'di shumë, bir, por ato që the, i kuptova të tëra, të tëra. Ti më thërret «nënë», një-

Illoj si Lilua. Ç'nënë do të isha unë për ty, po të të lija në këtë ditë? Hiqe atë mendje!

— Po detyra? S'mund të rri, e tillë është detyra.

— Detyra pa u plagosur, se tashi...

Partizani tundi kokën në shenjë mohimi të prerë.

— S'mundem. Mos më pengo, nënë, mos më bëj të më vijë turp nga shokët e nga vetja!

I drejtohej asaj natyrshëm si nënës së tij. Nëna ime pa nga unë. Mos vallë edhe ajo pati përshtypjen se po i flisja unë e jo Ridvani? Ndoshta isha zverdhur në fytyrë. Duhet të kisha ndryshuar. Këtë e lexova në sytë e saj.

— Dëgjo ç'të thotë nëna...

Mua më qenkësh pjekur goja. Fola nëpër dhembë, prandaj qërova zërin e përsërita:

— Dëgjo ç'të thotë nëna, Ridvan!

Ai m'i nguli sytë zhbirues.

«Edhe ti kështu gjykoke? Po sikur të dëgjoj atë e të rri, ç'bëhet me detyrën që më kanë ngarkuar? A e di ti ç'është detyra për një partizan? Po ti... bravo të qoftë!» më bëhej se thoshte ai shikim.

— Ti s'bën të dalësh. Po punën e paske me axhele. S'dua të të turpëroj, jo, jo, s'dua! Por...

— Partizanët presin...

Nëna ia vuri dorën në ballë. Partizani i plagosur kishte të nxehtë. Ai s'mund të vinte asgjekundi. Po detyra duhej kryer, se partizanët prisnin...

Ajo mernte frymë me vështirësi e gëlltitej. Si t'ia bënte? Sigurisht që në hall. I duhej dhënë një udhë këtij problemi. Puna kishte ardhur shtrënguar. Unë tani e kisha fare të qartë.

— Do ta plotësoj unë atë detyrë — thashë prerë.

Unë akoma nuk e dija ç'detyrë kishte ai. Sidoqoftë, çfarëdo që të ishte, përderisa ai mund ta kry-

ente atë detyrë, unë pse jo? Prandaj e mora me vendosmëri atë zotim.

Ai më mati me sy. Më studjonte. Nëna shikonte herë atë e herë mua. Fjalët e mia nuk i kishin ardhur të papritura. Kjo vihej re në vështrimin e saj, në qëndrimin. Nuk u alarmua siç e prisja unë.

— Ç'duhet të bëje ti, bir? — pyeti me ankth.

— Është detyrë me rrezik tha Ridvani.

— Vetëm ti ke kokë? Më thuaj çfarë duhet të bëj!

Nëna më pa mua, atë, mua. Partizani e pikasi shikimin e saj.

— Një moshë mbase jemi, shok i dashur, por unë jam mësuar, jam rrahur në këto gjëra.

Këto fjalë më prekën thellë. U krekosa:

— Më thuaj çfarë duhet të bëj dhe do ta bëj, të betohem!

Ridvani u kthye nga nëna. Ajo u bë e tëra eshtake. E kuptova, po i vinte gur zemrës, po e bënte atë hap, të cilit i ishte druajtur kaq kohë.

— E po, jepja detyrën tënde — tha. — Edhe ai djalë nëne është!

Tani më erdhi radha mua t'ia shtrëngoja dorën. E dija mirë ç'hoqi derisa arriti t'i thoshte këto fjalë, e dija ç'sakrificë po bënte. Ridvani futi dorën në një xhep të brendshëm e nxori një copë letër.

— Është me shumë rëndësi, Lilo!

Për të parën herë gjatë gjithë mbrëmjes ai m'u drejtua me emër e mua m'u bë zemra mal, sepse kjo në një farë mënyre tregonte se ai më quante të denjë për të qenë i barabartë me të.

— Mirë, e marr vesh.

— Jepja e mos ki merak — theksoi nëna ime.

Ridvani m'i dha porosinë e parullën dhe më tre-

goi ku duhej të veja e si të veja. Më gufoi zemra nga serioziteti i detyrës së parë partizane që po më besohej.

— Ki mendjen, bir! Ridvanit i ka thënë e ëma të jetë trim, por edhe të dijë të ruhet. Këtë do çdo nënë.

U përshëndeta me të dy e vrapova jashtë në errësirën ku feksnin yjet xixëlluese. Nuk shkoja gjë tjetër ndër mend veç si ta gjeja rrugën e si ta kryeja detyrën. Ai a nuk do ta bënte këtë? E pra, do ta bëja edhe unë!

## ISUF ARAPI

Shënova këtë titull e ndër mend kam edhe kapedanin e famshëm kaçak Isuf Arapi, edhe vallen që mban këtë emër. Për këtë të shkruaj më tepër? Ka një lidhje të ngushtë midis tyre, lidhje që e krijoi një situatë e posaçme. Vallja mund të kishte edhe një emër tjetër, mbasi është më e moçme se vetë Isufi, por, pas asaj që bëri ai në trevën ku luhej kjo valle, pas asaj që bëri e ndjenjave që provonte kur për nder të tij luhej vallja në çdo fshat, pas këtyre, them, nuk mund të ngjiste tjetër emër, e tillë lidhje e shkrirje u krijua.

Ka qenë ajo kohë kur bejlorçinat mbinin si kërpudhat pas shiut. Sapo i thoshin vetes se ishin më ndryshe nga të tjerët, ata mësonin të merrnin poza kapadaiu, të harbonin mbi kuaj e të përdornin kamxhikun. Se nuk është e thënë që njeriu të rrijë pa bërë gjë, dhe, kur s'ka punë, bëhet i egër e punon prapësira, ca më tepër kur kësisoj atyre u shtohet pasuria e porsavënë.

Tërë ditën hipur mbi kuaj e me kamxhik në dorë ata i shtonin gjithnjë e më shumë zullumet. Fshatarët e krahinës ku shtrihej rrezja e veprimtimit të tyre, e cila zgjatej çdo ditë e më tepër, po hiqnin

të zitë e ullirit, si i thonë fjalës, dhe ishin në një gjendje pasigurie e tmërri për çastin që vinte pas. Zullumet e mëria kundër tyre bënëin që trima të papapur të linin shtëpi e katandi e të merrnin malet kaçakë. Të revoltuar, por edhe pa qartësinë e duhur, vritnin e pritnin zabitë Turqie e bejlerë zullumqarë, me ta edhe ndonjë tjetër, sipas kokëshkrepjes (shfryrje e mërisë dhe e revoltës spontane, shpesh edhe personale) të ndonjë kaçaku e sidomos të komandantit të tyre.

Një nga këta ka qenë Isuf Arapi. Erdhi dita që ai e ca shokë të tij i zunë bejlerët e trevës, për të cilën po flasim, e i shkuan në satër të gjithë pa përjashtim deri dhe fëmijët meshkuj të familjeve të tyre. Mëria që e madhe e ata e kryen këtë vepër pa iu dridhur aspak dora. Pas kësaj shkonin fshat më fshat. Dënimi i rreptë duhej të bëhej i ditur gjer te njeriu i fundit. Kështu rritej nami i kaçakëve, pa rritej edhe çeta vetë. Kështu vihej në vend drejtësia e ashpër, për të cilat përpiquej e luftonte Isufi.

Lajmi përhapej si vetëtimë shumë më shpejt se të vinte në fshat Isuf Arapi, duke u sjellë fshatarëve një gëzim ngjethës. Çlirimi nga bejlerët zullumqarë e shushunja që pa dyshim dëshira e tyre më e madhe, ëndrra e tyre e zjarrtë. Për të ata edhe lutje bënëin natë e ditë. Shpëtimi i pritur nga qielli u vinte tani nga shpata e kapedan Isufit. Po më tej? Kapedan i njohur që Isuf Arapi. Fama e tij kishte ardhur me kohë në këtë trevë. Flitëshin kaq gjëra të çuditshme për të. Thoshin që ishte trim i marrë, thoshin që ishte njeri tej masës i rreptë, thoshin që ishte dinak e i paafrueshëm. Prandaj fshatarët gëzoheshin për atë që kishte bërë, po ishin edhe si të trembur. A që vërtet shpëtim ai që sillte Arapi i tmershëm?

Vetë ai ç'qëndrim do të mbante ndaj fshatarëve? A do të rrinte kësaj ane me çetën e tij, apo do të ikte? Nëse po, ç'do të bëhej pas ikjes së tij?

\*  
\*   \*  
\*

Fshati i tërë, të mëdhenj e të vegjël, kishin dalë te sheshi i madh para kishës së heshtur. Veshur e ngjeshur si në ditë të kremte, këndonin e hidhnin valle. Kurrë ndonjëherë ai shesh s'kishte parë aq një-rëz njëherësh. Kërshëria kishte sjellë atje gjithë sa mund të vinin, po më tepër interesimi për të ditur nëse atë ditë merrte rrugë e sqarohej fati i tyre.

Prisnin Isuf Arapin.

Ndërsa të rinjtë përfitonin nga rasti për të dëf-ryer, të moshuarit që s'mund të rrinin gjithë kohën duke mbajtur sehir, bisedonin rreth çështjes që i shqetësonte.

— Më kot i frenojmë vetes hovet e gëzimit të çlirimit. Pse e tjerrim kaq gjatë? Pse kërkojmë të gjejmë qimen në vezë? Veg, drejtësisë s'ka asnjë qëllim këtu. Isuf Arapi për drejtësi lufton. Sa për flori, o të keqen vëllai, ai e di sa zgërbonja pylli ka mbushur me to. Pra, s'e ha malli për kacidhet tona të mjera atë!

— Ai që ka shumë, do më shumë. Ky është arra-reti i kamjes.

— E po...

Dhe kjo «e po...» qëndronte si një pikëpyetje e madhe. Për disa që pikërisht ajo që ia jepte ndjenjën e pasigurisë kësaj dite shpagimi. Mos vallë Isufi vetë do të bëhej si bejlerët e t'i vinte në zap e t'u



kërkonte taksat? Po të qe kështu, hajde t'ia dilje atij? Se as ndër mend s'e shkonte kush që të mos paguanin taksa.

Sidoqoftë, ai kishte prerë kokat e urryera të shushunjave të krahinës. Kjo ishte gjë e mirë. Po qe se do të bëhej vetë i tillë, do të gjendej një kokë-prerës edhe për të, sado i fortë të ishte. Kështu mendonte një pjesë.

Kryeplaku, më i paduruari i të gjithëve, mbështetur në bastun të lëmuar për merak, me qostekun e orës që binte në sy që tutje, ishte njëkohësisht më i trondituri. Sido që të ndodhte, vala e parë do të binte mbi të, ai do ta takonte i pari. Me mend përsëriste fjalët që do të thoshte dhe, sa më tepër i përsëriste, aq më i pasigurt ndihej.

— Duken gjë? — pyeste herë pas here djalin që me porosi të tij vrojtonte në kodër.

Mbas kaq kohe pritjeje plot ankth djali tha se po vinin e të gjithë i prenë dëfrimet e bisedat e u tendosën të shihnin. Në fillim u duk një re e vogël pluhuri. Pastaj në krye të saj spikati një shpurë kalorësish që i kishin lëshuar kuajt të ecnin sipas qejfit. Shpura kaloi urën e mori kthesën për në fshat. Tani dalloheshin qartë. Në krye vetë kapedani, Isuf Arapi i famshëm, hipur në një kalë të bardhë e të madh, i bëshëm nga trupi e me atë tallaganin e trashë e të ndritshëm hedhur supeve, me xhamadanin e qëndisur me ar e dorezat e dy kobureve që dilnin nga silahu i purpurt, me sy të zinj, zeshkan e i vrenjtur, i ngjante një zotërie të madh e të ngjallte hutim në të parë. Hijerëndë e i heshtur shkonte përmes dy rreshtave të fshatarëve që e shikonin me habi, pa zbritur nga kali. Dukej i mërzitur e sikur mezi priste sa të mbaronin këto ceremoni, që s'përkonin fare me

ndjenjat e tij të atij çasti. I shtyrë nga këto ndjenja, njëherë puliti sytë a thua e gjitha që shihte që një tallje e aq. Po kur kryeplaku i doli përpara me bukë e kripë, iu përul e i tha ato fjalët e parapregatitura, kapedani e pa të udhës të zbriste e të dëgjonte me seriozitet.

— Zoti ia shtoftë ymrin kapedanit të madh Isuf Arapi, të cilin fshati po e pret si i ka hije një trimi të pamposhtur! — tha kryeplaku.

Kapedani u miklua nga këto fjalë. Ngjatjetoi me dorën në zemër, përveshi buzën e sipërme si për të qeshur, po nuk qeshi, e tha:

— Mjerë ai që i bie më qafë popullit, të cilin e marr unë në mbrojtje!

Kryeplaku u shushat, sikur këto fjalë kapedani ia drejtoi atij, ndërsa fshatarët në përgjithësi i pritën me kënaqësi e në çast ia falën me vete atë qëndrim fodull. Me dorë në zemër e uruan dhe e ngjatjetuan edhe ata.

Pas kësaj kryeplaku, ca i trembur, i udhëhoqi në shtëpinë e tij. U shtruan në një konak të gjerë mbi shilte të buta duke i bërë nderet që i takonin një njeriu të tillë të madh e të tmerrshëm. Ngadalë po u ikte ajo habia e takimit të parë me një kapedan vërtet të habitshëm, që kishte gjithë atë madhështi, shoqërues, armë. Që ishte ca i vrenjtur e hijerëndë, që nuk po i qeshte buza, ata me mend e përligjën duke thënë se kështu, ndoshta, duhej të që një kapedan me famë.

Nga ana e tij Isuf Arapi s'e ndiente veten mirë. E bezdisnin gjithë këta njerëz, apo dhoma që e ngushtë? Mezi mbushej me frymë, por, i duruar nga natyra siç që, ai ngrysi vetullat e s'e bëri për fjalë.

Nganjëherë mbyllte sytë për një çast. Mbase do të kishte qejf të mbetej vetëm e të qetësohej.

As kryeplaku nuk po qetësohej dot. Ku dihej ç'i shkreppte në kokë këtij kokëkrisuri që i kishte zënë derën? Mbase kryeplakun e mundonte ndonjë gjë. Të paktën këtë përshtypje linte qëndrimi i tij tepër i frikshëm.

— Mos është ca si zagushi? — tha me drojtje. — Pranvera çatisi dhe bukur është edhe jashtë. Po të jetë se urdhëroni...

— Posi, posi! — tha Isuf Arapi.

Dhe dolën e zunë vend te sheshi, ku edhe fshati, edhe natyra dukeshin si jo më mirë. Isuf Arapi rrotulloi sytë mbarë e prapë. Vërtet bukur! Ca bilbilë këndonin nëpër ahet e mëdha që sillnin llaht me atë erën e tyre shushuritëse. Kapedani e shprehu kënaqësinë e vet, duke u mbushur me frymë një herë, dy. Kraharori i gjerë i ngrihej e i ulej si kacek. Po, për të folur, as foli e as qeshi.

I vunë përpara mish shqerre të pjekur në hell e pulë të zier e të skuqur me gjalpë, verë e rrush të freskët, mbajtur në tallash, djathë disa llojesh. Ai hante e pinte fare pak, gjithë në heshtje. Ishte për t'u çuditur, se, me sa dihej, kur binte në të ngrënë, ai s'dinte të ngopur. Fshatarët ia morën një kënge me të ziere, sajuar ato ditë për bëmat e tij. Isufi dëgjonte duke u mbllaçitur me përtesë.

«Këta kremtojnë e janë të gëzuar. I shpëtova nga ata makutë delenxhinj. Po pse nuk qetohem dot?» thoshte me vete.

Të gjithë e dinin si trim të marrë e si njeri që s'i dridhej qepalla në çdo situatë, që shkonte e ndëshkonte pa mëshirë atë që e kishte mbushur kupën. E njihnin si njeri pa zemër. Këtë e dinte edhe ai

vetë, paçka se bënte sikur s'i kishte rënë në sy. Vetë me vete i bluante këto mendime sa herë ia sillte rasti. Dhe një rast i tillë ishte edhe ky. Krahas kënaqësisë së përmbushjes së detyrës po provonte edhe një ndjenjë të dytë, të fshehtë, shqetësuese. Kjo ndjenjë e kishte kllapuar të tërin.

«Eh, si s'paskam zemër? Kam, ore, kam! Por... ja, ashtu, i kam vënë gur. Edhe të tjerë kam vlarë, mbase më shumë sesa duhej, mbase edhe të pafajshëm, në inat e sipër, po sikur të të dridhet dora e në i lëng ata edepsëzë? E pëson ti, e pësojnë të tjerët si ti...»

E kishte sjellë hera të bëhej kaçak e i thoshte mendja se me veprimet që bënte i kishte dalë zot së drejtës. Njeri shpirtzjarr e krahçelik, ia patën djegur shtëpinë, vlarë e syrgjynosur njerëzit e afërm, nga kjo që bërë i ashpër e i ngrysur dhe dufin e shprehte në mënyrën si ia kishin punuar atij vetë. Dhe vrulli i rrëmbimit hakmarrës përfshinte edhe ndonjë që s'e kishte hak plotësisht. Për këto raste mendohej më pas, për këto e për shpagimin në masë që i sillnin veç kënaqësi të çastit e sfili të gjata.

«Zemër, po, kam edhe unë, sikur i përgjigjej dikujt ai. Zemra ndien, mendja peshon. Po që se një gjë anon nga e drejta, zemrës i do vënë fre, se të pengon!»

Kështu mendonte e kështu bënte Isuf Arapi. Mirëpo ja, si mbaronte punë, i vinte radha zemrës, që çlirohej nga freri e gjykonte. Dhe gjykonte ashpër. Në ndeshje të ndjenjave me mendimet i lindte ai shqetësimi torturues.

Sido që i pushtuar nga këto ndjenja, megjithëse lufta përbrenda vazhdonte, Isuf Arapi mundi të kapte një ndryshim të papritur. Zhurmat u ndërprejnë.

Ngriti kokën e pa nja dhjetë gra e vajza, të gjitha njëlloj nga shtati e bukuria, që dolën në shesh e u kapën dorë për dore. Ishin veshur po ashtu, njëlloj, me xibunet e errëta, përfundi e anash me garniturë gajtani të kuq, jelekë të qëndisur me merak, të hapur në mes për t'u lënë vend gjoksoreve të bardha, të qëndisura edhe ato, shami të holla me lule në kokë e në brez, çorape vija-vija. Po njëlloj të gjitha kishin një krehje të veçantë dhe shamitë kapur me karfica diku në mesin e kokës. Pafta e zinxhirë, karfica e rruaza të verdha e ngjyrë argjendi zbukurorin këto veshje aq të hijshme edhe pa to.

Isuf Arapi i pa me radhë njëerën pas tjetrës e iu duk sikur ato ishin motra midis tyre. Ndoshta shikonte akoma trubull, i zhytur siç që në shqetësimin e vet.

Pasi u varguan në shesh, gratë ia morën një kënge e nisën të kërcenin sipas melodisë. Një çast ai i dëgjoi e i pa sikurse gjithë të tjerët. Po nuk kaluan veçse disa çaste, kur e përshkuan mornica në trup e iu bë se diçka iu shkëput nga qenia e tij. Ndjenjat e mendimet iu hoqën menjëherë, u ndeh përpara, shikonte e dëgjonte i mahnitur.

Ajo që një valle e kënduar. Këndonin ato që e hiqnin, këndonin shoqet e tjera mbledhur grumbull aty në një anë. Kënga ishte e shtruar, me ndonjë ndërprerje të vogël, në të cilën merrej sulm për të vijuar më tej. Po kështu edhe vallja. Disa hapa para, të njëtrajtshme, lëkundje e hijshme e trupit në vend mbi majat e këmbëve, përsëri përpara e pak më shpejt e në afrim të ndalesës tjetër, këmba e majtë me një ngritje elegante vinte tek e djathta, pastaj e djathta vazhdonte me një farë zvaritje të shpejtuar, ndjekur nga tjetra me po atë ritëm.

Kishte një pajtim të çuditshëm ndërmjet këngës e valles e ky pajtim shkonte më tej: Lëvizjet e këmbëve ishin në harmoni të plotë me lëkundjen valë-valë të trupit e të kokës. Asnjë përkulje, asnjë sforcim. Vallja ecte lirshëm dhe e përshkonte një lirizëm i këndshëm që të rrëmbente. Valltarja e kreut valavitte mbi kokë e anash një shami të hollë, shoqja e fundit i përgjigjej gjithë po në atë mënyrë me dorën e kundërt.

Tekstet e këngëve përziheshin. Filloi me «As tinë, more», e vijoi me të tjera. Por Isuf Arapi s'po ua vinte veshin fjalëve. Atij i kumbonte në vesh një «Tra-la-la-laa, la» ritmike herë e qetë e herë me hove të papritura. Shikonte mimikën e valltareve, lëvizjet elegante të trupit, mbajtur drejt me krenari dhe të gjitha këto u jepnin këmbëve të tyre një theksim që atij i arrinte në zemër.

Vallja ngërthente në ndjenja të kundërta të pajtuara midis tyre e Isufit i ngjante se zemra e tij plot tallaze që hapur aty në shesh e lozte atë valle mahnitëse. Qe përqëndruar i tëri në të e njerëzit shikonin herë vallen e herë kapedanin krejt të hutuar e të trembur.

— I pëlqejnë këmbët e mbushura të grave me ato çorapet lara-lara, që i bëjnë aq joshëse! — pëshpëriste ndonjëri.

— Pse gjokset jo? Pa shih një herë. Ato janë edhe më joshëse, veçanërisht për një që s'i është ngopur syri me to. Ej, kush u bë sebeb të hyjnë gratë në valle!

Po kryeplaku finok që ndiqte me vëmendje atë që ndodhte me kapedanin, shpejt e hoqi frikën se mos ai bënte ndonjë ngatërresë. Ai vinte re si i zgjeroheshin flegtrat e hundës, si i zmadhoheshin sytë e si

merrte frymë me vështirësi, me hope, ngaqë e mbannte pezull një copë herë. Fytyra e gjithçka e tij, tërë qenia e tij në atë çast jepnin shprehjen e njeriut që e ka përpirë diçka, po jo shenja epshi. Ai nuk lëvizti fare as sytë, a thua shikonte një pikë të vetme që ishte a s'ishte në lëvizjet e veçanta të valltareve të veçanta.

«Ky do të ketë ndonjë brengë të madhe që e sfilit», arriti në përfundimin kryeplaku, të cilin ajo brengë e kapedanit po e bënte të merrte frymë disi i lehtësuar se deri atëherë atij e ca të tjerëve, edhe se hanin e pinin, edhe se dukeshin të gëzuar, nuk po u ndahej ajo frika e pasigurisë për ndonjë të papritur që mund të ngjante më pas.

«Këtu duket si qengj e kaq i ndjeshëm, saqë e ka përpirë me gjithsej vallja, po ç'bluan në kokë? Tha të mos kemi frikë nga askush sa kohë që ai është kapedan i çetës, tha që këtej e tutje askush s'ka të drejtë t'i përdorë keq e sipas qejfit fshatarët... Ç'janë këto?... Por... mos e bëjë si ai që e shpëtoi qengjin nga ujku dhe e hëngri vetë... Pastaj, kush i zë besë e sa mund të dajandisë me dërzhavën. Po hëpërhë i duhet shpëtuar, sidomos ndonjë zemërimi të tij të pashkak...»

Dhe tërë kujdesi i kryeplakut që ta përcillte një orë e më parë pa ndonjë ngatërresë. Pastaj ai do të që larg e s'do ta ndienin kaq tepër praninë e tij të rëndë.

Po pse s'hante e pinte ky njeri? Mos vallë s'ia kishte gjetur zemrën? Kush dreqin e di çfarë ha e pi ky, çfarë i pëlqen! Harxhet harxhe dhe...

Mirëpo, kur vuri re se kapedani ishte zbutur e shkrirë pas valles, u bënte shenjë valltareve të vijonin edhe ca.

Isuf Arapi vërtet nuk i shpërndante fare vështrimin e dëgjimin nga hapej e mbyllej vallja. Lëvizjet e veçanta, melodia shoqëruese, kostumet ishin bashkuar në një të tërë të vetme tek ai. Tërë shqisat e perceptimit, me to edhe përfytyrimi e tërë qenia e tij që ndien e mendon, ishte përqëndruar në këtë pikë të vetme. Ai e shijonte vallen në tërësinë e saj e kjo tërësi shkrihej me qenien e tij nëpërmjet lidhjes të shumta, të padukshme e të pashpjegueshme. Mendimi e ndjenja që vishnin vallen sa vinte bëheshin më të qartë. E pandalshme, me lëvizje të shkathtëta e të hijshme plot poezi, me atë melodi të shtruar shoqëruese, vallja shprehte një gëzim disi melankolik, një gëzim lindur përmes vuajtjesh e hidhërimesh, po në një mënyrë të tillë sikur vuajtjet e hidhërimi të ishnin shkrirë e bërë njësh me lirizmin e këndshëm e të gëzueshëm.

Asnjëherë nuk qe zgjatur kaq shumë kjo valle. Me intuitën e femrës e të valltares, secila nga ato të dhjeta e kishte vënë re tendosjen e kapedanit dhe vallja shtrihej e shtrihej. Inkurajimi është nxitja e çlodhja më e madhe. Ato kërcenin e me bisht të syrit hetonin kapedanin hijerëndë. Jo, atij nuk i shkante mendja në ato çaste te huret e tyre si femra. Ky do të qe një shkak që ta kishin lënë vallen, e cila po bëhej tërkuzë. Por atë e kishte thëthirë krejt vallja e si t'ia linin pa plotësuar atë kënaqësi që ishte njëkohësisht edhe e tyrja? Po më në fund ato u lodhën, ndaluan pak e ia nisën një valleje tjetër me tjetër melodi.

«Male, more male, keni shumë halle...»

Isuf Arapi boshatisi mushkëritë me një frymëlëshuarje të thellë e të zgjatur, u tërhoq prapa, mori një kofshë pule e, duke ngrënë, shikonte e dëgjonte



i topitur. Valltaret qëndruan, u panë sy ndër sy e këmbyen vallen.

*«Njëzet e pesë gërsheta  
t'i numërova, pa fjeta...»*

Kryeplaku e pa që as kjo s'i tërhoqi vëmendjen kapedanit.

— Lozin mirë gratë tona, kapedan!

— Valle e mirë — tha ai.

Kur një plak tjetër rrahu t'ia bënte qejfin duke përkrahur mendimin e tij, Isuf Arapi shtoi:

— Valle e mirë. Ta drithëron shpirtin e ta jep në dorë.

«Sikur të ketë pasur shpirtin e shqetësimit tim ai që e ka sajuar! Besa, po, sikur e ka sajuar kasten për mua!»

Atij iu kujtua kënga që kishin ngritur për të e pyeti se mos kështu ishte bërë edhe vallja.

— Është valle e moçme, o kapedani ynë i madh!  
— tha kryeplaku duke lëpirë buzët.

— Valle, po valle! Ta zvretit shpirtin si fugë!  
Të bën të qash e të qeshësh, të ngre e të përtpjek. Eh!

Që kur zbriti nga kali, ishte e para herë që fliste në këtë mënyrë, shpenguar e si me duf. Kryeplaku ngazëllente. Jo, s'mund të presësh asgjë të keqe nga një njeri që e rrëmben dhe e bën për vete një valle!  
Atë e vërtit si të duash.

Popull i vuajtur ky yni — mori zemër e tha një i moshuar. — Helmi e gazi s'i janë ndarë kurrë, gjithë pranë e pranë i ka pasur, si motër e vëlla, e ai i ka shkrirë e bërë një në këngë e valle. Shpirtin e vet ka derdhur populli në to!

— Në të parën, sidomos, — pohoi Isuf Arapi.

— Ashtu, vërtet, ajo është valle e valleve nga kjo anë.

Kur dëgjoi këto, kryeplaku u ngrit e thirri:

— «As tinë, more», moj gra!

Në shesh dolën gra e vajza të tjera. Isuf Arapi u tendos sërish.

Kishte dëgjuar këngë e kishte parë valle ai. I pëlqenin çuditërisht, megjithëse vetë as këndonte e as lozte. Po kurrë ndonjëherë s'i kishte pëlqyer ndonjë kaq shumë. Vallja e kënga e tanishme e gllabëruan të tërin, ia përshkuan shpirtin tejprtej dhe shpirti i dridhej si një tel i hollë, gati në të këputur. Të ishte vërtet aq e bukur, apo vallë që ndodhur ndonjëherë në të tillë gjendje shpirtërore? Kushedi, kushedi. Kënaqësia e fitojes në ndeshje me dhembjen që sillnin veprimet e tij tek ai takoheshin shpesh. Kësaj dite të gjitha këto takime u poqën e u bashkuan në vllug të shqetësimit, kur tallazet përplasehin paprerë në shpirtin e tij të ndezur zjarr...

— Kushedi, kushedi — tha edhe ai vetë. — Por kjo valle më pëlqen tej masës, ajo sikur të jetë bërë për ballsam.

Isuf Arapi sërish i mbërtheu sytë tek ajo pikë e padukshme për të tjerët, në tërësinë e valles, atje ku me melodinë e këndshme disi melankolike, prirë nga një shami e hollë shumëngjyrëshe, gratë e hirshme si njëra, tjetra gjatë kërcimit formonin figura magjepsëse, në të cilat hapej e shkrihej shpirti i tij aq i gjerë e i shqetësuar, aq i pasur në ndjenja kontraktore, si vetë jeta e bëmat e tij.

Këtë radhë gratë ndërroheshin herë pas here: E para ia linte vendin së dytës, duke i vënë në dorë shaminë e pas kësaj shkonte në fund. Kur mbaroi vallja, Isuf Arapi e lëshoi përsëri me hope frymën e

mbajtur pezull e dorën e madhe ia shkoi ballit të dursur. Në ballin e tij bulëzonin aq shumë bulëza djerse, sikur ai vetë t'i kishte kërcyer tërë ato valle.

— Valle, po valle!

Ai u mbush me frymë e u ngrit. I madh, i kënaqur, falënderoi e i hipi kalit sikur e kishin ngritur erërat. Ndihej i çlirët i lehtë, si të kishte bërë një banjë dlorësie.

Sa ndenji në atë trevë, s'iu nda kjo ndjenjë e madhe, e gjerë. Se në çdo fshat, para se të vinte ai, arrinin tani jo vetëm fama e bëmat e tij, por edhe vallja e pëlqyer. Në njërën nga këto fshatra, në kulmin e gostisë, njëri u ngrit e tha:

— «As tinë, more», vallen e kapedanit të pamposhtur Isuf Arapi!

Dhe që në atë çast vallja dhe Isuf Arapi u bënë një emër i vetëm. Vallja e bukur ka arritur e pasuruar në ditët tona dhe emrin e bëmat e Isufit, të kaçakut të çuditshëm, të rreptë e zemërndjeshëm, jetojnë në brendinë e saj të gjerë e të pasur, plot lëng jete e ndjenje, si shpirti i begatë i krijuesit të madh popull.

## KUMBIMI I NJË KRISME

Nëna hapi derën përgjysmë e tha ngadalë:

— Të kërkojnë, bir. Është një burrë që s'e kam parë ndonjëherë, thotë se ka një fjalë me ty.

Nuk më erdhi mirë që ky dikushi po më ndërpriste punën, po s'kisha si të bëja; si zakonisht nëna e kishte futur brenda e tani ai më pritte në dhomën tjetër.

Kur hyra, para meje u ngrit një burrë nja një kokë më i gjatë se unë, e më buzëqeshi me dashamirësi si një i njohur i vjetër. Thirra në ndihmë kujtesën për të mos u turpëruar e ndërkohë përpiqesha të mbaja gjallë bisedën me pyetjet e përgjigjet e rastit. Po më kot mundohesha. Nuk e njihja.

Ai qe i ri, fytyrëkuq, veshur mjaft mirë. S'e përcaktoje dot në ishte fshatar a qytetar. Kishte me vete një çantë, që e vendosi pranë, por edhe ajo s'arriti të thoshte gjë, mbasi tani fshatarët vijnë në qytet me çanta si të qytetarëve.

Nëna na qerasi. Ai uroi më parë atë, pastaj mua, e ngriti gotën ngadalë, e piu përgjysmë me një të shijuar të ngeshëm, e hoqi nga buzët dhe e zgjati përpara duke e parë në dritë.

— E mirë! — tha. — Duhet të jeni terjaki. Por...  
ka edhe më të mirë.

Këtu ai qeshi e mua m'u duk sikur tha: «Më falni që po qesh!» Pas kësaj nxori nga çanta një shishe litërshe dhe ia hoqi tapën.

— Pa provojeni një herë këtë!

Ishte vërtet raki e mirë dhe e lavdërova.

— Raki kumbulle — tha. — Pika e parë e rakisë së kumbullës, zier dy herë, ia kalon edhe asaj të rrushit, edhe asaj të manit. Është pa erë, shumë e kulluar dhe vjen si e ëmbël.

Teksa pohoja me kokë, vrisja mendjen të gjeja se ç'punë kishte me mua ky njeri dhe çfarë do të thoshte pas kësaj hyrjeje të çuaitshme për rakinë.

Ai e la shishen në tryezë.

— Mbajeni — tha. — Meqë jeni qejfli e meqë ju pëlqen, po jua lë me shumë dëshirë.

Ndjeva të skuqesha në fytyrë dhe kundërshtova prerë. Them se kundërshtova fare pa takt, se ai mbe-ti keq e mua m'u dhimbs që po e ulte veten.

— Unë nuk e kam të blerë, — shtoi — mos kuj-toni se po harxhohem, e bëj vetë.

— Jo, ju lutem, nuk bën!

Ai kafshoi buzën, por shpejt e mblodhi veten.

— Unë nuk desha t'ju fyeja, më falni, mos ma merrni për keq... Por, fundja, ma paguani.

Me këtë kusht pranova, sepse u zura ngushtë, ndryshe ishte njësoj si t'i thosha të ngrihej e të shkonte.

Vura re se edhe ai nuk ndihej mirë. Me sa duket hyrja e bisedës s'kishte dalë sipas parashikimit e tani po e mendonte ca si tepër vazhdimin.

Kisha ulur kokën në pritje. Ç'do të më thoshte? Kush që e përse kishte ardhur? Kur të vjen në shtë-

pi një i panjohur, një hall e ka. Po nëse ky hall mund të zgjidhet nga ti e duhet të zgjidhet, pse duhet sjellë edhe një shishe raki? Hajde se në shtëpi mund të ketë ardhur nga e keqja, ndoshta sepse ka kaluar orari i punës, po shishja me raki? Kështu bën ai që kërkon prej teje diçka që e kapërcen të zakonshme, të rregulltën.

Këtë sigurisht e dija, sikurse nuk ka njeri që të mos e dijë. E lashë atë punën e shishes e u ktheva nga ai me një vështrim pyetës. Ai e kuptoi.

Unë kisha një fjalë me ju, shoku Petrit. Më falni që erdha kështu deri në shtëpi, ju mbase kishit edhe punë, po s'pata mundësi t'ju gjeja gjatë. Arri- ta me vonesë nga fshati e sot më duhet të kthehem përsëri.

«Për këtë apo sepse ke mendimin që në shtëpi mund të mbarosh punë më lehtë?» pyeta me vete duke vënë re se ai qe njeri syfortë.

— Më dërgoi te ju shoku Emin.

— Hë, po...

Tani m'u kujtua se tek Emimi kisha pirë raki kumbulle e vetiu më shkuan sytë te shishja e rakisë.

— I kam sjellë edhe atij — tha vizitori duke ndjekur shikimin tim. — Unë ia sjell gjithnjë rakinë shokut Emin, rakinë dhe ca sende të tjera ushqimore. Me para, natyrisht, po... në fshat kushtojnë më lirë dhe... — ai përsëri buzëqeshi e mua përsëri m'u duk sikur më kërkonte të falur për këtë lloj buzëqeshjeje. — Mua më quajnë Fadil.

— Aha, Fadili?

— E shikon? Ja, ju keni dëgjuar për mua, me siguri keni dëgjuar!

Vërtet kisha dëgjuar për një farë Fadili nga

Gora dhe këtë e pranova duke e parandier se tani ai do të hynte në temë.

Ajo që dua t'ju them, për ju ndoshta s'është gjë, kurse për mua... Ka të bëjë me jetën time, me familjen time...

Për të parën herë mendova se ndoshta ai kishte një hall të madh familjar e unë mund të isha nxituar në hamendjet e mia. Merret me mend që për këtë arsye u përqëndrova i tëri në fjalët e tij.

— Kjo punë, shoku Petrit, varet nga shoku Gogo. Shoku Emin më dërgoi te ju. «Shoku Petrit, më tha, e ka grurë me Gogon, atij Gogoja nuk ia prish». Shoku Emin do të vinte vetë bashkë me mua dhe kështu e patëm lënë, por i doli një punë ashtu se kishte miq në shtëpi. «Shko, tha, mos u druaj, shoku Petrit është shok i mirë, i thuaj edhe të fala nga unë.»

Fadili e ndërpreu ligjëratën e më pa drejt në sy si për të hetuar se ç'përshtypje kishin bërë tek unë fjalët e tij dhe vetiu iu shpërvol në buzë ajo nënqeshja ndjesëkërkuese.

— I kam bërë tërë përgatitjet për të ardhur këtu, në qytet, në ndërmarrjen elektrike, por më thanë që shoku Gogo ka kundërshtuar, vetëm ai. Çdo gjë tani varet nga ju, unë, familja ime, e ardhshmja ime dhe e fëmijëve... Po t'i thoni ju një fjalë... Se unë s'kam të shkuar të mirë me të; ja, ashtu... që kur ai erdhi në fshatin tonë për të ngritur hidrocentralin. Faji që imi, xhanëm, e unë u pendova, mirëpo, sa pa u thyer çyreu, se po u thye... Edhe ndonjë gjë kushedi çfarë s'patëm, jo, por... ka edhe nga ata që i fryjnë zjarrit dhe... Po të mos mërziteni, unë jua tregoj si na ndodhi me të...

Kam dy arsye që s'po e risjell tregimin e tij për prishjen e marrëdhënieve me Gogon: E para, sepse

Fadili e tori gjatë e nuk ia vlen të harxhoj më kot kohën tuaj të vlefshme. E dyta, sepse ai u përpoq ta thjeshtonte sa më shumë konfliktin, pra, iu largua së vërtetës dhe a nuk do të ishte një punë e pander-shme t'ju mbaja me ndodhi të rreme?

Këtë ndodhi unë e kisha dëgjuar edhe prej Gogos. Nga bashkimi i dy rrëfimeve të kundërta për të njëjtën ndodhi po ju radhit këtu më poshtë shkurt e saktë ndodhinë, duke u munduar që ajo të jetë sa më afër së vërtetës.

... Ka qenë koha e aksionit të elektrifikimit. Gogoja me një shok qëlloi në fshatin e Fadilit. Vend malor, ujë e rrëzime me të tepërt. Teknikët bënë matjet e llogaritjet e u vendos që hidrocentrali t'u jepte dritë tri fshatrave. Filloi hapja e kanalit. Aty punonte edhe Fadili. Njeri zevzek, nuk i shtrohej punës e s'bënte dot pa folur, vend e pa vend. Ia nisi me teknikun Gogo. E pyeste për gjithë ato gjëra si njeri shumë i interesuar. Në fillim Gogoja vërtet i shpjegonte me sinqeritet, por shpejt e nuhati që diçka nuk shkonte në atë interesim. Atëherë, sapo Fadili hapte gojën për të pyetur, Gogoja i thoshte se do t'i jepte përgjigje në pushim e ndërkaq, sikur të mos kishte kuptuar gjë, i bënte vërejtje për punën. Pas kësaj edhe Fadili s'hynte më në bisedë të drejtpërdrejtë me të. I druhej. Ai ndihej disi i ofenduar dhe, për të nxjerrë dufin, kur kalonte aty pranë tekniku, do ta gjente patjetër ndonjë thumb.

«— Këta inxhinierët e kanë paq. Na dëndin ne në kanal dhe vetë sillen poshtë e lart, demek për të na mësuar si të punojmë e për të na kontrolluar. As punë, as lodhje, ama pulat e rakia varda si në derë të pashait. Kamp, ore, kamp pushimi e majmërie!»



Fyhej Gogoja, po s'e bënte veten. Një ditë Fadili lëshoi një fjalë me spond si gjithnjë:

« — Përpjetë do të shkojë uji, bre shokë? A s'ju duket se kanali po vete gjithnjë e më përpjetë?

— Ç'i ke këto ti? — ia ktheu Gogoja.

— O, qenkeni ju, inxhinier? — Fadili e quante me tallje «inxhinier» Gogon. — Unë, ja, po bisedoja me shokun tim, nuk e kisha me ju, të më besoni...»

Ai bëhej gjithë më i paturpshëm e gjithë më i neveritshëm, ndërsa kujtonte se e kishte bërë Gogon lodër në sytë e të tjerëve. Një ditë Gogoja iu ankua brigadierit për të.

« — Ma hiq që këtej!

— Pse?

— S'punon fare. Dhe thotë ca fjalë që... si për të sabotuar punën.

— Jo, bre, mos u nxito!

— Hiqe që këtej! Ma plasi shpirtin e ndonjë ditë do ta ngjesh në kanal!

Brigadieri qeshi e ia hodhi dorën në krahë.

— Jo, atë mos e bëj!

— Ka kufi edhe durimi. Pse e cakton këtu?

— Ku ta shpie? Pa punë, s'e lë dot. Në punoftë pak, pak i japim. Po kryesorja është që, nëse s'është në binarë, ta sjellim, ta edukojmë.»

Ta edukonin! Tekniku këtu sikur lëkundej. A s'vinte ai vetë nga klasa punëtore? A nuk e njihte ai metodën e edukimit në punë? Patjetër që po. Mirëpo ai kishte bërë kaq përpjekje, të cilat i kishin vajtur fir. Fadili shkiste si ngjalë, nuk zihej lehtë në fjalë ai. Dhe jo se nuk kuptonte...

« — Dëgjo, o brigadier: «Që këtu e gjer atje», ka thënë i mençuri.»

Brigadieri s'qe dakord e tekniku pranoi se ai

kishte të drejtë. Veçse Fadili gjithë si më parë dhe ca më keq.

U ngrit hidrocentrali, u përfundua montimi i turbinës e u lëshua uji. Gogoja ndiente mbi vete tërë shikimet kureshtarë e të etshme të shumë fshatarëve që kishin ardhur të shihnin provat e para. Punonte ngadalë e me kujdes, ishte i emocionuar dhe i bëhej se ishte ai e jo hidrocentrali që do të vihej në provë. Takoi çelësin e madh. Llambat u ndezën e thirrje të gëzueshme çanë ajrin. Drita që e fortë, shigjetat e treguesve në numrat normalë. Gogoja psherëtiu e puthi të parin njeri që iu ndodh pranë. Duar të shumta zgjateshin drejt tij, e uronin e i buzëqeshnin. Ai i mirëpriste pa ua ndarë sytë shigjetave e zhurmës së turbinës. Befas një shigjetë u zhvendos me shpejtësi. Gogoja i hodhi sytë llambës së afërt. Drita kishte rënë. Ç'kishte ndodhur? Ndonjë gjë në cifun? Akoma s'qe vendosur rrjeta mbrojtëse.

Zërat u platitën, shikimet e mbërthyen.

— Ç'pati? Ç'pati?!

Gogoja tha se mund të qe zënë cifuni.

— E dashka ujin të kulluar! — thumboi dikush aty pranë. — Do t'i mbledhim tërë çesmat ku janë e ku s'janë. Po të mos mjaftojnë a po qe se edhe kë-shtu do të bëjë naze, do të vëmë kazanët e rakisë, rakia është fare e kulluar e le të punojë me të hidrocentrali ynë!

Nuk ishte nevoja të kthehej e ta shihte cili qe ai thumbaxhi. E njihte nga zëri e nga thumbat e hidhur,

Kur hidrocentrali u shtrua e filloi të punonte në rregull, tekniku Gogo kërkoi të takohej me Fadilin.

«— Dëgjo, ti, unë e di si të kam duruar. Ku e ke hallin?

Fjala solli fjalën. Kur e pa pisk e s'kishte nga t'ia mbante, Fadili dredhoi:

— Jo, bre, unë nuk e kam me ty!

— Po me kë e ke ti?

— Me kë?... Me veten time!

— Tallesh?

— Ashtu të duket ty. Sa për mua, tani që u bë edhe hidrocentrali, ëhë për të ikur që këtej, mbeta!

Gogoja nuk kuptonte ç'qe kjo ikje e ç'lidhje kish-te ajo me hidrocentralin e porsandërtuar.

— Kërkon të vesh në qytet?

— Ta merr mendja. Jetë është kjo këtu, fshat me pesë shtëpi dhe...

— Jetën e bën njeriu, jo vendi.

— Na mbushe mendjen! Pa eja ti një herë dhe bëje. Po ke gjetur!

— Unë jam punëtor, or ti, ç'kam gjetur unë?

— Qytetin ke gjetur! Lehtësirat ke gjetur! Bukën e misrit e di si është? Jo, s'e di! Rrogën e ke të siguruar, kurse këtu është fabrikë pa çati, këtu... Po ty të duket kamp, sigurisht, se ty edhe këtu ta shtrojnë vençe. Pse ti t'i kesh të gjitha të mirat, apo meqenëse pate fat të lindësh në qytet? Erdhe të na bësh hidrocentral e të na e mbushësh mendjen...

— Ti po thua ca gjëra që njihen, sido që s'janë kështu si po i paraqit ti, dhe për to po punohet që të zgjidhen sa më parë e sa më shpejt. Se ti duhet ta dish që me sustë nuk bëhet ndryshimi i dallimeve të sotme. Që janë bërë shumë përparime, të cilat e afrojnë fshatin me qytetin, këtë ti s'mund ta mohosh. Hidrocentrali pikërisht një sukses i tillë është. Unë s'e di si duhet t'i kuptoj kundërshtimin e thumbat e tu për të. Ja, edhe tani e zure në gojë për keq.

— Aq di ti. Je në qytet e me shkollë dhe të

thotë mendja se kushedi kush je. Të paça vendin! Ne shpresonim të shpërngulehim dikë, o fatmadh!

— Jeta përmirësohet me punë e jo duke ndjekur limere, mendoj unë.

— Ta kripsha mendjen ty!»

... Fjalët e mëtejshme ishin edhe më të rënda. E ç'na duhen të tjerat? Ne tani e dimë pse u zunë ata dhe në ç'pozita është secili.

Më pas qëlloi që pikërisht Fadili të bënte një kurs për elektrikist dhe ai u ngarkua të punonte në hidrocentralin e fshatit. Disa nga kursantët, me të cilët ai mbaroi, u morën me punë në ndërmarrjen elektrike për të shtrirë linjat e për të bërë instalime elektrike nëpër fshatra të rrethit. Fadili i pati zili e i vinte inat. Ai shpërblehej me ditë pune, ata me rrogë. Dhe rroga, natyrisht edhe më e madhe që, edhe merrej në çdo pesëmbëdhjetë ditë, ndërsa ai duhej të priste ç'do të sillte moti në bujqësi. Pa le që veten e çmonte më tepër se ata kursantë. Se, ç'është e drejta, i zgjuar që e mësoi mirë në kurs.

Pas kësaj i vuri qëllim vetes që të rregullohej edhe ai me punë në ndërmarrje, dhe, për inat të atyre të linjave, të rregullohej në qytet. Qyteti e pati tërhequr me kohë, po tani, me zanatin e ri, e ndiente se ndodhej pranë tij. Kështu i thoshte mendja.

Eh, po vetëm ç't'i bënte atij Gogos! Gogoja tani ishte në një detyrë me përgjegjësi në ndërmarrjen elektrike. Kur kanë fat ca njerëz!... Dhe ai kishte gjetur të zihej pikërisht me një njeri të tillë me fat!

Tanimë Fadili sikur s'kishte ç'të thoshte më, se përsëri e përsëri kthehej në ato që kishte thënë.

— Ku dreqin ta dija se një ditë... Vete e zihem me shokun Gogo!... Le që, ç'të zënë që ajo... por, ja...

njeriu edhe çaste hajvanllëku ka e unë me të hajvanllëk bëra.

— E kuptoj.

Ai ngriti kokën e më pa drejt në sy. Nuk e di për të satën herë iu end në buzë ajo buzëqeshja e përvjelë.

— E pra, vetëm një fjalë nga ju...

— Do të bëje mirë të shkoje vetë tek ai.

— He, po ai... jemi shqipo ne, bre, dhe shqipua, kur ia ke prishur njëherë, ta mban vëth në vesh.

— Jo në këtë drejtim që kujton ti. Po qe se ndër marrja ka nevojë, ti bëje kërkesën dhe jepja atij. Gogoja është djalë me karakter, s'është nga ata që mbajnë mëri e nxjerrin inate. Pastaj kërkesa jote do të shtrohet në drejtori, s'e ka vetëm ai në dorë këtë punë.

Fadili luajti nga vendi.

— Hë, sikur s'e dini si bëhen këto punë! Ja, shtrohet në drejtori, në këshillin teknik a në kolektiv. Po varet shumë kush e shtron e si e shtron. Të tjerët, që s'të njohin, bëjnë siç thotë ai që të njeh e që lufton o për mirë, o për keq.

— S'është kështu, jo!

— Nejse. Ju t'i thoshit një herë. Ai ju dëgjon. Ç'ju kushton juve? Se mua ai mund të më thotë që s'kanë nevojë, ma pret shkurt dhe... Po gjeta punë në qytet, marr kollaj edhe shpërnguljen nga fshati.

Mezi po e përmbaja veten. Bëja përpjekje për t'u përmbajtur.

— Në qoftë se kanë nevojë, s'mund të të thotë se s'kanë. Dhe unë s'e krijoj dot nevojën e ndërmarrjes së tyre.

— Mua më tha shoku Emin se ju...

— Ka bërë gabim!

— Domethënë ju....

— E thashë një herë.

Ai psherëtiu e u shëmtua në fytyrë, ndoshta ngaqë i vajti gjithë ai mundim kot së koti. Më pa drejt në sy i dëshpëruar.

— Edhe një herë ju kërkoi ndjesë që ju bezdisa në shtëpi — tha duke i hequr fjalët zvarë si të ishin shumë të rënda.

«Ti gjuajte rastin që të më gjeje pikërisht në shtëpi», thashë me vete.

Mua më vinte inat. I ri, i shëndetshëm, i zgjuar, ai i kishte hyrë një rrugë të tërthortë, të shëmtuar dhe e shihte jo drejt të ardhshmen. S'e kam fjalën vetëm se deshi të rregullohej me punë në ndërmarrjen elektrike, po te motivet që e shtynin e te rruga që ndiqte për ta realizuar dëshirën. Dhe Emini ia kishte ushqyer këto motive, këtë rrugë... Keq, shumë keq. Përgjegjësi ka edhe ai, duhet mbajtur qëndrim edhe ndaj atij...

Fadilit i fola gjatë për të gjitha këto. Ai dëgjonte kokulur.

— Më falni! — tha kur unë mbarova. — Këto i dëgjova edhe nga kryetari i Këshillit, po s'desha t'i kuptoja.

Ai menjëherë u ngrit për të shkuar. S'ma dha syrin e s'arrita të kuptoja me çfarë domethënie i tha ato fjalë. Ai bëri nga dera.

— Harruat shishen!

Fadili bëri shenjë me dorë si të thoshte: «Në djall të vejë shishja!»

E mora e ia dhashë. Ai e hodhi në çantë pa kujdes. Shishja u përplas me një tjetër e lëshoi një tingëllim kumbues. Kjo e bëri të dridhej. Ajo krismë e ai kumbim më mbetën në mendje për shumë kohë.

Mos qe vallë thjesht kumbim i shkaktuar nga për-  
plasja e dy trupave të qelqtë apo diçka më e thellë?!  
Anoja nga dyshimi i dytë. Ai kumbim e ajo krismë  
qenë një thirrje tjetër që i bëhej ndërgjegjes së tij.  
Kjo qe arsyeja që ai u drodh, kur e dëgjo. Këtë e  
kuptova plotësisht pas ca kohe.

## NJË HAP I NEVOJSHËM

Qeti është një vajzë e shëndetshme dhe e shkathët, me trup të gjatë e të drejtë. Ajo kurrë nuk ecën ngadalë e nuk ka qëlluar ndonjëherë ta bëjë një punë me përtesë. Përveç rinisë, këtë gjallëri ia ka dhënë edhe baleti, ku merr pjesë prej vitesh e është një nga kërcimtarët më të mira të trupës amatore.

Pikërisht nga provat e baletit kishte dalë atë ditë. E bukur, e freskët, me atë të ecurën e shkathët që e bën një femër të pëlqyeshme, Qeti tërhoqte vëmendjen e kalimtarëve. Ajo nuk e kishte mendjen tek ata, po vetiu buzëqeshte dhe s'mund të ndodhte ndryshe; ajo vetë ishte e tëra si një buzëqeshje e këndshme, e madhe.

Vallja që po mësonin, i pëlqente shumë, shumë. Duke ecur trotuarit, i bëhej se akoma ishte duke kërcyer suitën me figurat e bukura e sikur dëgjonte muzikën e ëmbël që e shoqëronte atë suitë.

— Nezaqet!

Vajza dëgjoi kur e thirrën për të dytën herë. Ktheu kokën e me një lëvizje të hijshme mënjanoi një tufë flokësh që i binte mbi sy. Në anën tjetër të trotuarit, nën një bli, kishte qëndruar e po e pritte një burrë i gjatë e i hollë. Ishte i ati.



— Ti më thirre, baba?

— Unë, po kush tjetër?

Babai ia nguli sytë rreptë.

— Nga të fluturon mendja kështu?

Qeti i tha se kthehej nga provat e suitës dhe se  
qe një gjë e bukur, shumë e bukur.

— Aq e bukur, saqë edhe rrugës po merresh  
me të?

Vajza pohoi me kokë. Babai e hetoi edhe një  
herë me sy të egërsuar. Pastaj i tha të venin bashkë  
për të blerë disa ushqime. Qeti ia mori rrjetën dhe  
e shoqëroi. Babai shpejtoi këmbët, gjithë duke ecur  
trotuarit. Ajo në krah të tij me të njëjtin hap. Nje-  
rëzit venin e vinin mizëri në bulevard. Disa nxitonin,  
të tjerë shëtitnin qetë-qetë. Një djalë i ri vinte kun-  
drejt tyre. Ecte ngadalë duke thithur cigaren me një  
pipë të hollë. Ia kishte ngulur sytë Qetit dhe e shi-  
konte me lakmi nga koka te këmbët pa e përfillur  
fare babanë e saj. Kur kaloi përbri tyre, djali ktheu  
kokën dhe e pa edhe një herë nga pas. Atë çast ai  
hasi vështrimin e vrenjtur e kërcënues të babait të  
Qetit dhe për çudi qeshi. Babai i Qetit u tërbua sido-  
mos nga kjo e qeshur e paturpshme.

«E sheh ti, rrufjanin? T'i kthehesh e ta bësh  
pestil!... Kafshë!»

Nuk i erdhi aspak mirë që fytyra e së bijës qe  
e qeshur e mjaft e kënaqur (atij kështu iu duk),  
ndërsa duhej, të paktën, t'i tregonte vendin atij ho-  
rri, goftë edhe me një të ngrysur të vetullave. Qeti  
e kapi për krahu e u mbështet fort pas tij. Babait  
as kjo nuk i pëlqeu, po s'e bëri veten.

Më tej vajza dikë përshëndeti buzagaz. Babai  
ndoqi me sy shikimin e saj dhe pa një djalë trup-  
llastar që buzëqeshte edhe ai. Djali i buzëqeshi dhe

e përshëndeti edhe babanë pak si me drojte, ndryshe nga buzëqeshja për vajzën. Babai kështu iu duk. Ai nuk iu përgjigj fare përshëndetjes së tij.

— Cili është ai? — pyeti.

— Koreografi.

— Aha!

Babai tregoi interesim për të e do të donte ta shihte më mirë atë djalë që na qenkësh koreografi, po e shtrëngoi veten të përmbahej?

— I martuar është?

— Jo.

— Aha! — ia bëri për së dyti.

Vajza nuk foli. As ai. Mbase flitnin me vete. Dhe flitnin vërtet. Qeti thoshte me mend se babai po tregohej shumë i kujdesshëm. Babai shkante më tej. Atij po i rritej e i merrte formë një përfytyrim sfilites. As njëri, as tjetra nuk thanë gjë, derisa u kthyen në shtëpi. Ka çaste të tilla kur ke shumë për të thënë e megjithatë hesht. Qetit i vinte inat e për të qeshur njëkohësisht.

Sapo hynë në shtëpi, nëna e Qetit iu vu punës për të përgatitur darkën. Babai hoqi pantallonat e veshi pizhamat; pastaj u ul në divan e ndezi radion. Qeti vraponte sa andej-këtej. I ndihmonte nënës ose rregullonte ndonjë gjë nëpër shtëpi. Shpesh me mend ishte përsëri te vallja e bukur. Njëherë, ashtu më këmbë si qe, duke pritur një porosi të së ëmës, i dha trupit përpara, siç bënte kur përgatitej për të filluar vallen. Dalngadalë kjo po i bëhej shprehi. Në këtë lëvizje fustani i hollë u bë për një çast si ombrellë e lejoi të dukej më tepër nga mbigjyri. Babai e pa e diçka e kafshoi përbrenda. Mbylli sytë e u kthye nga muri. Po s'mund ta hiqte dot nga mendja atë pamje.

«Ajo e di veten të vogël akoma e bën lëvizje si pa të keq. Budallaqja!»

Në kokën e tij kaloi vetëtimthi ai djali i pacipë, pastaj koreografi i qeshur trupllastar.

Babai shtrëngoi sytë e u drodh.

«Në moshën e saj vajza nuk e di as vetë ç'është, s'e di ç'rreziqe fsheh e sidomos në këto lëvizje... Prandaj dhe gënjehet shpejt. Jo, s'duhet lënë më!»

Ai u vërtit në divan. Divani krisi. E shoqja ngriti kokën e sytë e tyre u takuan.

«Ajo hov pa të keq dhe... ata kullosin sytë, moj, e di ti apo jo?» tha shikimi i tij.

— Qeti!

— Urdhëro, baba!

Ai u ngrit ndenjurr e i bëri shenjë të ulej pranë tij.

— Po ti akoma do të vesh në balet, moj çupë?

— Akoma. Pse?

— Të vogël e di veten?

Babai e mati me sy për të përforcuar mendimin se ajo s'qe më e vogël.

— Po, — tha vajza — e di që s'jam më e vogël.

— E pra, nuk duhet të merresh më me këto balete e...

Qeti ngriti vetullat sikur s'e kuptonte ku desh të dilte ai. Ndoshta kuptonte vetëm njërin anë të çështjes.

— Por unë s'jam më në baletin e Shtëpisë së Pionierit de! Në baletin e Pallatit të Kulturës të gjithë jemi vajza e djem të rritur!

«Vajza e djem të rritur! Jo, ajo s'e di se ç'rreziqe ka kjo moshë! I takon prindit ta mësojë e ta mbrojë.»

— E po... ca gjëra ti tani duhet t'i kuptosh edhe vetë.

— Aha! — ia bëri Qeti e uli kokën e menduar.  
Babai kuptoi se ajo po e qesëndiste duke përdorur shprehjen e tij.

— Nuk e ke marrë me tapi atë baletin. Le të venë edhe të tjerat sa ke vajtur ti!

— Cilat të tjera?

— Qyteti ka me qindra e mijëra vajza.

Vajza qeshi.

— S'është aq e lehtë, baba. Ne jemi mësuar, se kemi vite që ushtrohemi. Atje s'duhën as njëqind e as një mijë. Duhën dhjetë vajza të talentuara.

— Të talentuara.

Babai ngeci. Tani e kuptonte gabimin. Dikur i bëhej qejfi që e bija kërcente si flutur. Na, tani! Qenka e talentuar! Në tërë atë qytet vetëm ai e nja dhjetë të tjerë na qenkëshin të mençëm e paskëshin nxitur talentin e bijave! Ama, talent!

Kafshoi gishtin e luajti vendit.

— Tani mësimet t'u rënduan. Sa vjen më të vështira bëhen. E more vesh si u dhanë të drjetat e studimit sivjet? Nxënësve të dhjetave u thanë të zgjidhnin vetë degën që kishin qejf. Këtë duhet të arrish edhe ti!

— Do ta arrij, baleti nuk m'i pengon dhjetat mua!

— S't'i pengon tani, t'i pengon më vonë. Lodhje është. Pastaj edhe me punët e shtëpisë duhet të merrësh ca më shumë. Jot ëmë punon me turne, edhe e sëmurë është, ti e di!

Qeti e pa drejt në sy sikur të provonte në këtë shikim vërtetësinë e fjalëve që ai sapo kishte thënë. Babait ky iu duk një guxim i tepruar.

«Është a s'është çupa ime kjo, xhanëm? Po më silllet si komandante! Kaq poshtë kam rënë unë?... E po, moj çupë, hiç mos të të gënjejë mendja. Për të

rritur, u rrite vërtet, po me trup ama, se nga mendja, ti s'ndan dot të bardhën nga e zeza! Nuk e ndan dot!»

Pas këtij mendimi iu duk fare e kotë koha që po harxhonte e mënyra se si e kishte nisur bisedën.

— Nuk do të shkosh më në balet! More vesh? Mora, thuaj!

Qeti u hodh drejt e më këmbë. E ëma, që deri atëherë s'ia kishte vënë veshin bisedës së tyre, u kthye gjithashtu nga ai. Të dyja e mbërthyen me një vështrim pyetës e habitës njëkohësisht. Ai nuk e përfilli vështrimin e tyre. U ngrit e shkoi në dhomën tjetër. U kthye i veshur për të dalë. Duke shtrënguar kravatën në qafë, mjaft i nervozuar, tha:

— Ç'të thashë! Dhe shiko e gjej ndonjë shkak që të mos të të qepen më. U thuaj se ke për të mësuar e se mamaja s'është mirë me shëndet. Diçka të këtillë!

Ai ia nguli sytë kërcënueshëm, lëvizti dorën në ajër sikur të thoshte: «Mjaft më», u kthye e doli. Ëmë e bijë këmbyen me njëra-tjetrën vështrime të habitura.

— E po... — tha nëna.

— S'është kaq e thjeshtë, nënë! — tha Qeti.

E ëma u përkul mbi tenxhere. Vajza e pa ashtu e ndjeu keqardhje për atë e për vete. Një keqardhje të papërcaktuar. Do të donte të bisedonte me të ëmën, po vuri re se ajo s'e vlerësoi kushedi që këtë ndodhi. Prandaj doli edhe ajo e vajti në dhomën e pritjes. U shemb mbi divan e mërzitur. Kur u çlirua disi, ia mbërtheu sytë tavanit.

«Ti më kujton të rritur vetëm në shtat. Jo, baba, gabohesh! Unë vërtet s'jam e vogël më dhe, kur s'jam e vogël, domethënë se jam rritur, po jo veç në një drejtim, rritja s'është e njëanshme. Ti s'do që unë

të vete më në balet, se druhash mos ngatërrohem me ndonjë. A thua s'e kuptoj unë ku e ke hallin? Kohët e fundit se si më shikon. Se mos gjesh tek unë hovet që mund të ketë mbjellë ndonjë shigjetim. Më sheh me tjetër sy. Ky qëndrim mua më habitte deri sot; kurse sot ti vetë më sqarove si jo më mirë. Tani e di, ti ke frikë. Ti je treguar përparimtar dhe unë jam mburrur me ty. Mirëpo tani ndryshove papritur; tani thua: «Më mirë larg zjarrit»...»

Qeti për një çast i ndërpreu mendimet.

«Ti ke një fjalë më tepër. Mirë ti, po unë?»

Qetin e zuri gjumi vonë, pasi e lodhi veten me këto lloj gjykimesh. Bëri një gjumë të rëndë e u zgjua me dhembje koke. Mbasdite nuk vajti në provat e baletit. Shoqeve u tha se ishte sëmurë.

— Meqë s'erdhe ti e s'bëheshin dot provat, një copë herë vallëzuan. Ç'vajti! Letit s'iu nda Mondit!  
— tha Lili.

— Ti pse s'shikon veten tënde? — kërceu ajo që quhej Leti.

Vajzat qeshën pa të keq e Qetit i theri në zemër.

«Edhe këto shakara të dijë ai dhe...» mendoj me hidhërim.

— A do të vish sonte, Qeti?

— Të shoh, po të jem mirë...

Një herë mundi t'i gënjente dhe ato e besuan. Po më tej? Të nesërmet vijnë radhazi. Ajo që e vrrarë shpirtërisht. Nuk ishte e mundur të mos binte në sy ndryshimi i humorit të Qetit, asaj çapkëneje që qe kripa e klasës.

Shkoi edhe një ditë tjetër. Në mëngjesin e mëpasshëm, pa hyrë në mësim, e takuan shoqet e baletit.

— Pse s'erdhe as mbrëmë? Ti e di që së shpejti kemi shfaqje! — tha Lili.

Ç't'u thoshte? I vinte turp që i kishte gënjyer, po i vinte edhe rëndë të pohonte faqe tyre se babai i saj po tregohej fanatik. Ca më tepër se e kishte mburrur për të kundërtën. Mirëpo s'kishte si t'ia bënte. Ato do ta merrnin vesh që do ta merrnin. Më mirë t'u fliste hapur.

— S'më lë babai — tha me turp.

— Ua! — ia bëri njëra.

— Tani e gjeti kohën të kujtohet ky? — tha Lili.

— Pse, ne, vajza rrugësh jemi?

Qeti kafshoi buzët sikur atë fyerje ua bënte ajo shoqeve e jo ai, se është e çuditshme që e mbajmë mbi shpinë edhe ne vetë gabimin a fajin e një të afërmi dhe kjo ndodh në mënyrë krejt të vetvetishme.

— Po ti? — pyeti Lili.

— Unë?... Përpiqem t'ia mbush mendjen... pa dobi.

— Ua, po kjo është e qartë, ç'ka këtu për t'iu mbushur mendja?

— Nuk uroj ta provosh mbi vete, Lili — tha Qeti.

— Të kuptoj, më fal! — pranoi tjetra.

— Tërë bisedat përfundojnë në favor të tij. S'të lë dhe pikë!

Shoqet thanë se e besonin. Ato e shikonin si me keqardhje. Qeti ktheu kokën në anën tjetër. I bëhej se përçmonte veten duke mirëpritur keqardhjen. Kafshoi buzët e u përmbajt. Korridorët ciasnin nga moria e nxënësve e do të vdiste nga turpi po të qante aty si një bebe. Kjo i dha zemër.

Pastaj ra zilja e hynë në klasë. Kur mbaroi mësimi, Qeti shkoi drejt e në shtëpi menjëherë.

Hëngri drekë e po rrinte në divan. Rrinte në një

cep si e trembur. I ati e shikonte vetullngrysur. Me sa dukej, i thoshte mendja se duhej të rrinte sa më vrazhdë ndaj saj për të qenë sa më i efektshëm urdhri i tij i prerë. Ajo i shtrëngonte gjunjët e përpiqej të shtrinte fustanin mbi ta.

«Ashtu, posi!» tha me mend i ati.

Mirëpo ai nuk arriti të kënaqej me këtë «bindje» të së bijës, kur pa me habi të hynte brenda një grup vajzash, shoqe të saj. Ai e pa drejt në sy Qetin për të zbuluar se mos ky qe një takim i kurdisur. Qeti nuk iu përgjigj këtij shikimi, po dukej qartë që edhe ajo ishte ca si e hutuar nga vizita e shoqeve.

— Mirëdita! — tha Lili.

— Mirëdita! — thanë të tjerat pas saj.

— Uluni, moj çupa! — tha nëna e Qetit, e cila hyri bashkë me to.

— Faleminderit, mamaja e Qetit, po s'kemi kohë. Erdhëm për Qetin, se kemi prova. Gati je, Qeti? — tha Lili.

Babai i Qetit i shikoi me radhë. Vështrimi i tij qëndroi te Lili. Tha në një mënyrë tepër të zakonitë:

— Te ju ka mbetur Pallati i Kulturës? Shih, shih!

— Ne s'kemi ardhur këtu për të na vënë në lojë! Qeti, hë, se po të presim!

— Qeti nuk vjen — tha babai i saj. — Nuk ia ka ngenë baletit ajo, e ëma punon me turne e është e sëmurë.

— Ato tonat mos vallë rrinë shtrirë gjithë ditën?

— Atë s'e di unë. Di ç'bëhet në shtëpinë time. Qeti ka punë, këtë di unë. Dhe duhet t'u vihet më tepër mësimëve.

— Po ne nuk duhet?

— Puna juaj. Vërvuni, pra, e mos u merrni me... me tra-la-la!



— Tra-la-la u thënkeni ju?!

— Po ç'janë tjetër?

— Aktivitete edukuese.

— Hëm!

— Dhe këtë aktivitet e bëjmë ne e ju s'duhet të na pengoni.

— E po, moj çupa të mbara, sipas jush, prindërit asgjë s'dinë? Apo s'u dhemb fare koka për ju?

— Kush e tha këtë?

— Kush e tha?

Ai përsëriti në mënyrë të pavetëdijshme pyetjen e saj dhe kjo pyetje mbeti pezull.

— Ajo nuk vjen. Edhe unë t'i them, s'vjen... Sepse e di ç'punë ka, sepse... — ai u kthye nga Qeti me shpresë se ajo do të mos e kundërshtonte atë që kishte thënë ai. Mbi Qetin u mbërthyen edhe vështrimet e shoqeve. Ky ishte një provim i fortë vështrimesh.

— Vërtet? — tha njëra nga ato.

— Unë kam qejf — tha Qeti. — Ajo çështja e mësimëve dhe e punëve të shtëpisë, s'është gjë.

— Nuk është ashtu!

Babai u vrenjt e heshti.

— I qerese çupat? — tha pas pak.

Ato e kuptuan se ai po i përcillte. U ngritën e shkuan të heshtura, pa e marrë dot shogën me vete.

— Kështu, hë? Mirë ma bëre! Mirë! Se të kam dashur e ta kam zgjatur sa më s'i bëhet! — shfreu babai.

Qeti nuk ishte një gjendje të përcaktonte kishte bërë ajo diçka jo të mirë, apo ishte bërë diçka jo e mirë? Ndjeu një boshllëk të pakuptueshëm në zemër e mend qante. Pas kësaj edhe babai heshti. Qe një heshtje e gjatë dhe e rëndë, e cila u prish nga një

trokitje e lehtë në derë. Babai u ngrit vetë e vajti ta hapte. Ai mbeti me derën gjysmë të hapur kur u ndesh atje me atë djalin trupllastar e me një djalë tjetër më të ri.

Në çast babai i Qetit e mblodhi veten dhe kup-toi si qe puna.

«Ky tjetri do të jetë ndonjë nga ata «të talentuarit»! tha me vete. Do të kenë ardhur të bëjnë atë që s'e bënë dot vajzat.»

Nuk ua dha dorën e as i ftoi të hynin brenda.

— Na falni, — tha koreografi — unë jam punonjës i Pallatit të Kulturës dhe ky djali një aktivist amator. U shtrënguam të vinim deri këtu, se jemi para shfaqjes dhe mungesa e Qetit në provat e fundit na prish shumë punë.

— Po sikur ajo të qe e sëmurë?

— Do ta shtynim shfaqjen, ndoshta.

— He, ashtu, llogaritë s'i keni bërë mirë. Tani bëni si të bëni, zëreni si të ishte e sëmurë.

— Ka rolin kryesor — ngulmoi koreografi.

— Unë ju thashë t'ia jepni atë rol?! Jo, s'ju thashë. As ju s'më thatë gjë. Të larë jemi, pra. Ajo s'mund të vijë më.

— Por... kështu, kaq papritur... Ne mbetemi edhe të fyer, si të thuash... Cili është shkak?

— Hiç s'keni pse të mbeteni të fyer. Deri tani erdhi, këtej e tutje s'vjen, asgjë s'ka me ju këtu. Ka punë shtëpie, ka mësimet,.. shkaqe tona, me një fjalë.

Babai i Qetit s'priti që ata të thoshin gjë tjetër, mbylli derën dhe hyri brenda.

Qeti vinte e vinte sa në një dhomë në tjetrën. Hapte një sirtar, diçka kërkonte me nervozizëm.

«Do të ketë dëgjuar! tha me vete ai. Ca më mirë.»

— Ti u solle shumë keq me ta, — tha ajo.

— Iu prish qejfi, thua?

— Ti e mban veten për njeri me kulturë, kur-se sot...

— Çfarë sot? Mend do të më shesësh ti? Krushqi s'kemi për të bërë me ta!

«Aq di ti, tha me mend. Po... ta kisha mbajtur një çikë veten, xhanëm. Urtë e butë më mirë do të qe... Mirëpo kjo budallaqja m'i solli të gjithë këtu e njeriu s'i ka nervat prej çeliku.»

— Këto ditë po pësoj një zhgënjim të madh. Po më dukesh i çuditshëm e s'po të kuptoj dot deri në fund. Ti ke frikë se mos unë atje...

— Çudi është thua ti? — e ndërpreu ai.

— E sikur?... Njëzet vjet më parë ju jeni martuar me dashuri, pse tani i trembesh kaq shumë një mundësie të tillë për mua?

— Kur të vijë koha. S'kemi për të të shitur, mos qaj. pa të rrahur.

— Si e kupton kohën ti?

— Pusho! S'ke as turp që bisedon të këtilla gjëra!

Ajo kërceu përpjetë krejt e çmerituar.

— Çfarë zhgënjimi! — ia bëri si për vete.

Babai bëri sikur nuk dëgjoi. Tha ngadalë:

— Nuk dua të të ndodhë ndonjë gjë e shëmtuar.

E kam për detyrë të kujdesem si prind që jam. Jo se s'kam besim te ti, po... rasti edhe i gabon të rinjtë. Kur të vijë koha, do ta gjesh edhe ti shokun e jetës, po, që të hërbosh, s'të lë!

— Baba!

— Hajde, hajde! Ku ke vajtur ti, unë jam kthyer. Rasti...

— Ti qenke... Ti qenke...

— He, pa të të dëgjoj, ç'qenkam unë?

— Kam gënjyer veten e shoqet me ty! Tani që unë u rrita, ti...

— Qepe! Se të durova si shumë! Do të bësh si të të them unë, edhe se u rrite. Kur të të marrë ai bandilli, le të të lërë makar të...

E ëma e Qetit ndërhyri për ta zbutur bisedën.

— Ç'bëni kështu? Si s'mendoni një herë që jemi në rrugë! Ju dëgjojnë bota e kushedi përse u shkon mendja. Turp! Po ulu, moj bijë!

— Ah, mama.

— S'bën kështu, s'bën!

— Si ti dhe unë. Je bindur pa fjalë ti, ashtu kam bërë edhe unë. Jemi nënshtruar dhe babai...

Babai iu vërvit, po vajza s'u tund fare.

Nëna u shushat e shihte me lemeri herë njërin e herë tjetrin. Vajza qëndroi, ai u kthye pa e qëlluar. Vetëm atëherë Qeti shkoi në dhomën tjetër.

Pas ikjes së saj, në kuzhinë pllakosi heshtja. Babai tha ca fjalë të rënda në adresë të vajzës, po gruaja s'ia vuri veshin, madje një herë i tha se si s' kishte turp që fliste kësisoj.

Heshte edhe dhoma matanë. Ç'bënte Qeti, vallë?

— Mos ka ikur? Shko shih!

E kishte tronditur dhe e kishte trembur qëndrimi i patundur i së bijës.

Gruaja u kthye shpejt.

— Atje është — tha.

— Ç'bën?

— Mendohet.

— Mirë. Do t'i gjejë qetë. S'ma merrte mendja të ishte kaq kokëkrisur, por edhe unë s'bëj udhë. Tani ajo do fre!

Gruaja s'foli. Psherëtiu. Ai e pa. Ajo bëri kokën

mënjane. S'foli prapë. Ç'mendonte, vallë? Edhe ajo po i kthehej kundër? Ç'po ndodhte kështu në shtëpinë e tij?

Ai e ndezi e vente e vinte nëpër dhomë. Ecte me kujdes. Nuk deshë ta merrte vesh e bija që ai ishte i tronditur. Kështu ajo merrte zemër dhe e shpinte më tej kryeneçësinë e saj, e quante të mposhtur babanë. Duhej ta mbante veten, dreqi ta hajë!

«U rrëmbeva. Ndryshe duhej ta vërtitja. Mirëpo ajo faqe shoqeve e pranoi që ka qejf të vejë dhe... fare budallaqe! Sa pak që i njohkemi fëmijët tanë!... Sidoqoftë, u rrëmbeva. Prit kur të vij në prapë ato çupat, në mos edhe të tjerë. Ca fëmijë s'munda t'i bëja dot zap...»

Tani ai e kuptonte se puna kishte marrë spicë. I druhej ndonjë ballafaqimi në drejtorinë e shkollës a në qendrën e tij të punës. Asgjë s'i dukej e pamundur, çdo gjë e priste.

— Më keq s'mund të bëhej, dreqi e marrtë! — shau me vete dhe vuri në punë trurin për të meremetuar atë që e kishte prishur aq përnjëherësh në zemërim e sipër.

Ndërkohë Qeti në dhomën matanë mendohej gjithashtu. Ulur në divan, syrin pishë, gjumit ia kishin zënë vendin mendimet.

«Ato që thotë ai, s'të bindin aspak. Në krahasim me çka bëjmë ne, ato janë qesharake e krejt çikërrima. Po si t'ia bëj unë? Ai ka një fjalë më tepër: «S'të lë!»»

Dy ditë më parë kurrë nuk do ta përfytyronte dot një bisedë të tillë me babanë. Nuk besonte të kishte kaq guxim, kujtonte se do ta kishte të rëndë, shumë të rëndë, se s'do të mund të fliste, se s'do të

mund të mbahej fare. Tani kjo bisedë ishte bërë dhe për çudi ndihej edhe e fortë, edhe si më e lehtë.

«Ai ka një fjalë më tepër. Mirë ai, po unë? Një punë e nisur dhe për të cilën ke bindjen se është e mirë, duhet shpënë në fund.»

Rreth kësaj pike përqëndroheshin tani tërë mendimet e saj. A ishte sjellë keq ajo? A e kishte fyer gjë babanë? Ishte treguar vallë e parespekt, pa edukatë ndaj tij? Nuk gjente asnjë të metë të kësaj natyre, madje edhe ato ditë kur ai ishte sjellë aq ashpër me të. Nga kjo anë ishte fare e qetë. Nga ana tjetër ishte tërësisht e bindur se ai nuk vepronte drejt, aspak, drejt. Këto i jepnin kurajë.

Mëngjesi ia hapi qepallat e ia rivuri në kokë mendimin e fundit, që ia kishte rrëmbyer gjumi pas aq mundimesh në orët e vona të natës.

«Sonte është prova e përgjithshme. Njëlloj si shfaqje. Më paska zëvendësuar Lindita. Lindita kërcen bukur, po ç'mund të arrijë ajo në dy ditë? Lili e tha qartë që duhet të vete unë, ndryshe shfaqja mund të shtyhet... Të shtyhet vetëm për shkakun tim? Dhe pse? Se i ka hyrë frika babait për mua! Kjo është e tmerrshme!... Lili s'ka për të ndenjtur rehat, e njoh unë atë. As të tjerat. Mund të bëhet problem... Për mua, sikur... Babai si zor të jepet. Mirë ai, po unë?... Sonte është shfaqja...»

Qeti u ngrit rrëmbyer u shtriq.

«Po sikur të përpiqem edhe një herë?»

Me këtë mendim hyri në kuzhinë.

Edhe ai sapo qe ngritur.

— Mirëmëngjes! — tha Qeti.

Babai iu përgjigj me një lëvizje të kokës.

Ajo vuri xhezven e bëri një kafe. Dhe, kur ia dha kafënë, tha:

— Ti duhet të kesh më tepër besim tek unë... Nuk është mirë të më bësh të skuqem para shoqërisë. Nga kjo as ti s'fiton gjë, përkundrazi.

Ai ngriti kokën dhe e pa në sy të bijën. Sytë e ëmbël e të bukur të Qetit kishin fiksuar mbi të një shikim të zgjatur e të fortë. Babai nuk i qëndroi dot atij shikimi.

— Më kupton?

Ai s'foli.

Vajza fërgëlloi. Nëse nuk po pranonte gjë, i ati as edhe po kundërshtonte. Dhe kjo për të nuk qe një gjë e rastit e pa rëndësi. Shpejtoi në dhomën tjetër për t'u përgatitur për në shkollë.

— Sonte kemi shfaqje! — tha e i dha trupit përpara e mori atë qëndrim të hijshëm, si zakonisht, para kërcimit.

## KËRCIMI TEKNIK

### 1.

Përgjegjësi i sektorit u ndal pikërisht atje ku shkëputej nga kanali një vijë uji. Vjeshta kishte ardhur qëkur, po akoma bënte mjaft nxehtë e kanali vaditës vijonte punën e vet.

Gllu-gllu, bënte uji që derdhej me rrëmbim poshtë mezhdës. Në jonxhën e kositur rrafsh me tokën uji e priste vrullin, përhapej e humbiste ndërmjet bisqeve të reja e ca fletëzave të buta e të blerta që sapo kishin bulëzuar pranë kërcejve të trashë të jonxhës.

Ajo glju-glluja e ujit, fletëzat e njoma të jonxhës dhe bukuria e vjeshtës së begatë që sapo kishte shkëlur në prag, i sollën një kënaqësi përtëritëse përgjegjësit të sektorit. E thirri kooperativistin që ujitte e u ul në mezhdë. Kooperativisti u mbështet në shatën bishtgjatë.

— Ndize, Sabri! — tha përgjegjësi i sektorit.

I dha cigaren, e ndezi edhe vetë. Fjolla e tymit mavi në fillim u zgjat, pastaj u shpërnda e krijoi një si mjegull rreth tij. Përgjegjësi po e thithte fort e me kënaqësi cigaren.

— Edhe një kosë të mirë do t'ia marrim kësaj —



tha për jonxhën. — Pesë kosa të plota s'i thonë pak, ë?

— Jo, s'ishin pak. Sabriu pohoi në heshtje.

Po ç'kishte ky Sabriu kështu? Pse dukej i menduar e jo në qejf? Dhe se si e shikonte përgjegjësin, sikur ia qante hallin për ndonjë gjë a sikur e qortonte, diçka e tillë, një përzierje e këtyre dy nuancave.

— Pak më parë qe këtu agronomi.

— Cili agronom?

— Qemali.

— Hë... e pastaj?

— Tha se kjo jonxhë është rralluar e do çare.

Përgjegjësi kërceu drejt më këmbë.

«Kudo po më del përpara ai!»

— Tha gjë tjetër?

— Jo.

— E ku vajti?

— S'e, di, rrugën e fshatit mori.

Flladi s'e freskonte më, atë gllu-gllunë e këndshme të ujit nuk ia kapte veshi. Pamja e bukur iu terratis çuditërisht shpejt. Sikur ia shkuli njeri me dorë tërë kënaqësinë.

Përgjegjës Bedriu u përshëndet me kooperativistin e u largua i menduar, qejfprishur.

## 2.

«Ai do të jetë andej nga magazina, do të ketë vajtur aty për punën e farës.»

Edhe kishte edhe s'kishte qejf të takohej me kryeagronomin. Thoshte me vete se me një njeri që s'i ke qiqrat të mbara, më mirë të takohesh sa më

dendur për të shpërndarë hijet e keqkuptimit. Të ndenjurit larg sjell keqkuptime të tjera e i ushqen të mëparshmit.

Po bënte vitin kryeagronom Qemali në kooperative. Bedriu e priti mirë emërimin e tij. Kishte dëgjuar fjalë të mira për të, thoshin se qe djalë i zoti. Me përvojën që kishte ai vetë si drejtues dhe me një agronom për të qenë, punët do të shkonin grurë. Pra, e priti me qejf dhe e ndihmoi të sistemohej sa më mirë me banim në fshatin e tij. Mendohej ta njihnte sa më shpejt e në mënyrë sa më të saktë me sektorin.

Njerëzve të mirë u bëhej qejfi që ata të dy kishin të shkuar. Bedriu kurrsesi nuk e shkante ndër mend se midis tyre mund të krijohej ndonjë e çarë.

«Secili ka vendin e vet, s'ka ç't'i lakmojë tjetrit.»

Mirëpo kontradiktat s'kanë të bëjnë vetëm me vendin e punës e rrezikun e zënies së tij. Këtë Bedriu s'e kishte llogaritur fare.

Që në ditët e para ndodhi diçka jo e pëlqyeshme.

... Përgjegjës Bedriu e shpuri kryeagronomin në një parcelë- pllajë që po e sistemonte me merak të madh. Ajo pllajë kishte qenë e ndarë pjesë pjesë, me ledhe e mezhda të shumta, njëlloj si para krijimit të kooperativës. Me pastrimin e ferrave e me rrafshimin e hendeqeve e të mezhdave pllaja i ngjante një koke të madhe të qethur zero.

— S'bëhet më me ekonomi të copëzuara! — tha me mburrje përgjegjës Bedriu. — Kjo parcelë ishte copa-copa sikur akoma qe tokë individësh. Nuk e shihja dot ashtu. As traktor, as kombajnë s'bënin punë në të. Sa për minj e dëmtues të tjerë, mos pyet: Tërë këtu folenë.

Ai qeshi i kënaqur duke fërkuar ballin.

— Gjë e bukur e me leverdi, po gjysma e punës. Përgjegjësi kërkoi të dinte se ç'deshi të thoshte ajo gjysma e punës.

— Zgjerimi i parcelës, prishja e ambientit të përshtatshëm për dëmtuesit e bujqësisë, janë gjëra shumë të mira. Ama kështu si është bërë tani, lihet në mëshirën e forcave të natyrës.

Kryeagronomi sqaroi se forcave të natyrës nuk u duhej lënë fushë veprimi për shkatërrime, përkundrazi, duheshin frenuar.

— Bujqit tanë i kishte mësuar koha të bënin mezhda jo thjesht për të ndarë kufijtë e arave, po për t'i mbrojtur nga erozioni, sidomos për këtë.

Bedriu që pregatitur shpirtërisht për një pëlqim të plotë të kësaj pune, e cila bëhej nën drejtimin e tij. Iu prish qejfi, sido që s'e bëri veten. Kryeagronomi shtoi se tani duheshin bërë mezhda të gjata e të ngushta tejpertej pllajës, në një largësi të çaktuar njëra prej tjetrës.

— Ashtu, po, sipas radhës! — ia mori fjalën përgjegjësi, duke lënë të kuptohej se puna e mezhdave vinte pas rrafshimit të përgjithshëm, pra, jo se ai s'e dinte e s'e vlerësonte rëndësinë e tyre, po sepse akoma s'kishte ardhur radha që ato të bëheshin.

Për kryeagronomin kjo që një përpjekje për t'i bërë bisht së vërtetës dhe i hodhi një shikim të shpejt, jo të zakonit.

«Nuk më besoi! Ndoshta edhe s'më vlerëson!» mendoi tjetri.

Ky mendim i papritur që shkëndija e parë e mërisë së tij ndaj Qemalit, sido që këtë ndjenjë as vetë s'e besonte në hapat e parë të saj.

Një rast tjetër, të cilin përgjegjësi i sektorit nuk

e shmangu dot e nga i cili u thye fare pa e parashkuar, ndodhi në prag të pranverës.

Nëpër ara kishte mbetur një shtresë dëbore si Lymë. Qemali gjeti në magazinë Bedriun që po hahej me fjalë me agronomin e mesëm që ishte edhe brigadier.

— S'ia japim përroit plehun kimik, o kungullësh! Ama shkollë që më ke bërë!

— Mos më fyej, nuk të lejoj të më fyesh! Plehu, në do të dish, tani bën efekt — ngulmoi i riu.

— Si është puna? — ndërhyri Qemali.

Të dy ia ngulën sytë me shpresë kryeagronomit, secili për hesap të vet.

— Kërkon t'ia hedhë plehun kimik grurit! — tha Bedriu. — Sot, kur ujërat venë lumë e dëbora s'ka shkrirë e tëra!

— Ky s'e kupton dobinë — tha i riu. — Shkencërisht...

— Shkencërisht! — përsëriti me përçmim përgjegjësi i sektorit pa e lënë të mbaronte fjalën. Atij i dogji keq edhe fjalëza «ky», edhe ajo «s'e kupton».

— Dale, prit një minutë! — tha Qemali. — Pa hë, ti! — i tha djaloshit.

Ky u skuq pakëz sikur do të merrej në provim.

— Po ajo dihet: Në këtë kohë nitrati i amonit i vlen kallirit, kokrrës, se ndihmon ngritjen e shpejtë të bimës. Më pas vlen kryesisht për kërcellin. Shkencërisht unë kështu e di se është. Dhe, natyrisht, ne më parë duam grurë e pastaj kashtë.

— Shkencërisht, shkencërisht! Shkenca në kënkën tënde mbeti!

— E ka mirë ai! — pranoi menjëherë Qemali.

Përgjegjësi këtë s'e priste fare. Një çast ngeli mëdyshas, pastaj turfulloi:

— Mirë, meqë edhe ti i jep hak, bëni si të doni!  
Ama do të mbani përgjegjësi, ta dini!

Dhe iku i zemëruar. Dy të tjerët e panë me keqardhje tek largohej me hapa nervozë.

— S'ke ç'i bën! — tha kryeagronomi. — Po do të kalojë — shtoi.

Ai shkoi pas tij. Diku e arriti. Bënë një copë udhë pa thënë asnjë fjalë. Vajtën në zyrë. U ulën karshi njëri-tjetrit, po prapë s'folën. Qemali s'dinte nga t'ia niste. Deshi t'i fliste. Kishte ç'ti thoshte. I vinte keq që ai ishte nxehur fare kot. Jo fare kot, xhanëm, Qemali e kuptonte edhe shkakun dhe më tepër për këtë kërkonte t'i fliste. Që të mos majiste më keq kjo punë. Sa më parë, aq më mirë.

Përgjegjësi bënte sikur s'e vinte re fare praninë e agronomit. Mori një dosje me evidenca e po i shikonte si i përqëndruar i tëri në to. Cigarja e tij vinte oxhak e dëshmonte disi për të kundërtën.

— Je i sigurt që ai ka të drejtë? — pyeti pa e ngritur kokën nga dosja.

— Plotësisht.

— Unë jo. Po kjo është tjetër gjë. Nëse ti je i bindur, s'mund të ma thoshe me një farë marifeti, po ashtu, bram, para një djalurçine? Ç'më mbetet mua si përgjegjës që jam, po qe se ti ma nxjerr bojën kësisoj?

— E vërteta është e thjeshtë e thuhet haptazi. Ajo askujt s'i bën keq, veçse së keqes.

— Dhe të keqit, mos deshe të thuash?

— Së keqes, thashë.

— Domethënë...

Bedriu s'e mbaroi mendimin. Qemali e shikonte ngultas dhe kështu e pa gjatë.

— S'të kam pyetur: Pse s'e ke kryer teknikumin

bujqësor të mbrëmjes, Bedri? Fare afër e keni shkollën.

Bedriu e la kalemin dhe mbështeti bërrylat në tryezë. Këtë pyetje nuk e priste fare, dhe kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend se mund t'ia bënte njeri. Rrudhi vetullat i mërzitur, por, meqë pyetja do përgjigje, ai nuk e pa me vend t'i shmangej.

— S'kam pasur kohë. Ne po sakrifikojmë veten për kooperativën, nuk na lë puna. Po mbase e teproj e duket si lëvdatë, edhe mukaet s'jam bërë — tha me përtesë e si me mospërfillje.

— Ti je akoma i ri, kuadër që e do kooperativën, bujqësinë e ke me qejf, mund ta vazhdosh edhe tani. Në do ndihmën time, jam tërësisht i gatshëm të ta jap.

Përgjegjësi i shtyu evidencat në dosje dhe këtë e rrsi në dollap. E mbante veten për njohës të mirë të bujqësisë, njeri që kishte shumë praktikë e që kishte lexuar vazhdimisht, por, që t'i kthehej teknikumit tani ai, kuadër me rëndësi i një kooperative të madhe e burrë në vaktit, këtë s'e kishte shkuar ndër mend dhe nga ana e kryeagronomit iu duk guxim i, tepruar ky, fyerje për personalitetin e tij.

— Ti s'më çmon mua as sa një teknikumas? — pyeti e u ngrit.

— Nuk shtrohet kështu çështja. Megjithatë, ti duhet ta kuptosh vetë: Përvojë ke, njohuritë e duhura jo. Teknikumi për ty do të qe shumë i vlefshëm.

— Unë kam lexuar e lexoj «Bujqësinë socialiste», broshurat e gazetat, kam bërë kaq shumë seminare për probleme të bujqësisë...

— S'mjafton. Duhet me themel. Bujqësia intensive kërkon njohuri shkencore të qëndrueshme e të thella.

— Shkencore,,shkençërisht... Domethënë ti s'më  
vë barabar me atë teknikumasin mua? Faleminderit!  
— tha përgjegjësi me ironi e tundi kokën i prekur  
në sedër.

Atë ditë deri këtu e s'eci më tej biseda midis  
tyre.

Më tej Bedriu zuri t'i druhej kryeagronomit.  
Nuk desh të fyhej rishtazi, nuk desh të krijoheshin  
situata, në të cilat mund të bënin fjalë. Kjo s'do të qe  
rë të mirë të punës e as të marrëdhënieve midis tyre.  
Përgjegjësi i sektorit përpiquej t'i zgjidhte problemet  
pa zhurmë e pa ndërhyrjen e të tjerëve. Ai e donte  
me gjithë shpirt kooperativën dhe çdo acarim ndër-  
mjet kuadrove i dukej se e dëmtonte rëndë atë.

Tani gjithnjë e më shumë po i rritej në vetvete  
një ndjenjë frike për rënien e personalitetit të tij.  
Tani nuk qe kurrë plotësisht i qetë. Para ardhjes së  
agronomit i shkante fjala kudo, i shkante e i çmohej,  
punonte ditë e natë e s'lodhej kurrë e ishte gjithë i  
kënaqur; kurse agronomi sikur po e cungonte, sikur  
po ia ngushtonte rolin si drejtues, po ia kufizonte  
kompetencat. Duke iu druajtur, i bëhej se nga dita  
në ditë i jepte terren, ndërsa vetë po tërhiquej e po  
tërhiquej, po zvogëlohej e po zvogëlohej...

Për këtë arsye prania e tij kudo e kurdoherë e  
ngacmonte keq.

### 3.

Këto i sillte në mendje Bedriu, duke ecur rru-  
gës së fshatit i vendosur që të takonte kryeagrono-  
min, të bënte përpjekje për të shkukur disi atë dreg  
drojtjeje.

Në magazinën e sektorit ishte vërtet Qemali së bashku me një brigadier të arave e nja dy kooperativistë, të cilët po merrnin farë për ta mbjellë.

— Si pak më duket — tha brigadieri.

— Aq sa duhet.

— Pak më duket edhe mua — tha njëri nga kooperativistët. — Kush kursen farën, hap qesen. Ne jemi mësuar denbabaden të hedhim aq sa në një gjurmë kau të bien shtatë koqe gruri.

— Mos u bëj merak — e qetësoi agronomi. — Ky është grurë me vëllazërim të shumtë.

— Ja, kemi edhe përgjegjësin këtu. Kush kursen farën, djalë, hap qesen për të blerë pastaj, them unë.

Duke u përpyetur të ishte i paanshëm, Bedriu tha se kryeagronomi e dinte më mirë këtë punë, prandaj, ashtu si thoshte ai, të bëhej. Bisedën e kishte ndjekur me kujdes dhe për çudi se pse i erdhi keq për kooperativistin, i cili s'lëshonte pe, edhe pse nuk e njihte fare grurin që do të mbillej. Ky ishte një varietet i ri, të cilin Qemali do ta eksperimentonte në një hektar vend.

Ndërkohë në magazinë arriti një «Zis» ngarkuar me thashë.

— Grurë fare e ke? — e pyeti magazinieri shoferin.

— Tamam.

Qemali zgjidhi thesin e parë e i futi duart në grurin e porsaardhur.

— Ç'farë është kjo? — pyeti Bedriu.

— «Strampeli.»

— «Strampeli?»

— Njihet edhe me emrin «Lushnja.» Jep rendimente të larta.



— Nuk di të kemi porositur të tillë farë. Mos është bërë ndonjë gabim.

— E kam porositur unë.

— Aha!... E po.

— Çfarë?

— Unë s'di gjë dhe fare pa dijeninë time vjen të shkarkohet këtu një makinë e tërë me një farë gruri të panjohur. Ç'jam unë këtu.

— Ke të drejtë në një farë mase. Po kjo s'është kryesorja.

— E cila na qenka kryesorja? Hu gardhi jam unë këtu?

— Mos kapemi pas fjalëve, shoku Bedri. Kështu bëjnë njerëzit me sedër të sëmurë. Unë po të shpjegoj...

— A, jo, jo! Secili në vendin e vet e deri ku i arrin!

— Mirë, atëherë! Edhe unë kam vendin tim. S'ta mbush syrin ty? Për farën përgjigjem në radhë të parë unë. Ky është vendi im!

Qe një shpërthim që përgjegjësia e habiti. Ai s'qe mësuar t'i kundërshtonin kështu. Asnjëri. Edhe vetë kryetari nuk i fliste në këtë mënyrë, madje kishte respekt për të; kurse ky... ky s'e pyeste hiç dhe kërcente si gjel!

— Dëgjo, mor djalë. Njeri s'ta prek vendin e përgjegjësia, ama unë jam në krye të këtij sektori e duhet të di se ç'bëhet këtu ku drejtoj.

— Sigurisht.

— Atëherë?

— Unë të thashë që ke të drejtë, po ti s'më le ta mbaroja fjalën, s'do të më kuptosh.

— Të drejtë kam, po për të marrë s'kam.

Kryeagronomi e pa në sy, rrudhi vetullat e i

ktheu shpinën. E dinte se e kishte shkelur disi nga ana formale. Për ca njerëz ka rëndësi kjo gjë, po këtu s'qe fjala vetëm për këtë.

Disa ditë më parë ai qe ndodhur në depon e farërave dhe kishte përfituar nga kjo për të tërhequr një sasi fare «Strampeli», të cilën e pati kërkuar më se një herë. Ishte mjaftuar me një bisedë telefonike me kryetarin.

« — A ia vlen? — kishte pyetur ky.

— Shumë.

— Kush do ta eksperimentojë?

— Unë.

— Mirë, merr!»

Dhe, për këtë punë të nisur me kaq qejf, tani përgjegjësi i sektorit po i nxirrte ngatërresa. Pse disave mirë të bësh, keq u duket? Pse vënë së pari anën formale e jo brendinë e çështjës?

Përgjegjësi ose i druhej, ose s'e kuptonte. Ky s'qe rasti i vetëm. Mirëpo kështu kurrë s'mund të thellohesh në problemet e punës. A mund të ecej përpara me moskuptime të këtij lloji?

I shkonte këto ndër mend kryeagronomi dhe i vinte keq e inat. Tanimë marrëdhëniet midis tyre kishin arritur një pikë të tillë që edhe i mënjanoheshin ballafaqimit, edhe e kërkonin atë, si një nevojë pa të cilën s'bënin dot.

— Në fund të fundit eksperimenti është provë, apo jo? Kurse plani s'është provë, po detyrë që duhet plotësuar. Kush na shtrëngon ne t'i hyjmë së papriturës, kur s'jemi keq edhe kështu si jemi? Veç në na shtrëngoftë e mira.

— Ka edhe më mirë.

— Shejtani fle, ne duam ta zgjojmë, i thonë kë-

saj. E di se rrezikohet plani me shumë lloj eksperimentesh? Ne po bëjmë një në grurë.

— Përkundrazi, plani do të tejkalohet.

— Po më habit. Ç'na shtrëngon, bre, ç'na shtrëngon? Keq jemi?

— Duhet të jemi më mirë. Ka mundësi e do të jemi.

— Kur qenke kaq i vendosur e i sigurt, po të jap një hektar tjetër ta eksperimentosh me këtë «Strampelin» tënd që dreqi e di nga e gjete.

— Duhet 40 hektarë.

— Vetëm në sektorin tim?

— Në sektorin tonë.

Bedriu bëri sikur s'e vuri re ndreqjen e fjalës.

— Mua s'më ka marrë koka erë. Kjo s'bëhet!

— Po!

— Jo!

E panë njëri-tjetrin në sy. Ishin të dy tepër të vendosur, secili në të tijën, dhe e kuptuan që nuk do të merreshin vesh lehtë.

#### 4.

Në mbrëmje, shtrirë në shtratin e tij me duart nën zverk, Qemali mendohej.

«T'i them kryetarit? Ta bëj problem të kryesisë?»

Edhe kështu mund të pënte. Edhe vetë mund të ngulte këmbë me të drejtën që i jepte detyra. Por...

Asnjëherë s'i kishte qëlluar t'i ankohej njeriut. Asnjëherë e për asgjë. Jo se s'kishte pasur rast, se të tilla krijohen sa të duash në jetën e njeriut. Kur ishte i vogël, u zu një herë me një shok e vajti duke

qarë në shtëpi që të kërkonte ndihmë për t'ia marrë hakun.

«Ç'ke? Të rrahu ai? Hë, po ti përse i ke duart, veç për copën e bukës? Ptu! Qaraman! Vetëm kështu mos të të shoh!»

Pas këtyre fjalëve i ati ia kishte kërcitur me një shuplakë të fortë. Kjo i ngeli në kujtesë si një gozhdë e madhe, mbërthyer në një tra të shëndoshë.

«Po pse, pse të na ndodhin këto?»

Bedriu nuk qe njeri i keq. Punëtor e i papërtuar atë e takoje tërë ditën duke u marrë me gjithfarë punësh, të kooperativës, të cilat janë aq të ndryshme.

«S'ka fituar kulturën e duhur shkencore. Kjo është e tëra. Më e keqja, këtë gjë s'e kupton a s'do ta kuptojë, mbase e gënjen mendja se e ka. Mirëpo gjysmaku mendjemadh është më i dëmshëm se injoranti, se këtij të paktën i thua e të dëgjjon, bën si e mëson...

Po jo, Bedriu sikur ka zënë ta shohë hendekun. E, në vend që të marrë sulm e ta kapërcjë, mbyll sytë e thotë se s'ka hendek. Ky është fillimi i një drame, që, pa marrë masa, një ditë kthehet në tragjedi shpirtërore. Se një ditë do t'i hapë sytë, ndryshe s'ka si të bëhet!»

Kjo hamendje e shqetësoi. U ngrit, veshi xhaketën e doli.

Nata ishte e errët, e qetë dhe e freskët, gati e ftohtë. Nga udha tutje vinte buçima e fuqishme e traktorit dhe kur e kur ca fasha drite të projektorëve të tij. Ai ecte ngadalë i menduar. Në çdo qoshe i binte nga lart drita e llambave elektrike.

Disi e kishte bërë me mend se ku do të vinte. Këmbët gati vetiu e shpunë në shtëpinë e përgjegjë-

sit të sektorit. Trokiti e priti. Bedriu vetë doli e ia hapi portën.

— Ti qenke! Hë?

Bedriu mbeti me portën gjysmë të hapur.

— Erdha të shoh ndonjë gjë në televizor, se s'më flihej e as nuk shtrohesha dot për të lexuar. Apo do të flini ju?

— Jo, hajde.

Gruaja dhe fëmijët e Bedriut kishin rënë për të fjetur. Televizorin po e shikonin nja dy fshatarë të moshuar. Si mbaruan lajmet, u ngritën e shkuan edhe ata. Bedriu i përcolli gjer në oborr. Qemali vazhdonte të pinte duhan gjoja i përqëndruar në programin e televizorit. Në të vërtetë ai po mendonte si e nga t'ia niste. Natyrisht edhe Bedriu nuk e mori aspak si një dëshirë për të shkuar kohën ardhjen e agronomit. I kishte ardhur në shtëpi. Përse vallë? Ç'do t'i thoshte. Si duhej të sillej ai këtej e tutje me këtë njeri? Kur dikush, me të cilin s'shkon mirë, të vjen në shtëpi në këtë mënyrë, s'është gjë e rastit...

Asnjëri s'po fliste. Bedriu kur e kur kollitej për ta shkukur atë drojtjen shtrënguese.

— Unë them ta shoshitim punën. Nuk më pëlqen të grindemi — tha Qemali sikur biseda midis tyre të mos kishte reshtur fare.

— As mua.

— Të dy në një qafë duam të dalim, atëherë le të shohim nga e si delet më mirë e më shpejt... Që s'të pyetëm, ti ke të drejtë. Po kjo është e dorës së dytë.

— Eksperiment me 40 ha tokë s'lejoj unë. Kjo s'është shaka. Shkencërisht, shkencërisht thua ti,

por edhe ne bar s'kemi ngrënë. Gjithnjë të dalluar kemi qenë në rendimente. Ç'na shtrëngon tani?

— Nga ne kërkohet shumë më tepër. Sektori ynë ka palcën e tokës.

— Llafet e tepërta janë fukarallëk, o djalë. Sa për mua, o 1 ha për provë, o të m'i heqin nga plani ata 40 ha dhe ti pastaj bëj ç'të duash me ta! Në provë s'e vë planin unë, kur e di se do ta realizoj.

— Në të vërtetë këtu s'është fjala për provë në kuptimin që e merr ti. A thua s'e kam studjuar këtë punë unë? Kam parë përbërjen e tokës në laborator, kam...

— Ashtu, ashtu, po unë për veten time s'e di ç'del. Po dha rezultat, mirë, por, po të mos japë? Ja, do të të kritikojmë, do të marrim masa; ama depoja s'mbushet as me kritika e autokritika, as me masa ndëshkimore. Do grurë ajo! Nuk turpërohem tani unë, pas kaq vjet suksesesh.

— Kësaj i thonë të ruash ekuilibrin.

Bedriu lëvizi nga vendi.

— Mos u nxeh, duro! Kësaj i thonë frikë. Shqip, frikë. Sipas teje ecet veç në rrugë të njohura, horizontale. Kurse, për të përparuar, duhet edhe të kërcesh, të hidhesh.

— Me mend në kokë.

— Varet si ta kuptosh këtë. Ndonjëherë «me mend në kokë» i thonë ngecje në vend.

— E po, meqë na këshillon t'i vihemi shkollës së mbrëmjes...

— Unë s'e kisha me të tallur. Pa dijeni të shëndosha, s'ka bujqësi intensive, vetëm ato, dijenitë e guximi për t'i vënë në jetë, e zhdukin frikën e së papriturës, të së paprovuarës.

— Je i ri e s'po t'i marr për shumë. Edhe s'bën si kuadër të merrem me anën personale të çështjes. Ama ti po më fyen rëndë. Unë jam kuadër, o djalë, që me krijimin e kooperativës, mbase që kur ti akoma s'ishe lindur. Dhe gjithnjë kam qenë i nderuar, vetëm tani për ty...

Qemali ngriti supet si për të kërkuar ndjesë.

— A t'i mohoi njeri meritat? Ne po flasim për një problem pune. Sa për atë që the, me sa di unë, ai që rëndom mburret me të kaluarën, nuk sheh mundësi për të ecur po në atë mënyrë në të tashmen e në të ardhshmen, pra, ka ngelur në vend. Nuk më pëlqen që ti të jesh i tillë, ndryshe s'do të bëhesha fare merak e s'do të të flisja për këto gjëra. A duhet t'i rritim më tej rendimentet?

— Patjetër.

— Ja, tërë puna këtu qëndron. Me hezitime s'ka rritje.

— Edhe rritja ka një kufi. Ky «Strampeli» yt mund ta rritë ose jo, po një kufi ka.

— Rritja s'ka kufi. Kjo arrihet me varietete të reja, me studime të thella...

Bedriu e pa me një farë qesëndie. Ky djalosh kishte marrë si shumë revan.

— Mua më duket se te ne nuk punohet keq. Kulturave u bëhen mirë shërbimet. Këta njerëz janë, kjo tokë është. Diçka më tepër edhe mund të japë, por, pa kufi...

— Vetëkënaqësia është sëmundje e rrezikshme. Më fal që e përmend, po s'duhet ta lëmë veten të na mbulojë. Ti thua se këtu punohet mirë. E pranoj, sido që edhe më mirë mund të punohet. E zëmë se puna bëhet shembulllore, toka jep maksimalen e prodhimit. Po më tej?

Bedriu mblodhi buzët i habitur.

— Çfarë më tej? Po të bëhet kjo, kjo është e gjitha.

— Shkohet edhe më tej — nxitoi të pohonte agronomi. — Unë këtë synoj dhe dua që ti të më kuptosh drejt. Rritja e rendimentit të tokës përtej asaj që duket maksimale në kushte të njohura, bëhet me varietete më produktive, me plehrimin në kohën e në masën e duhur dhe me faktorë të tjerë të llogaritur shkencërisht. Këto për ne përbëjnë atë që në atletikë e quajnë kërcim teknik.

— Kërcim teknik! — Bedriu qeshi e tundi kokën, me sa duket i kishte pëlqyer kjo shprehje.

— Mirëpo kërcimi s'bëhet pa rrezikuar qetësinë që të mbërthen në vend, pa rrëzuar sedrën e sëmurë që të rri si mburojë. «Strampeli» është grurë që e ka provuar epërsinë e tij. Me hala, rezistent ndaj ndryshkut, me ngritje të vonshme të hershme, dimri e gjen jo të hedhur shumë, pranvera të gatshëm për t'u rritur shpejt. Jep 11 kv më shumë se «Myzeqeja,» fjala vjen... me këtë farë fituan garën ata të kooperativës «1 Maji» vitin që shkoi.

Bedriu brente me dhëmbë një copë kalem me vështrim të ngulitur në fytyrën e pastër e të shëndetshme të kryeagronomit. Befas iu bë se diçka u shemb përbrenda tij. Ç'kishte ndodhur? Ç'ishte kjo shembje? Në tërë acarimet me Qemalin paskësh ndier gjithnjë shkundjet e saj, tani shembjen vetë.

Qemali fliste ngadalë, i qetë, i sigurt. Pa dyshim këtë siguri ia jepte dija shkencore. Bedriu kujtonte se ato i kishte edhe ai. Po në këtë çast i ndiente të rrëzuara përtokë, të pafuqishme. Dhe kjo qe shembja.

Njeriu që njuh papritur një dobësi të tij në atë



pikë që ka qenë i bindur për të kundërtën, pëson një tronditje të fortë, të madhe, tronditjen e zhgënjimit.

Këtë po provonte Bedriu, përgjegjësi i sektorit. Doli në hajat e u kthye, piu një gotë ujë, shëtiti nëpër dhomë. Cigaren e shpinte oxhak.

— Mirë, de, prej teje s'kërkohet të kesh njohuritë e një specialisti. Perspektivën, po, atë të takon ta njohësh e ta vlerësosh dhe kjo bëhet jo me llafe, jo me të nxjerrë gjoksin, as me kryeneçësi, po duke ulur kokën mbi libra e duke dëgjuar edhe mendimin e atyre që kanë zbardhur sytë mbi ta dhe të atyre që i kanë provuar. Se s'ka kërcim teknik pa teknikë!

Bedriu qëndroi e pa në sy ngultas, vrerët. E flaku bishtin e cigares e iu vu sërish shëtitjes nëpër dhomë.

— Ndize edhe një! — tha Qemali e i zgjati paqetën.

Bedriu u ndal para tij, mori një cigare dhe afroi fytyrën për ta ndezur në çakmakun që kryeagronomi i shkrepiti me dorën tjetër.

## BARDHËSI NË DITË TË BARDHA

Shega bëri si bëri dhe e takoi djalin, me të cilin donin ta fejonin. E pa dhe i pëlqeu. Gurja nuk ishte i moshuar, as i shëmtuar, përkundrazi djalë i ri, i fortë e i pashëm dhe, siç thoshte e ëma, punëtor i zoti e i papërtuar. Edhe Shega ishte e re, e bukur, e shëndetshme, si vajzë malësore, kishte mbaruar edhe shkollën shtatëvjeçare.

Pastaj erdhi dasma, shtëpi e re, njerëz të rinj e një farë ankthi në zemrën e saj: Si do të ishte ai? A do të ishte ashtu si e krijoi ajo përshtypjen në takimin e parë? Si do të ishin ata, njerëzit e tij?

Shkonin ditët, ankthi në zemrën e nuses së re shkëputej ca nga ca dhe po kështu ca nga ca hynte në të një ndjenjë e ngrohtë e e ëmbël. Nuk i kishte provuar Shega të rrahurat e zemrës nga dashuria. Por ajo ndjenjë e ngrohtë dhe e ëmbël që ia përshkonte tërë trupin valë-valë kur ndodhej pranë tij a kur mendonte për të, ç'të ishte vallë? Ndoshta ishte vetë dashuria. Edhe Gurja provonte të tilla ndjenja. Por ai shpesh rrinte si i shupëlitur, sikur trembej mos ia zbulonte njeri ndjenjat e mendimet. Shegës i vinte keq për të, i dhimbsej tek e shihte ashtu. Pse kështu, pse?

I kujtohet nata e parë kur mbetën fare vetëm. Ai kishte turp jo më pak se ajo. Ndonjëherë, përsëri kur mbeteshin vetëm, atij i zbutej zëri, shikimi, i zbuteshin tiparet e fytyrës, lëvizjet. I fluturonte zemra Shegës në ato çaste. Po në prani të të tjerëve Gurja ngrysej në fytyrë e rrinte si i kontraktuar dhe kurrë nuk i fliste në emër.

Njëherë ajo lante rrobat në oborr. Gurja kishte ndonjë punë me të e i thirri: «Moj, moj!» Shegës nuk i erdhi mirë që ai iu drejtua me këtë «moj» dhe i shkrepri në kokë të mos i përgjigjej derisa ai t'i fliste në emër. Ai «Moj, moj!» e ajo bënte sikur nuk dëgjonte, as i përgjigjej, as kokën kthente. Ndoshta Gurja u kujtua ose i shkau, kushedi:

«Shegë, moj! Ty të them!» i mëshoi zërit.

Atëherë Shega kishte drejtuar trupin e i qe përgjigjur buzagaz. Kishte tingëlluar bukur emri i saj në gojën e tij. I kishte pëlqyer së tepërmi. Po kënaqësia qe e shkurtër, në krye të shkallëve kishte dalë e vjehrra. Ajo u kishte hedhur një vështrim qortues, djali ishte skuqur i turpëruar. Shegës i ishte shtrënguar zemra e kishte ulur kokën mbi govatë. Pse kështu, pse?

«Edhe ai duhet ta mendojë veten. Nuk është e tij kjo sjellje as e afërt, as e largët. Kështu duhet, vallë? Kjo është marrëdhënia burrë-grua, afrim natën e drojtje ditën sikur ke bërë ndonjë faj? Vjehrra thotë se qëmoti burrë e grua as sytë nuk guxonin t'ia hidhnin njëri-tjetrit e jo më t'i flitnin në emër. Po si bënin vallë? Eh, po... qëmoti si qëmoti!...»

Sytë Gurja ia hidhte. Shega e vinte re. Ai më parë sigurohej se mos e shikonte njeri dhe pastaj e vështronte butë e ëmbël, gjithë më butë e më ëmbël. Ai e donte, kjo dukej. Po pse sikur trembej nga

dashuria? Të vjedhur e kishin? Ai ishte njeriu më i afërt për të, pse nuk guxonte ta shprehte sheshit këtë të vërtetë kaq të thjeshtë?

Në këto pyetje ankthi sikur kapej me thonj e s'donte të shkëputej përgjithnjë, madje ndonjëherë egërsohej, merrte sulm e ia shtrydhte tërë zemrën, ndjenjat, tërë trupin.

Një mbrëmje... Po këtë do ta tregojmë më pas.

\*  
\*  
\*

Dy muaj pas martesës babai e thirri Guren e i tha:

— Merr torbën me çekanin e mistrinë e shko me shokët. Mjaft u argalise me nusen. Dimri po vjen e para s'kemi.

Gurja shkoi. Shega mbeti me prindërit e tij. I dukej se ishte fare vetëm. E vjehrra e mësoi si të vepronte tani, që s'e kishte burrin. Duhej ta mbante veten sa më keq që të ishte e mundur (ashtu duhej të bënte një nuse e re në të tilla raste). Shega ashtu bëri, por i bëhej se ishte e përçmuar, e lënë, kishte zënë të mos e donte as ajo vetë veten e saj në këtë gjendje shëmtie. Rrallë fliste, se rrallë i kërkoheshin fliste.

Kur vinte mbrëmja, tërhiqej në dhomën e saj. Dhoma i dukej e ftohtë, e madhe. Shega mbështillej e tëra me jorgan sikur t'u fshihej errësirës, të ftohtit e boshllëkut. Mblidhej kruspull e jepej pas kujtimeve. Një mbrëmje nuk i ndahej asnjëherë nga kujtimet. Sa herë e sillte ndër mend, e shtrëngonte ngërçi e i vinte për të qarë. Gjumi i terratisesh e

vërtitej e mblidhej edhe më. Oh, kjo jeta e nuseve të shkreta! Prandaj kishte dalë ajo kënga e moçme e dhimbshme:

*...Më iku bandilli, më iku natën,  
nuk e pikasa t'i shkruaja kartën,  
t'i shkruaja kartën, t'i vija gishtin,  
kur ta këndonte, t'i këputte shpirtin...*

Thoshte kështu, kujtonte këto e mallëngjehej e bënte çmos t'u jepte udhë mendimeve e përfytyrimeve. Përpiquej të sillte ndër mend bisedat me shoqet për këto gjëra. Ja, mësuesja, mamia, biseda të shkëputura me to.

«E kanë mirë ato, e kanë lehtë, pse të mos thonë. Atyre s'u kanoset njeri kur kthehen në shtëpi. Ato rrinë gjithnjë të lara e të krehura, vishen bukur, të pëlqen t'i shohësh, por asnjeri s'u thotë gjë. Asnjeri?! Edhe për to folën, por... ato s'ua vunë veshin fjalëve. Pastaj fshati u mësua t'i shihte ashtu...»

Ngacmime gjithandej. Sa e qetë në dukje, aq e shqetësuar përbrenda. Po si t'ia bënte?



— Moj nussee!

Shega hidhet përpjetë. Thirrja i erdhi kaq papritur e iu duk sikur e zuri njeri në faj, meqë po mendonte e përfytyronte për këto gjëra.

«E dobët, fuqi s'ka, pse thërret kaq shumë? Pse ky stërmundim në të thirrur fort?»

Shegës i vjen keq e inat njëkohësisht.

— Erdha! Erdha! — tha.

Dhe vajti menjëherë.

— Më doli mendsh të të thosha qëpári, moj nuse. Erdhi Sefiu. Gurka është shëndoshë e mirë. Edhe ay do të vijë së shpejti. Kështu tha Sefiu. Po e thotë edhe vetë Gurka, se ka shkruar kartë, e këndoi Myrtua.

Shega dëgjon kokulur. Zemra i rreh, faqet i skuqen, po për të folur s'flet e as kokën e ngre.

«Paska dërguar letër! Dhe e lexoi Myrtua, sikur unë jam pa shkollë. Po mua të mos më ketë shkruar... Që s'u ndodha këtu! ...Por, meqë ka për të ardhur vetë...»

— Ka dërguar edhe një qese me kështu, si u thonë de, s'ua sjell në hatër emrin. Na, merr një!

Shega hap sytë. Janë ca pemë që s'i ka parë ndonjëherë. Po shpejt e mbledh veten e atëherë të kuqtë e mbulon deri te veshët. I ndizet fytyra, i rreh edhe më zemra. Me dorë të dredhur merr atë kokërr të kuqe e të madhe si mollë. E shtrëngon në dorë e ndien se nga plogështia e, ca çasteve të mëparshme s'i ka mbetur gjë prej gjëje, si t'ia kishte hequr njeri me dorë. Tani, e tronditur e me një gëzim në zemër, ndihet si e vogël, e brishtë, po më e fortë.

E di Shega ç'është ajo, e merr me mend si quhet, është e sigurt që s'gabon. Se diçka e këndshme lidhet me të e s'ka si të jetë ndryshe.

Nusja shpejton të shkojë në dhomë. Kjo ndodhi e vogël e papritur, është një gjë e madhe, një gjë që e prish ekuilibrin e mërzitshëm të nuses së re. A ka gjë tjetër për t'i thënë e vjehrra? Shega ngre kokën e shikon. Jo, s'ka. Sa mirë që e vjehrra s'paska më punë me të! Tani edhe punët e tjera Shega i ka mbaruar e mund t'i kushtohet vetes një copë herë.

Disa çaste edhe atje, në dhomën e saj, nuk qetohet dot. Zemra gjithë i rreh me vrull, faqet i digjen, zjarrin e ka përbrenda e ushqimi i tij është tek ajo kokërr peme që mban në dorë.

— Kjo qenka shega! — pëshpërit ajo, duke e fërkuar në dorë atë kokërr që ia ka dërguar i shoqi që larg.

Pema shegë ka të bëjë me kujtimin e asaj mbrëmjeje të këndshme. Shega s'e kishte parë kurrë të shoqin si atë natë. Ai asnjëherë deri atëherë s'i kishte thënë fjalë aq përkëdhelëse, asnjëherë s'e kishte përkëdhelur aq shpënguar. Drojtja e ashpërsia atë natë s'ndiheshin fare, fare.

«Ti i ke faqet si shegë e pjekur. Shegët janë si kumbullat, jo më të mëdha si drurë. Kokrrat spikatin midis gjetheve. Kanë bukuri të madhe fletët tepër të gjelbra e si me lustër, po ca më shumë kokrrat e paqme e të kuqe. Sa më tepër piqen, aq më të kuqe bëhen. Një të kuq si i egër, po shumë joshës. Kur dielli nxeh paq, lëvozhga e shegës çahet e këkrrat e brendshme si rruaza, gjak të kuqe e me zemër të bardhë, të joshin ca më tepër. Si këto faqet e tua që çahen te buzët!»

Shegën e mbështillte një ngrohtësi e madhe, e madhe, që ia zgjeronte zemrën, kraharorin; i bëhej se do të shkrinte e tëra nga kënaqësia. Ai ia puthte sytë, faqet, gushën. Si e dehur e kishte puthur edhe ajo. Ai kishte qëndruar dhe e kishte parë me habi.

«Të jesh e përmbajtur, mos bësh si e tërbuar si... se burri dyshon, se...»

Shega ishte dredhur, kur kishte, sjellë ndër mend këtë këshillë. Por ai kishte qeshur, e kishte shtrënguar më fort dhe Shega përsëri mend kishte qarë nga kënaqësia.

«Ti je shegë, tamam shegë!»

«Kaq e mirë të jetë shega? Sa mirë që ma kanë vënë këtë emër!» thoshte me vete...

Shega e fërkon në duar shegën që i ka dërguar i shoqi. S'e paska harruar atë natë! Domethënë e sillte ndër mend! Ndryshe s'kishte pse t'i dërgonte ato pemë. Ai i kishte dërguar posaçërisht për të. Se në Opar askush e asnjëherë mbase s'e kishte parë të udhës të dërgonte shegë, që andej s'njiheshin...

E shikon mbarë e prapë me kujdes dhe e gjen pikërisht si ia ka përshkruar ai.

«Ti je shegë...»

Shega afrohet në pasqyrë dhe e vështron veten. Sy të zes e të gjallë, të bukur, faqet të mbushura, fytyrë e kuqe, e shëndetshme. Sytë i ka shumë të gjallë, shumë të pastër, shumë të bukur, faqet disi të lerosura. Një cullufe flokësh, kërklicë të zes e drizë të pakrehura, del prej shamisë. Shega e zgjidh dhe e heq fare shaminë. Flokët e pakrehur e të pluhurosur ngjajnë me paruke plakash. Sa në kontrast janë me vështrimin e ëmbël e të butë të syve të zes! E pllakosin dhe e fundosin fare bukurinë e gjallërinë, shëndetin e saj. Shega mbyll sytë. Nuk e ka përfytyruar dot në asnjë mënyrë se mund të duket kaq e shëmtuar. Që ishte e bukur, këtë e dinte, edhe Gurka ia kishte thënë.

Sheh në pasqyrë e tmerrohet. Fërkon sytë e shkundet. I bëhet se s'është fare në vete.

Po sikur të vinte tani ai? A do ta quante më shegë? Kështu si qe bërë ajo, atij nuk do t'i kujtohej fare ky krahasim. Ai do të zinte sytë me dorë duke parë si ishte katandisur nusja e tij e bukur...

Shega bëri një tjetër përpjekje për ta përmbajtur veten. Kokrra e shegës që mbante në dorë, i bë-



hej se e vinte në lojë. Ngadalë, me shumë kujdes, e vendosi atë mbi vatër. Pastaj u ul në shtrat e menduar, duke folur me vete.

«Është e habitshme. Në fshat janë bërë kaq shumë ndryshime. Vetë prindërit e tim shoqi e quajnë ndryshimin të pakrahasueshëm me të kaluarën nga të gjitha anët. Në shtëpinë tonë, që të mos shkojmë më tej, sa gjëra të reja kanë hyrë! Dhomat i lyem me gëlqere e ndritin nga bardhësia, karrige blemë, bukë hamë secili në pjatë më vete, edhe plaçka për të veshur shtëpinë kemi. Vetëm dy gjëra kanë mbetur si më parë: Shkuarja e burrave në punë larg fshatit dhe ky zakon përçmues që ne të rrimë si mos më keq gjersa të kthehen ata. Se ndryshe biem në sy e na vardisen të tjerët. Pse, nuk e kemi veten në dorë ne? Nuk e zotërojmë vetëm, po varet nëse do të biem në sy apo jo? Çudi, e madhe!»

Kur thellohej më tepër, ajo vinte re se edhe në këtë anë ndryshime ishin bërë, po pak, kurse kishte ardhur koha që të përmbyseshin këto. Mësuesja e mamia, të dyja nga fshati, moshatare me Shegën, të martuara edhe ato, kur u iknin burrat larg për sado kohë, as që i ndryshonin fare veshjen e kujdesin për trupin e tyre. Në fillim folën për to, por ato s'ua vunë veshin fjalëve. Dhe, duke qenë se ato s'u përkulën, zakoni vuri një melhem në të çarën e parë. «Mësuesja e mamia janë me rrogë, në punë të shtetit, s'kanë si të bëjnë ato, se kështu ua do puna.» Kështu thanë në fshat për to e s'i nganë më.

Shega shpesh bisedonte me të dyja. Ato e donin atë dhe vinin dhe e takonin dendur. Njëherë i kishte thënë se zakoni përçmues për femrën s'mund

të shkonte më tej dhe ishte punë e nuseve si Shega që t'i vinin drunë përgjithnjë. Tani do të ngrihej edhe kooperativa e burrat s'do të vinin më poshtë e lart për punë, jeta do të sigurohej me punë në fshat; po zakoni duhej flakur edhe më parë, s'kishte ç'pritej më.

«Kur vjen koha, thoshin ato, bëhen ndryshimet, prishen edhe zakonet e vjetra të këqija e krijohen zakone të reja të përshtatshme me përparimin që ka sjellë Partia. Kështu edhe me këtë.»

Shega u jepte të drejtë, po ja që kjo s'qe e lehtë.

«Ato e kanë mirë. Ky zakon s'rëndon vetëm mbi mua. Kanë vendosur kokrra të zeza si një peshë ndrydhëse në bardhësinë e dëshiruar të nuseve. Po tani që ditët janë të bardha? Po tani?... Mos vallë do të vijë njeri e ta heqë me dorë? Është folur e është folur... Partia ka thënë se zakonet poshtëruese duhet të flaken tutje. Ky i tillë është... Ti dhe shoqet e tua, ju duhet ta bëni këtë, thonë ato...»

I lind një forcë e brendshme e patreguar, një dëshirë e zjarrtë për t'u ndryshuar aty për aty, menjëherë e tërësisht. Të lahej mirë e mirë e të krihej! Pastaj... të lahej e të krihej më parë...

Vrapon në hajat. Dëgjon zërin e së vjehrrës e ndalet si e trembur. Stepet. Kafshon buzët e i bën gjak. Kthehet. «Dëshirë e marrë,» do t'i thoshin. «Dëshirë e marrë vërtet? Një tekë? Tekë prej gruaje të...?»

«Po i re në sy, i bie edhe në dorë dikujt,»

«S'është e vërtetë! Një mijë herë jo! Dhe bukuria e gjallëria s'janë bërë për t'u mbajtur fshehur. E në u shfaqshin me tërë forcën e tyre, ky është shëndeti, jeta, lulëzimi e s'është e thënë që nusja

të bëhet pre e ndonjë maskarai për shkak të tyre. Jo e jo!»

Të shëmtosh veten që të mos biesh në dorë e në sy të dikujt! Budallallëk me brirë! Më i madhi budallallëk! Më poshtëruesi!... Ai do të vinte. Si do ta kishte qejf ai vetë? Kështu të shëmtuar për të trembur galat? Kurrsesi! Gurka thotë «si shegë!...»

«Ata të dy janë njerëz të mirë, të dy të mirë. Po ja, këto zakone i kanë bërë të ashpër e çehrengrysur... Në fillim mbase do të shahen ca, po pas-taj do t'u pëlqejë edhe atyre, s'ka pse të mos u pëlqejë.»

U nis e sigurt drejt e në hajat. U la mirë e mirë në muslluk. I lagu flokët e i shpleksi me gish-tërinj. U kthye në dhomë, u kreh me mundim e u pa përsëri në pasqyrë. Tani po, faqet i ndritin, sytë i ndritin, flokët i ndritin. Faqet i marrin një të kuq të ndezur e dhëmbët i zbardhin nga një e qeshur e gëzuar.

Shega i qesh vetes. Një zhurmë matanë. Për një çast instiktivisht tronditet e kërkon nëpër dhomë. Rrëmben shaminë dhe e hedh në kokë.

Askush s'vjen, askush s'e thërret. Prapë qetësi. Dëgjon zemrën e saj që rreh me vrull. Pasqyra përballë. I hedh një sy. I pëlqen vetja. E ngre vetullën e i jep kraharorit përpara. Nga këto lëvizje të shka-thëta, shamia shket e bie në dysheme. Ajo e ndjek me sy, po nuk ulet ta marrë. E sheh atë dhe diçka i shkon ndër mend: Në flokët e pakrehur shamia qëndron edhe pa e lidhur, sidoqë ta hedhë. Flokët e krehur e të butë s'e duruakan dot, e bjerrin.

Nuk e ngau shaminë, madje e hoqi edhe përpa-rësen, e cila ndoqi po atë rrugë. E shtroi me dorë

- fustanin e zhubrosur që e fërgëlluan format e trupit të saj të gjallëruar. E ndjeu veten të freskët e të lehtë, krejt të shkontraktuar.

Dhe i buzëqeshi Shegës së pasqyrës që ishte bërë kaq shpejt e bukur dhe e mirë, që ishte bërë për t'i buzëqeshur.

## JEHONË THELLËSIE

Pisha të larta, të drejta, të dendura. Kurorat e tyre bashkoheshin atje lart e qielli s'dukej fare. Erë e freskët plot aromë rrëshire dhe një shushurimë filladitëse që përcillej degë më degë. Kudo hala e boça pishash të thata. Aty-këtu ndonjë lirishtë e vogël që binte në sy që larg, se dielli atje ndritte më tepër sikur zbrazte tepricën që kurorat e pishave degombrellë s'e lejonin të arrinte në tokë. Bar i gjatë e luleshtrydhe që skuqnin midis tij në atë lirishtë.

Të porsamartuarit, të mahnitur, rendnin pas tyre. Këput e ha e qesh. Aroma e luleshtrydheve përzier me atë të rrëshirës e të njomësisë së barit ishte joshëse, dehëse.

— Një ketër! Shih, shih një ketër!

Ketri hidhej degë më degë pendë i lehtë. Pas disa kërcimeve mbështetej në bishtin e gjerë e zgjat-te poshtë kokën e vogël me ata sy shpues. Përsëri kërcente e përsëri qëndronte për të hetuar. Diku zuri vend. Si e pati hallin?

— Sa i shkathët! Dhe tërr s'ia bën syri!

Gruaja e re hodhi drejt ketrit një boçe të thatë. Ketri u nder edhe më, po nuk u trëmb e nuk ia mbathi.

Kishin bërë mjaft udhë. Tani pylli përzihej. Pisha të rralla e ahishta tumba-tumba. Midis tyre dredhonte një vijë uji që kishte gjetur shtrat në fletët palë-palë. Uji shpejtonte tatëpjetë e hidhej nga një shkëmb i thepisur. Që poshtë shkëmbit vinte një erë e ftohtë së bashku me zhaurimën e përroit të shkumëzuar. Gruas së re i shkuan të ngjethura në trup e u shtrëngua pas burrit. Pastaj ktheu kokën në drejtimin tjetër dhe pa zanafillën e asaj vije. Ishin dy sulinjarë që e hidhnin ujin larg.

— Çesma e Nuses? — pyeti ajo.

Ai pohoi me kokë.

Ndërkohë ajo u turr me padurim. Piu ujë me etje, lau faqet, gushën, sytë larushë si gjumashë dhe, si u filladit, i pëlqeu t'i mbante duart në rrjedhën e vrullshme. Ashtu bëri edhe burri i ri.

— Çesma e Nuses! Pse ia kanë vënë këtë emër, vallë?

Vështrimet e të dyve u tretën te sulinjarët, që dilnin prej një çakëlli të gurtë. Çakëlli që veshur me myshk të blertë, kurse sulinjarët e drunjtë me një zgjyrë ngjyrë vaji. Koha i kishte veshur kështu në një mënyrë të tillë që gur e dru ishin bërë një dhe dalloheshin veç nga ngjyra.

— Këta sulinjarë më ngjajnë me sytë e një hu-seje të moçme që lotojnë e lotojnë pa mbarim...

— Po, ti ke të drejtë, sy që lotojnë. Se nuk është e mundur që ky emër të lidhet me ndonjë ndodhi të gëzueshme. Për nuset e moçme zor të këtë pasur ndodhi të këndshme. Tragjedi po.

— Të shkretat nuse! — psherëtiu thellë ajo.

Ai tundi kokën. Sigurisht e kishte kuptuar drejt aluzionin e qartë të nuses së tij të re e të bukur.

— Sua kanë kuptuar kurrë dëshirat, ca më te-

për nuk ua kanë kuptuar dashurinë nuseve të moçme. Tërë jeta një tog dëshirash të porealizuara që askush nuk ka dashur t'i kuptojë e t'i çmojë.

Ajo dukej sikur fliste me vete e për vete. Ai solli ndër mend luftën që atyre të dyve u ishte dashur të bënin. Dashuri e zjarritë, po kundërshtime të rrepta. Nga të dyja anët. Ata të dy kishin luftuar një kohë, pastaj, duke mos i përfillur fare këto kundërshtime, erdhën së bashku në këtë kamp malor ku e filluan jetën bashkëshortore. Ditë të bukura ato që po kalonin. Errësoheshin disi vetëm kur sillnin ndër mend kundërshtimet, rreth të cilave bisedonin shpesh e prapë s'ishin të qartë.

— Të dashurosh e të martohesh me atë që do, është një gjë kaq e bukur, e thjeshtë dhe e qartë — tha gruaja e re. Pse të ketë njerëz që s'duan ta kuptojnë këtë? Pse ta pengojnë?

Dhe me vështrim të tretur tej, të dy i ndoqën këto pyetje sikur sa më larg t'i shpinin, aq më të qarta e më të sakta do t'u vinin përgjigjet. Myshku, era flladitëse, shushurima e pandërprerë, aroma e lulështrydheve dhe nanurisja e ujit që nxitonte, i përkundën të porsamartuarit në përfytyrime të gjalla të atyre që dëgjuan ditët e para të mbërritjes së tyre në këtë vend.

## I

«...Nusja e moçme korr thekër në një arë diku në mes të pyllit. Pisku i vapës. Xibuni rëndon plumb. Nusja kullon në djersë, lëpin ato që i vijnë në buzë, po kripësira ia shton edhe më tepër etjen. Djersët ia veshin sytë e lodhur. Nusja i fshin me mëngë e

korr, korr e duron. As që i shkon ndër mend të flasë e të kërkojë. E kanë mësuar me një mijë mënyra që të heshtë e të durojë, të mos flasë e ca më tepër të mos kërkojë. Dhe ajo duron. Duart i lëvizin vetiu, drapri pret kallëzat e thekрит, pollogjet rriten e zgjaten, lodhja e etja rëndojnë.

— Nuse, a po na mbush ca ujë?

Nusja ngre belin që i ther dhe e shikon atë që i foli. Nuk është nevoja t'i përgjigjet së vjehrrës, askush nuk ia kërkon një gjë të tillë. Ajo duhet të dëgjojë e të bindet. Dhe nusja ashtu bën. Po kësaj here urdhri i pëlqen sa më s'ka. Rrëmben bucelën e humbet në pyll.

Ja çesma. Nusja sulet e me një frymë ndodhet te sulinarët etjeshues. Oh, ç'të pirë! Oh, ç'të freskuar! Lan sytë e faqet, pi e lahet përsëri. S'i bëhet të ikë që andej. Pastaj e vë bucelën në sulinjar. Bucela mbushet shpejt, uji i tepërt rrjedh anash në faqet e drunjta. Rrjedha ia merr sytë e mendjes nuses e i ngjan se është në përrallë. Sa të lehtë e ndien veten! Sa mirë atje te çesma!

Po pa shih, ca gjethe lëvizin te një kaçubë atje tej. Ajo kthen kokën me rrëmbim e zemëruar. Kush po e shkëput kështu nga ai çast kënaqësie? Ç'është ai që guxon?

— Rezi!

Ç'është ky i krisur që e thërret në emër?

— Ma paske harruar zërin, Rezi?

Pa shih si zbuten tiparet e fytyrës së nuses atje te çesma! Pa shih si shket bucela nga duart e saj e ajo as përpiqet ta mbajë e as ia hedh sytë! Një fytyrë e dashur atje te kaçuba. Një zë i ëmbël ai që e thërret. Dy sy të zjarrtë ata që e shohin. E tërheqin, e tërheqin.



— Unë jam këtu, Rezi!

— O zot!

— Unë jam këtu! — përsërit djali syshkëndijë.

Nusja fërkon gushën që i përpëlitet, i vë duart në krahë, vështron anash e trembur, por shpejt harron çdo gjë dhe... hop! Fluturon e bie në prehërin e atij njeriu që s'e ka hequr kurrë as nga sytë, as nga mendja. Ai e shtrëngon në gji dhe e puth me mall e dashuri.

— Nga qielli re?

— Ja, ashtu. S'duroja dot e erdha.

— Ma ndillte zemra. Të kam takuar në gjumë.

— E di.

— Edhe qëpari të kisha ndër mend.

— E di.

— Po tani?

— Të ikim, Rezi!

— Jo!

— Ke frikë?

— Jo.

— Atëherë?

— Ku të vemë?

— Ku të mundim.

— Kam një peshë të rëndë, ja, mu këtu.

Ai e shtrëngon dhe e puth përsëri. Ajo mbyll sytë si e përhumbur. Sa e lumtur ndihet!

— Kjo më duket si në ëndërr.

Heshtje. Dëgjojnë zemrat e njëri-tjetrit.

— Kështu i ndodhi asaj nuses së përrallës?

— Kështu.

— E pastaj?

— Trimi e rrëmbeu në krahët e tij dhe ikën tutje, tutje...

— Rrëmbemë, o trim!

Dhe trimi s'e bën të gjatë. Me të në duar vrapon pyllit.

Ikin e ikin. Ku venë vallë? Larg nga ai vend, larg nga ata njerëz që s'i lënë të dashurohen.

Dy krisma pushke dhe vrapimi i tyre u ndërpre. Ata ranë të përqaftuar aty në mes të pyllit. E ashtu mbetën.»

## II

«...Dasmë e potershme. Pinë, bërtasin.

— Hej, nusen! Gati nusja? — thërret një krushk mustaqemadh.

— Gati nusja? — pyeti një tjetër.

— Nusja gati është, xhanëm, po... si kështu, me kaq, a?

— Zotrote kujton se do t'ia marrim me gjumë? Na pret dasma e madhe dhe e gjatë e këndesit.

— Ha, ha, ha! Hi, hi, hi! — gjëmon shtëpia.

— Këndesi, ë? Këndesi është këndes! Brompt! Shëndeti i këndesit!

— Brompt!

Ngrihen faqore, gurgullon rakia në gurmazet e pangopura, djersiten fytyrat e përzhitura nga dielli e era, qeleshe shkasin anash, cullufe drizë bien mbi ballë. Përdridhen mustaqe e përshkënditen sy.

— Nusen!

Këtë radhë mustaqeliu brofi në këmbë. Të tjerët ndjekin shembullin e tij. Ai mbush për të fundit herë faqoren dhe e fut në brez. Të tjerët gjithë si ai. Krushqit dalin e hipin në kuaj. Edhe nusja në kalë. Me duvak të gjatë e të gjerë duket vetëm një gjë e bardhë atje majë kalit. A thua regëtin jetë

nën atë duvak? Qenia e gjallë flet, lëviz. Ajo as flet, as lëviz. E megjithatë edhe ajo jeton. Dëgjon e ngashëren symbyllur. Zemra i dridhet, i qan. Merr frymë me të keq, s'e lë duvaku, e pengon ngashërimi.

Krisma pushkësh. Nuses i bëhet se e qëlluan atë, aq të forta i erdhën në vesh ato krisma. Ngrihet pezull, jo, s'e paska gjetur gjë!

— Epo, nisemi?

— Nisemi!

Krisma të tjera, gurgullima të tjera. Një këngë zëgërvishur. Hingëllima. Patkonj kuajsh në trok e në linkth.

Nusja e merr me mend se janë vënë në udhë. Diçka i pëshpëritin rrëzë veshit ose më mirë atje ku e marrin me mend se duhet të jetë veshi i saj. Ajo s'kupton asgjë, s'dëgjon asgjë, nuk është e aftë as për njërën, as për tjetrën. Zemra po, ajo i rreh e i rreh sikur kërkon të dalë nga ai trup i mbështjellë me duvak. Papritur i bëhet se zemra i ngelet diku e zë shpështillet e shpështillet. Ky pe i çuditshëm diku tkurret e diku lirohet. Kali ecën, nusja mbi të, zemra shpështillet parrështur si një çorape e vjetër. Deri kur kështu? Njëherë ai pe duhet të këputet. Akoma jo?

Nusja merr frymë me vështirësi, nuk ngopet dot. Duvaku i rëndë e pengon të shohë, e pengon të dëgjojë, por, sidomos e pengon të marrë frymë. Ajo mbërthen duart në kaptell. Duarve, veç atyre ua ka lënë besimin e trupit. Zemra i shpështillet, truri s'i punon, sytë s'i shohin gjë, veshët shumë pak i dëgjojnë. Zbresin, ngjiten a ecin në udhë të shtruar, ajo e kupton vetëm nga duart. I lodhen, i mpihen. Liron njërën, pastaj tjetrën.

As që e merr dot me mend si bëjnë këta njerëz,

si ia dalin dot të çirren e të bërtasin. Hingëllima e ndonjë kali e sjell në vete për ca kohë. Oh, ai kalë me siguri habitet me këtë orgji, prandaj hingëllin!

Diku kali qëndron. Ai zgjat qafën e këput një degë me gjethe. Nusja ndehet bashkë me samarin. Poterja e dasmorëve papritur ka heshtur. Nusja dëgjon mbllaçitjen e gjetheve në gojën e kalit. ndien erën e athët të djersës së tij. Pastaj veshët i fitojnë mprehtësi. Shushurimë pishash e zhaurimë uji. Ujë! Nusja lëpiu buzët e thara. Eh, një pikë ujë, vetëm një pikë! T'i njomë buzët që i thahen, të lagë gojën që i piqet, të ftohë trupin që i digjet.

— Zbritni, o burra! Zbritni e flladituni në këtë ujë ar.

Burrat ulen e pinë ujë. Pinë e lahen, futin këmbën në ujin e ftohtë e turfullojnë.

— Ujë, po ujë!

— Na bëri esëll, o burra!

Ngrihet rishtazi një faqore, e pasojnë të tjera.

— Ohoho!

Gjithsekush ka bërë hall për vete. Brezi i gjerë e xhepat e tallaganes së rëndë mbajnë jo veç faqoren e rakisë, atje zë vend e rri punë e madhe edhe një shpatull dashi, një brinjë a një copë mishi çfarëdo. Dhe tani dalin me radhë këto pjesë të zgjedhura sipas shijes e të zhvatura në mishrat e pjekura me të tepërt. Ngulen dhëmbë në to e lëshohen gogësima kënaqësie pas tyre.

— Po nusja? — kujtohet njëri.

— Nusja është nuse!

— Po si, nusja është nuse! Mos dëshiron zotëria jote të vijë e t'ia shtrojë me ne?

— Ha, ha, ha! Hi, hi, hi!

— Të çlodhet, bre!

— Pse, lodhet nusja!?

— Ha, ha, ha! Hi, hi, hi!

— Mos ia qaj hallin, o bir.

Dasma e saj është, ne për të po e djegim. Ç'do të mbajë mend ajo? Ky është lezeti!

— T'i japim ca ujë, bre!

— Ujë? Ja, sikur kemi vajtur. Ai që e pret, ia shuan etjen... apo s'e kam mirë, bre?

Një tjetër argalisje.

— Bromp!

— Bromp! Shëndeti i nuses!

Ai që ia qante hallin nuses, s'u ndje më. Mbase i druhej ndonjë thumbi edhe më të rëndë në adresë të tij, të cilin pastaj s'mund ta linte pa paguar.

Nusja dëgjon e pret. Shpejt iu shua ajo shkëndijë shprese se mund të flladitej me ujin e ftohtë.

E lënë majë kalit e bëjnë qejf. Kali ndjek fijet e rralla të barit. Nusja shtrëngon duart në kaptell. Digjet zjarr si në ethe. Regëtin diku zemra e mbërthyer. Filli zgjatet e zgjatet. Akoma nuk është këputur? Sa i fortë!

Në këtë mes një zhaurimë vjen që poshtë. Ajo i shuan edhe gurgullimën e çesmës, edhe zërat e burrave. Nusja e merr me mend se që atje uji merr vrapin tatëpjetë e hidhet nga ndonjë shkëmb i thepisur. Ajo e përfytyron atë dhe ndien në fillim një farë freskie, pastaj trembet nga humnera.

Kali vazhdon të ndjekë fijet e barit. Zgjatet e këput një gjethe. «Kрак, крак», bluhet gjethja në nofullat e kalit. Nuses i bëhet sikur ia blujnë koskat në mokra të gurta. Lemeriset e prapë bie në qetësi. Duart mend i këputen. Të rënda, të rënda e megjithatë përpiqet t'i shtrëngojë për kaptelli. Duvaku s'e

lë që s'e lë të marrë një herë frymë. Nën të si nën një saç të skuqur.

Kali shtrin qafën e kap një degë tjetër. E tërheq një herë, dy. Dega paskësh qenë e fortë. Ai e tërheq përsëri e përsëri, po ajo s'jepet. Duke tërhequr degën, kali pengohet. . . »

— Obobo! — kërcen përtpjetë gruaja e re sygjumashe që e sheh nusen e përfytyrimin të saj të fluturojë në humnerë bashkë me kalin.

— U trembe?

Ajo psherëtin e fërkon sytë me dorë. Shtrëngon kraharorin, zemra i rreh e i rreh. Dalngadalë frika largohet nga sytë e saj e ata bëhen sërish të butë, të qeshur e ëndërrimtarë.

Çesma e Nuses! Ç'ndodhi të moçme lidhen me këtë emër! Emri i saj është i vërtetë. Nusja e moçme, një e vërtetë tjetër. Me dy të vërteta të tilla përfytyrimet e mësipërme janë më se të ngjashme.

— Kthehemi? — u kujtua e tha ai.

Gruaja e tij e re dhe e bukur prapë kishte rënë në mendime dhe e shikonte sikur që në gjumë me sy hapur. Ai mbushi një grusht me ujë. Duke ia nuhatur qëllimin, ajo kërcëu sa munda, po nuk arriti dot të largohej mjaft dhe, ndërsa era ia ngiste fustanin e hollë, një mori piklash të ftohta uji e spërkatën nëpër trup. Ajo qeshi.

## DUKE PRITUR AUTOBUSIN

Kur pushoi era, filloi një shi i rrallë e i ftohtë. Ndërkaq retë po bëheshin gjithnjë më të dendura, qielli u var poshtë e u bë i njëllojtë si një det ngjyrë plumbi. Pas pak ky qiell i murrëmë dërgoi tatëpjetë mizëri cufdash të bardha që ndiqnin njëra-tjetrën. Cufat e dëborës nxitonin, i vërsuleshin tokës, por, sapo takonin në dheun e lagur, shkriheshin e bëheshin ujë. Pas tyre sulmonin të tjera, të tjera...

— Ejani brenda, — tha Resuli — duhet gati edhe një orë që të vijë autobusi.

Më tepër se fjalët të ftonte buzëqeshja e atij burri të shkurtër me shëndet e humor të mirë. Resuli që shitës dhe dyqani i shitblerjes që e vetmja ndërtesë në atë vend qëndrimi për autobusin e linjës, të cilin ne e prisnim.

Në dyqan, rreth një mangalli me prush të porandezur, u qarkuam e ia nisëm bisedës. Vinin fshatarë, Resuli ngrihej e u jepte çfarë donin, ata shkonin pasi na përshëndetnin e Resuli sërish kthehej te ne. Një fshatar bojalli fytyreshtak, veshur me rroba kadifeje të reja, e shkundi ombrellën te pragu dhe e la prapa derës.

— Tungjatjeta! — tha.

— Tungjatjeta!

— Resul, mirë? Ju, shokë, mirë?

Ne u ngushtuam ca e i bemë vend pranë mangallit. Resuli i dha një cigare e fshatari e nderzi në një thëngjill.

— Për nga kështu, Idriz? — pyeti Resuli.

— Do të dalim një herë andej nga qyteti.

Pastaj ne vijuam bisedën e ndërprerë e fshatari me emrin Idriz hyri menjëherë në fazë, dëgjonte i vëmendshëm duke thithur cigaren ngadalë e me një farë kënaqësie. Ashtu ngadalë e me vëmendje sytë e tij ngjyrë gështenje nën ca qerpikë të gjatë e të dendur nguleshin tek ai që fliste, pastaj te në të tjerët, në një hetim të kujdesshëm, me takt. Befas ai u ngrit e shkoi drejt banakut. Këtë herë vështrimi i tij kishte mbërthyer një shami dore lidhur shuk e varur në një gozhdë në raftin karshi derës. E shikonte duke pulitur sytë si për t'u bindur nëse shikimi që i saktë. Sigurisht që po e ndiqnim me sy. Resuli qeshte nën buzë.

— Ç'është kjo, Resul?

— Shitet — tha gjithë duke buzëqeshur Resuli.

Idrizi u kthye drejt tij mëdyshas. Ashtu mbeti një çast. Pastaj tha:

— Mos janë mbështjellë 1800 lekë me të?

— Të reja a të vjetra?

— Të vjetra.

Resuli u hodh në këmbë, hyri brenda banakut, e zhvari shaminë dhe e hodhi në banak.

— Merre! — tha.

Idrizi e futi në xhep e u kthye në vendin e tij. U ul edhe Resuli.

— Më bëhet qejfi që i gjeta, po më vjen edhe çudi — tha Idrizi.



— E pse të ardhka çudi?

— Këta lekë mund t'i kishe futur në xhep pa të vrarë shumë ndërgjegjja.

— Mundet, vërtet. Po edhe kështu si u bë, mundej, apo jo?

— Po, edhe kështu.

Idrizi nxori një kartmonedhë.

— Na mbush nga një dopio konjak.

— Kjo, po. Të mos e kishe bërë këtë, do ta prishje punën.

Idrizi e çoku gotën me të gjithë.

— Për ndershmërinë! — uroi ai. — Njerëzit po bëhen gjithnjë e më të ndershëm. Të pimë për ndershmërinë!

— Për lekët e gjetur! — tha me shaka Resuli.

— S'është gjë ajo punë! 1800 lekë as më varfërojnë, as më pasurojnë. Rëndësi ka që po bëhemi njerëz gjithë e më të ndershëm.

Biseda u soll rreth kësaj teme. Njëri prej nesh kërkoi hollësi dhe Resuli tregoi si kishte ndodhur.

Kur po fshinte dyqanin, pa shaminë në rrëzë të banakut. Në fillim s'i dha rëndësi dhe e mori me fshesë bashkë me plehrat, pastaj vuri re se ajo ishte lidhur si një top lecke. E mori me mend çfarë kishte dhe e zgjidhi. 1800 lekë. «Mos i ka hedhur njeri për provë? Gjepura, ç'provë bëhet me gjëra të tilla?» Megjithatë hodhi një sy përjashta, asnjëri. Si t'ia bënte? I futi lekët në xhep e vijoi pastrimin e dyqanit. Mirëpo lekët i futi në xhep e shqetësimin në kokë. Mendonte: «Për atë që i humbi, janë shumë, për mua hiçgjë. Në i mbajtsha, do të më vrasë ndërgjegjja. Për më tepër ajo që i ka humbur është grua. Kushedi ç'bën!» Se ai e dinte që vetëm gratë fshatare i mbështjellin kështu në shami lekët. Ai e dinte

edhe sa me të keq i prishin lekët ato, sa u dhimb-  
sen... E po, si t'ia bënte?!

Pas kësaj kishte vendosur ta varte shamipë në  
gozhdë. Ajo që e kishte humbur, do ta kërkonte e  
do ta njihte. Disa kishin pyetur se ç'qe ajo shami  
dhe Resuli u kishte dhënë një përgjigje sa për të  
kaluar radhën. I zoti i mallit, doemos, do të pyeste  
e do të sillej më ndryshe.

Kështu kishte ndodhur. Resuli tregoi shkurt, pa  
qejf.

— S'pate tundime, Resul?

— Tundime? Aq pata, sa më vjen turp t'i sjell  
ndër mend! Dhe të mendosh... për 1800 lekë...  
nejse, gëzuar!

Ai e trokiti gotën me secilin prej nesh dhe, kur  
e vuri në buzë, diçka iu kujtua, se qeshi e tundi  
kokën.

— Fit e fit, Idriz!

— Ëhë! — ia bëri Idrizi. — Jo, xhanëm, s'është  
njësoj. As nga shuma, as... unë nuk e bëra kaq me  
lehtësi. Unë...

Ne po shikonim herë njërin e herë tjetrin të ha-  
bitur.

— Tani le të tregojë ky — tha Resuli.

— Mesele e vjetër — tha Idrizi. — Pastaj...  
sa vajti ora, o shokëni?

— Ka kohë, ka. Dhe mos i bëj bisht, nuk kemi  
për ta shitur.

— Kanë lidhje — tha Idrizi. — Këtu e nja dy  
vjet të shkuar që thoni ju, çimentoja vinte me pa-  
kicë. Ndërtime shumë, çimento pak. Që të mos na  
mbetej hatri e që të mos kishte ngatërresa, ky miku  
e ndante me kalem barabar për të gjithë sa kishin  
kërkuar. Po djall punë, se tjetri vjen të blejë këtu

e s'pyet me ç'llogarira merresh ti. Për lehtësi një herë në muaj Resuli bënte listën, secili paguante e merrte një dëftesë për sa kishte paguar. Çimenton, pastaj, vije dhe e merrje kur të doje.

Ashtu, or vëlla, bëmë edhe ne. Ndërtuam shtëpi të re, për çimento po nevojë sa më s'bëhet. Vij unë këtu e paguaj për dy kuintalë. Pas dy ditësh erdhi çimentoja. Atë ditë u ndodh këtu babai, shpinte patate në depot e kooperativës.

«— Tungjatjeta Resul!

— Tungjatjeta!

— Kam paguar lekët për dy kuintalë çimento, mirëpo dëftesën s'e kam me vete. Meqë më qëlloi puna këtej e kam edhe dy kuaj, po të kesh besim, ma jep. Në mos, po, do të vij një ditë tjetër apostafat.

— Mirë, ta jap. Po e le këtu, do të më vardisen kushedi sa e do të më vësh në bela. Merre!» i thotë Resuli. Ia peshon çimenton, i ndihmon edhe për ta ngarkuar. Me të ngarkuar, babai u nis. Resulin dikush e kërkoi. . .

E solli çimenton babai, or vëlla, ia kërkoi nënës dëftesën e ma dha mua në dorë.

«— Dëgjo, ai pati besim, t'ia dërgosh që sot, se druaj që nuk më njeh me emër e as ndonjë shënim mbajti. Po e mira duhet shpërblyer veç me të mirë.»

«Mirë», thashë. Po s'më erdhi për mbarë që ta sillja që atë ditë dhe u harrua. Nganjëherë të venë përpara punët e harron çdo gjë. Ai që ka bërë shtëpi të re, e di bukur ç'telashe ka hequr. E kështu, or vëlla, dëftesa mbeti për ditë me radhë. Çimentoja po dihet, nuk na mjaftoi. U puqën dy gjëra që përkonin, njëra e rastit, tjetra e nevojës dhe a nuk na qëllon shpesh që rastin ta shohim si mrekulli të zgjidhjes së nevojës? Mua s'më mbante vendi e një

mendim djallëzor më vërtitej në kokë. Çimento më duhej e ku ta gjeja? As në qytet nuk kishte. Kisha në dorë një dëftesë, me të mund të siguroja edhe dy quintalë e me kaq hallosesha. E merrja në duar atë dëftesë dhe e vërtitja. Një copë letër, po ç'vlerë kishte në ato çaste! Bëja hall dhe si pa, veresie! «Resuli s'ia mbajti shënim emrin. Pastaj unë nuk besoja ta njihte e ca më keq akoma, që ta dinte se ishte babai im? Fundja, për të qenë më i sigurt, dërgoj tim kushëri. Dhe në mos daltë mbarë, or vëlla, i themi të na falë, nuk e kishim me qëllim të keq... Po në vaftë mbarë?...»

Më ngacmonte ky mendim. Më shtrëngonte nevoja, ë, e kisha pisk. Dhe rasti më vinte në derë. Ta humbja? S'kishte, or vëlla, s'gjeje dot, popo shtëpia desh mbaruar. Nganjëherë edhe i thosha vetes: «Idriz, je këtu apo jo? Për dy barrë çimento ta bësh veten?... Pastaj, mirë ti se mund ta bësh, po babai? Ai mund të ta nxjerrë kopilin sheshit fare papa-ndehur.»

Më falni se u zgjata ca, ë, po... kam hequr keq, or vëllezër, të më besoni. Ama mua më duket se asgjë e keqe nuk bëhet, po ta mendosh gjatë. Se, sa më tepër e sillja në mend këtë veprim, aq më i rëndë e më i ulët më dukej. E besoni që mbushesha me djersë sikur kushedi ç'punë të vështirë po kryeja? Atëherë vendosa ndryshe, ta merrja çimenton e më pas t'ia paguaja. Ndoshta do të shante Resuli, po, fundja, ndonjë gjë kaq e pandershme s'qe kjo, se, ku të gjeja?

Ashtu i dhashë karar. Vij këtu, i jap dëftesën dhe ky burri i mirë më peshon çimenton pa dyshuar fare. Unë e vëzhgoja në çdo hap që bënte e zemra më rrihte. Ngarkova e u nisa. Deri te kthesa frika

po më torturonte, pastaj, or vëlla, ndjeva një farë sigurie në vetvete. «S'kuptoi gjë ky e s'ka për të kuptuar kurrë. E pat kjo punë!»

Po do ti, sa zura t'i shkarkoja mushkat në oborr, sapo im atë më hodhi një vështrim pyetës që desh të thoshte: «Ku e gjete?», unë u preva e s'më mbante vend. Një të kthyer u bëj mushkave e me të rendur drejt e këtu...

Idrizi heshti dhe ndezi një cigare tjetër me sytë mbi mangall.

— Pastaj?

— E çfarë, pastaj? I thashë Resulit: «Or vëlla, kështu e kështu!»

— Pastaj?

Idrizi më pa me habi.

— Pastaj ai u qetësua e unë bëra timen — e plotësoi Resuli. — Gëzuar!

Ai i ra shpatullave Idrizit e ne u çliruum duke i shkundur gotat.

— Njëherë një shoku ynë vajti të merrte rrogat e arsimtarëve... — zuri të tregonte njëri prej nesh.

Mirëpo te kthesa u dëgjua boria e autobusit. Dhe kthesa që përballë dyqanit. U ngritëm nxituar e u përshëndetëm me shitësin, i cili na përcolli gjer te autobusi me atë buzëqeshjen e shëndetshme që i shkonte aq shumë.

Dëborë vazhdonte të binte ashtu me mizëri cuflash që ndiqnin njëra-tjetrën. Tanimë dhe i që nënshtruar vërshimit të tyre. Dukej që nuk i shkrinte dot më dhe ato kishin zënë të formonin një shtresë të bardhë e të pastër.

## PLOTËSIMI I KURËS

Një copë herë ajo ndenji fare në heshtje, shoqëruar nga mendimet e saj. Më pas pati zjarrmi e u ngrit, shëtiti nëpër dhomë e ndjekur nga shikimi i shqetësuar i shoqes së shtratit përbri.

— Ç'pate, Mirjana?

— Asgjë, asgjë — tha ajo.

Koha që e keqe e dhoma gjysmë e errët. Mirjana iu afrua dritares e mbështeti faqet në xham. Faqet i kishte të nxehta, xhami që i freskët e vajza ndjeu një kënaqësi të madhe, të madhe, puliti sytë e mbeti ashtu, në një gjendje rehatie të përkohshme. Pastaj zhurma monotone e shiut i tërhoqi vëmendjen e vështroi përjashta. Shiu që i ngadalshëm e i pandërprerë, shi vjeshte. Plepat gjysmë të zhveshur me ato bisqe të çliruara nga fletët dukej sikur sulmonin qiellin. Bisqet ngjanin pikërisht si gjymtyrë kryengritës. Një degë arrinte deri te dritarja. Dega dridhej, fërkohej ritmikisht pas xhamit sikur kërkonte mbrojtje.

Mirjana ia kishte ngulur sytë një flete të gjerë e të verdhë që përpëlitej nën goditjet e parreshtura të pikave të shiut.

«Do të qëndrojë dot, do të qëndrojë?» thoshte me vete dhe zemra i dridhej.

— Mirjana, po ç'ke kështu sot ti?

Shoqja që ngritur e po i afrohej e shqetësuar.

— Asgjë, Razi. Ja, shiu. Çdo gjë e lagur, e murme, e mërzhitur. Çudi. Si e duron toka gjithë këtë shi? Si e durojnë drurët?

Si për t'iu përgjigjur, bisqet u lëkundën duke fëshfëritur të ngacmuara nga një erë e papritur. U shkundën e ranë fletë, midis tyre edhe fleta e verdhë, bashkë me ujin që kishte mbetur nëpër to, bisqet bënë edhe më përpjetë duke e forcuar atë përshtypjen e kryengritjes.

— Mbetë në dritare, moj vajzë. Shiu të trish-ton. Më mirë bisedojmë, ose lexo. Apo të hap alto-parlantin? Duhet të ketë muzikë tani.

Mirjana nuk kundërshtoi. U shtri mbi batanije me kokën mbështetur në njerën dorë. Flokët e butë e ngjyrë ari i derdheshin mbi llërë. Sytë e pulitur ia mbulonin krejt qerpikët e gjatë. Një arterie e qafës i regëtinte nxituar, dy rrudha të vogla në anë të syve ia tregonin fytyrën më të dashur e më të njohur. Dukej sikur flinte.

«E bukur është, mendoj Razija. E bukur dhe shumë e mirë, po ca si tepër melankolike. Nuk do ta kisha besuar këtë. Në skenë duket krejt ndryshe.»

Mirjana kishte rënë në mendime.

Tri javë i pati kaluar. As nuk doli, si i thanë kur u shtrua, as kurën nuk ia kishin ndërprerë. Ndihej e dobët, më e sëmurë se përpara.

Java e katërt e asnjë fjalë për të dalë. Mjekimi me po ato preparate. Frymëmarrje e shpeshtuar, temperaturë e dhembje koke.

Pse ilaçet s'po i bëjnë asnjë efekt?

Mendimet ogurzeza bëhen përbindsha të shpirtit kur i pranon e u jep udhë. Nxitojnë e shtohen si insektet në terren të përshtatshëm e të tërheqin, të tërheqin në vorbullën e tyre torturuese.

Mirjana qe në pushtetin e tyre.

— E bukur, Mirjana, apo jo?

— Si!?

— Këngë e bukur.

— Ë, po.

— Ta mbush zemrën me gëzim. Dhe Ema e këndon me shpirt.

Mirjana bëri «po» me kokë e psherëtiu lehtë. Ajo nuk e shprehte të të tjerët vuajtjen e saj shpirtërore dhe nga kjo rëndohej edhe më tepër. Mirjana shpesh çuditej me shoqen e dhomës, madje nganjëherë mendonte se mos ajo e merrte jetën si shumë lehtë e prandaj s'merakosej.

Razija u ngrit dhe e uli zërin e altoparlantit. Duke u kthyer, kopsitte penuarin.

«Është e shëndoshë Razi, shih ç'këmbë të ka!» mendoj Mirjana për të.

Razija vajti tek ajo e ia vuri dorën mbi kokë. Gjinjtë e saj të kërcyer u shtypën në supin e Mirjanës kur ajo u ul pranë saj dhe asaj iu bë se mori diçka nga trupi i bëshëm i shoqes dhe e pa e përgjëruar.

— Koha e keqe s'të ndjell asgjë të mirë.

Mirjana pohoi me kokë.

Atë çast u hap dera e hyri infermierja, pas saj doktori.

— Si jeni sot, moj çupa?

— Mirë — tha Razija.

— Mirjana ka temperaturë — tha infermierja.

Doktori shkoi tek ajo, ia mori dorën e i mati



pulsin duke e parë drejt në sy. Në sytë e saj lexoi frikë, tronditje, po edhe padurim. Ai e vizitoi me kujdes, pa u nxituar.

— Mirjanën do ta nxjerrim për ca ditë — tha buzagaz doktori. — Na pengon ca kjo dreq kohë, që sikur pret të dalë artistja e ta sulmojë. Po nuk e lëmë! Do të të shëndoshim mirë! — shtoi.

Mirjana e shikonte me ngulm si me mosbesim. Një çast mendoi se mund t'i fliste për të gjitha dyshimet. Pastaj tha vetëm:

— Ndoshta s'më bëjnë efekt ilaçet, doktor. Pse nuk po m'i ndërroni?

— Ilaçet ndërrohen kur s'bëjnë efekt ose kur keqësohet sëmundja — tha doktori.

Ajo s'ia hoqi sytë. Vështrimi i saj thoshte afërsisht:

«Unë e di që ju kështu thoni, kjo është detyra juaj. Sikur të jetë vërtet si thoni!»

— Së shpejti do të të shohim në premierën e re — tha si rastësisht doktori. — A do të na gjesh ndonjë biletë? Se, kur dalin nga spitali, disa as nuk na përshëndetin fare.

Doktorit i kujtohen sa e sa raste, kur vajzat, që i kishte pasur paciente, e shihnin në rrugë, ulnin kokën e skuqeshin. Kjo sjellje, natyrisht, kishte të bënte me konceptin se ai i kishte vizituar, e, sipas tyre, ai ua dinte dobësinë. Doktorit njeriu i zhvishet fizikisht e shpirtërisht, s'ka si të bëhet, përndryshe, e keqja fshihet edhe më. Mirëpo, kur kjo e keqe kalon e harrohet, kujtimi i zhveshjes merr formën e turpit.

Doktori diçka i tha Razijes, i përshëndeti e doli.

— Ti do të dalësh më shpejt, sigurisht — tha Mirjana. — Ti je fare mirë tani.

— Ne do të dalim bashkë.

Mirjana ia nguli sytë. Atë çast dera u hap dhe në atë pjesë të hapur u paraqit si në estradë komikja Mite. Pas saj zgjatën kokat Berti, Lumja, Vali Tato, Sala...

— Me leje? — tha Mita.

Mirjana u habit nga e papritura.

— Tamam si në estradë! Urdhëroni, urdhëroni! — tha Razija.

Dhe hynë brenda shoqet e shokët e Mirjanës, u përçafuan e u përshëndetën me të e me shogen. Mirjana vuri re se asnjë nuk pati drojtje ta qafonte e t'i rrinte pranë. Kjo ia ngrohu zemrën.

U ulën rreth shtratit me vështrim nga Mirjana. Pardesytë e lagura sillnin mbresa të gjalla jete në atë dhomë të gopur me avuj barnash. Një fshinte me shami fytyrën, tjetra shtronte me dorë flokët; të gjithë të qeshur, të freskët si pika e shiut.

— Po ç'bën, moj zogëza jonë e parritur? — ia filloi Mita. — Kemi mbetur keq, s'na shkojnë fare biletat!» Ku e keni atë, thonë spektatorët, atë që është më e bukur nga të gjitha; nga pamja, nga arti, nga emri!»

Mirjana qeshi disi e turpëruar.

— Mos u tall, Mita!

— Vërtet, vërtet. Mita nuk tallet aspak, po bëj si të bësh edhe hë, fry që këtej — tha Berti.

Mirjana psherëtiu.

— Mua s'm'ë besohet.

— Do të rrimë edhe ca — tha Razija. — Ndoshta mund të na mbajnë nja një javë akoma.

— Pse të mos ju mbajnë? Ju kanë rregulluar punë e madhe këtu... Të ri e keni doktorin?

— Mita, shiko sel...

Mirjana qeshi me dliresi. Pastaj i pyeti për të tjerët e për punën, çfarë po loznin dhe ku? Ç'ishin duke përgatitur? Ndonjë gjë të re e të fortë? Dhe këtu, pa i lënë kohë të mbaronte me pyetjet, Vali Taton xori nga çanta një tufë fletësh të daktilografuara e ia dha.

— Janë për ty.

Mirjana zgjati dorën, pastaj ngriti supet e habitur.

— S'të kuptoj — tha. — Ç'kërkon të thuash?

— Janë rolet që të kemi caktuar për premierën e re.

— Mua?!

Mirjana e pa drejt në sy Vali Taton, pastaj të tjerët. Secili pohonte të njëjtën gjë, kur i vinte radha të ndeshej me shikimin e saj.

— Ti lexoji njëherë dhe na thuaj nëse të pëlqejnë rolet. Unë mund të vij prapë nesër — shtoi Vali Taton.

— Vali është regjisore e numrit të ri — sqaroi Mita.

— Sa mirë! Suksese! — uroi Mirjana e i shtrëngoi dorën. — Unë do të punoja me shumë dëshirë me këtë regjisore, po...

— Ç'domethënë kjo «po...»? Mendoj se vetëm në estradë ka vend për të.

— Po unë jam në spital, moj Vali e dashur! Apo mos lozim komedi këtu?

Mirjana edhe një herë ua nguli sytë radhazi. Dukej sheshit që nuk besonte.

— Do të dalësh — tha Berti. — Na tha doktori që do të dalësh së shpejti.

— Kur e takuat?

— Ne e takuam... — Berti shikoi Vali Taton e

kjo i dha shenjë që ta shpinte në fund mendimin — edhe sot, por edhe më parë e kemi takuar. Ne gjithmonë jemi interesuar për ty.

— Aha! — ia bëri Mirjana dhe askush nuk e mori vesh çfarë desh të thoshte ajo me këtë pas-thirrme.

Berti gjeti rastin e i dha një pako me ëmbëlsira dhe një tjetër me mollë, ndërsa Sala e Lumja i bënë ato pyetjet e zakonshme për ushqimin e fjetjen, ç'lexonte, a i kujtonte ndonjëherë apo jo, si ia shpinte me shoqen e dhomës e të tjera e të tjera. Mirjana përgjigjej shkurt me: «Falemnderit, «Si jo, si jo» dhe «Mirë, mirë», po dukej që këtë e bënte mekanikisht e që mendjen e kishte gjetkë. Sapo mbeti një çast e lirë, ajo iu kthye Vali Tatos:

— Cilën dubloj unë?

Kjo që një pyetje krejt e papritur.

— Ti... jo, nuk dublon njeri. Sa kohë që je këtu, meqë ditët janë të numëruara, për të mos mbetur prapa me punën, në provat e tryezës rolet e tua i lexon Teuta.

Mirjana nuk bëri më pyetje. Biseda e mëparshme kaloi nga një temë te tjetra, me ndërprerje e shakara dhe me shumë të qeshura. Mirjana u harrua krejt pas bisedës e ca më tepër shoqja e saj. Kur pa orën, u habit, kishte shkuar gjashtë. Ajo do të kishte qejf të bisedonte akoma, akoma, por ata u ngritën.

— Ju falënderoj nga zemra — tha dhe bëri një gjest teatral, që njerëzve të skenës shpesh u bëhet shprehi.

Grupi shkoi duke lënë pas vetë humorin e mirë që është rezultati më i pritshëm i vizitave të tilla.

— Sa njerëz të mirë! — tha Razija. — Ju artistët jeni njerëz të gëzuar.

— Po, po — pranoi Mirjana.

Sa për vete Mirjana që në një gjendje të dyfishtë, tepër e gëzuar nga dashmirësia e vizitorëve e kujdesi që tregonin për të, deri te rolet për premierën e ardhshme, sido që ajo akoma që në spital; njëkohësisht e dëshpëruar sepse ishte sëmurë, sepse s'mund të shkonte së bashku me ta dhe sepse ata u larguan. Atë filloi ta brente një hije shqetësuese dyshimi. Mos që në të kurdisura të gjitha? Fjalët e doktorit që përkonin me ato të grupit të estradës, gjoja rolet për premierën e ardhshme, të gjitha ç'u thanë?

Ulej në karrige o në krevat me duart qarkuar në gjunjë, ngrihej e shëtiste nëpër dhomë. Razija tregonte përshtypjet e saj.

— Ti je një femër e çuditshme — tha. — Një copë herë m'u duke krejt e ndryshuar dhe m'u bë qejfi, tani prapë të shoh të mërzitur.

«Vërtet të jem e çuditshme?...» foli me vete, pastaj iu drejtua shoqes: — Razi, thua të m'i kenë caktuar vërtet këto role?

Razija qeshi.

— Po bëhesh tamam e çuditshme, Mirjana. Nëse do të dyshosh kështu, rrezik të mos i besosh as vetes një ditë.

«Ndoshta e ka mirë. Pse u dashka dyshuar për çdo gjë?»

Me hap të vendosur shkoi te shtrati i saj, i mori dorëshkrimet e filloi t'i lexonte.

«— Bobo! Bobo!

— Ç'pate?

— Lëre, lëre! Ç'më gjeti mua! Si do t'ia bëj?

— Si t'ia bësh? Kurajë e besim, shoko. Pa to njeriu mbytet në një pikë uji.»

Mirjana tundi kokën e qeshi. «Ndoshta edhe

kjo...», por nuk e çoi në fund mendimin që ky fragment mund të qe shkruar posaçërisht për të. Shfletoi dorëshkrimet e lexoi më tej:

«Në paraskenë hyn një vajzë me fund të shkurtër, me gjerdhanë e byzylykë, me flokë të fryrë. Konferencieri:

«— Me leje, moj shoqe!

— Hë, ç'do?

— Përgjigje e bukur! Nejse. Pse je veshur kështu?

— Se më pëlqen.

— Po pse të pëlqen?

— Se më pëlqen, s'të mjafton kjo ty?

— E, mjaft s'është, xhanëm, por... Qejfi ta ka të dukesh, sido që pa këto marifete ti dukesh edhe më mirë, po... ta ka qejfi, domethënë, ke parë e bën edhe ti.

Vajza bën një gjest të papërcaktuar.

— Mirë, po kush imiton, a nuk më thua? (i afrohet) — Majmuni, do të thuash ti?

— Pikërisht.

Ai qeshi me të madhe.

— Pse qesh?

— Sepse, sepse... majmuni e ndan njeriun nga bota e kafshëve!»

Mirjana qeshte duke lexuar. Materialet e reja po i pëlqenin. Shoqja i vajti pranë e mori të lexonte edhe ajo. Kur e kur Razija qeshte me zë e bënte komente: «Ua, po kjo!»; «Ç'ia bëri bukur!»

— Mirjana, — tha ajo — e di ç'të bëjmë? Ti i thuaj ato ç'të takojnë, unë po t'i lexoj të të tjerëve, të partnerëve, si i quani ju. Mirë? Edhe ti i mëson, edhe zbavitemi ca. Mirë?

Tjetra ia shtrëngoi krahun në shenjë pranimi

e mirënjohjeje. Ashtu filluan. Lexonin e këmbenin mendime, pastaj bënin prova konkrete si në skenë. Në batutat e gjetura Mirjanën e rrëmbente pasioni i aktores e interpretonte, kurse shoqja e saj shkrihej së qeshuri. Në tërësi Mirjanës i pëlqente ky tekst estrade, e tërhiqnin rolet e caktuara për të dhe këto prova të stisura në spital po i dukeshin krejt të natyrshme. Dora-dorës që kjo punë shkonte më tej, hijet e dyshimeve të mëparshme vinin duke u sfumuar gjithnjë e më tepër e ajo s'kishte më as kohë e as dëshirë t'u kthehej atyre.

## PARA PREMIERËS

Punëtori Peçi dëgjonte pa e ndërprerë folësin. Rrinte në një fron në zyrën e përgjegjësit. Komino-shet, kapela, deri edhe vetullat e tij ishin kripur në tallash dhe, duke pirë duhan e duke bërë përpjekje të kapte thelbin e asaj që i thuhej, ngjante se po e kqyrte këtë veshje të dytë mbi veshjen, që s'i ndahej gjatë gjithë kohës së punës.

Përgjegjësi, mjaft i pastër, qëndronte para tryezës së zyrës. Duke folur, vërtitte në duar një kalem plumbi të mprehur me merak. Ishte një burrë fytyreshtak, fjalët i shoqëronte me buzëqeshje, kur fliste nuk i lëvizte asnjë muskul dhe fytyra i ruante çuditërisht një pamje babaxhane, që s'prekej as nga tallashi, as nga nuancat e bisedës.

Bisedën e tyre e ndërpreu dikush që trokiti në derë.

— Hyr! — tha përgjegjësi dhe e ktheu kokën nga dera gjithë me atë pamje të qetë në fytyrë.

Trokitja u ndje përsëri. Ndoshta ai që trokiste, nuk kishte dëgjuar, se aty afër ishte reparti i madh i makinerive, në të cilin bëhej shumë zhurmë.

— Hyr! — tha më fort përgjegjësi.



Dera u hap e në zyrë hynë njëri pas tjetrit drejtori dhe skenografi i teatrit. I fundit mbante nën sqetull një dosje të madhe ngjyrëkafe.

— Urdhëroni! — tha përgjegjësi në mënyrë të sjellshme.

— Të mos ju harxhojmë kohën, drejt e në temë! — tha drejtori i teatrit duke i dhënë dorën.

— S'ka gjë, urdhëroni! — tha sërish përgjegjësi e u nder të dëgjonte, gjithë duke vërtitur në dorë kalemin e mprehur me merak.

— Jemi para festës, trupa e teatrit ka marrë inisiativë të punojë ditë e natë e ta nxjerrë para kohe me rastin e festës premierën e re, mirëpo marangozi ynë prej disa ditësh është i sëmurë dhe do të pengohemi me dekorin. Po të na ndihmoni ca ju, ia dalim. Për këtë erdhëm. Kemi me vete skicat e zbrërthyerat të dekorit. Tregoja, Male!

Përgjegjësi dëgjoi me vëmendje. Nuk tha as po, as jo. I mori skicat njërën pas tjetrës, i pa me kujdes e vetëm pas kësaj tha qetë:

— Dekor i bukur.

I pa edhe një herë dhe ia ktheu piktorit duke shtuar:

— Më vjen me të vërtetë keq, po s'ju ndihmojmë dot. E kemi të ndaluar të punojmë për institucionet, se jemi repart shërbimesh!

— Po të jetë për leje nga seksioni juaj, besoj se edhe ata do të na kuptojnë.

— S'ka mundësi. Keq më vjen, po jemi shumë, shumë të zënë. Klienti vjen në kohën e caktuar dhe do porosinë, s'pyet ai se ç'kemi bërë ne.

Drejtori tha se kjo ndoshta rregullohej, s'qe ndonjë punë kushedi çë për një ndërmarrje; ishte çështje feste e inisiative dhe këto, dihet, kanë rëndësi

politike e ideologjike, po përgjegjësi kundërshtoi, duke thënë se punët e ndërmarrjes i dinte ai dhe se nuk qe faji i tij në qoftë se premiera nuk do të dilte në kohë.

Ndërkaq Peçi ia kishte marrë skicat piktorit e po i kqyrte afër, larg. Piktori ia shpjegonte detajet. Peçi shikonte skicat e dëgjonte piktorin me një simpati të dukshme.

— Shumë i bukur do të dalë. Ti ditke edhe nga zanati ynë, qenke edhe si inxhinier. Eh, po shkolla shkollë, thuaj! — psherëtiu Peçi.

Drejtori e skenografi i teatrit u përshëndetën me të dy e dolën. Në zyrë pas tyre një copë herë zotëroi heshtja.

— Ku e patëm fjalën? Se, ja, për çfarë kërkesa nuk vijne këtu! Të duhet të merresh me lloj-lloj njerëzish e të shkon koha, po punën tënde s'ta bën njeri.

Përgjegjësi fërkoj llapën e veshit e shtoi ngadalë:

— E ke të qartë si do t'i bësh?

Peçi mori skicat e doli. Ai shkoi drejt e në repart. Një copë herë kërkoi pjesët e bufe-bibliotekës që do të montonte. I kontrolloi e i gjeti të përgatitura dhe filloi menjëherë nga montimi. Kjo ishte një bufe-bibliotekë mjaft e ndërlikuar. Pikërisht prandaj e kishte thirrur përgjegjësi, që ta sqaronte mirë. Tani ai e kishte më se të qartë e puna shkonte mirë.

Por çak e çuk sqepari e dang e dung jehona në trurin e tij. Kjo jehonë padashur e papritur sillte diçka tjetër, që s'i hynte në punë në montimin e bufe-bibliotekës: një ngjyrë, një shkallë, një telajo të madhe me dritare. Ai qëndroi dhe e kapi të tërën.

Në sytë e mendjes iu fiksua skica me ngjyra e dekorit të teatrit.

«Dekor i bukur vërtet. Piktur me fantazi e talent. Do të qe gjë e bukur t'i kishim edhe në të pikturuara objektet që bëjmë. Kjo të nxit. Edhe skicat teknike i kishte bërë punë e madhe, të thjeshta, shumë të qarta. Djalë i shkathët!» mendoi.

«Po të gjykosh nga dekori, shfaqja do të jetë e bukur. Dekori ka dritë e ambient. Po ç'e do, s'e shihkemi dot për festë!»

Peçi i pëlqente teatri. Vinte në të gjitha shfaqjet që jepeshin në qytet, qofshin këto të trupës së qytetit a të qyteteve të tjera që vinin për shfaqje në qytetin e tij. Ai vetë ishte anëtar i grupit amator të ndërmarrjes. Po kjo s'qe e tëra. Në pasionin e tij për teatrin kishte ndikuar i kunati, Berti.

Berti punonte në park. Ashtu si tifozët e futbollit, ai ishte tifoz i teatrit, veçanërisht i teatrit të qytetit të vet. I dashuruar me të, shfaqjet i shihte nga dy e nga tri herë. Sido që ta kishte punën, gjente kohë e mundësi për të vajtur bile edhe në prova. Berti ishte bërë njeri i brendshëm në teatër, i njohur e i mirëpritur. Kur trupa dilte në turne, s'kishte pse të lodhej për makinë që të transportonte dekoret. Këtë punë e mbaronte Berti njëlloj sikur ta kishte detyrë të tij.

«Mirë bën. Në fund të fundit asnjë rregull nuk shkel.»

Peçi vetiu bëri një krahasim ndërmjet asaj që bënte i kunati dhe asaj që kishte ndodhur disa çaste më parë në zyrën e përgjegjësit. Përgjegjësi s'kishte bërë mirë, jo, s'kishte bërë mirë. Nuk ishte thelluar në hallin e teatrit. Drejtori vetë kishte ardhur gjer këtu. Në qytet asnjë ndërmarrje s'mund ta ndih-

monte, s'kishte mundësi. Dhe për një punë jo kushe-  
di çfarë, teatri ishte i shtrënguar ta shtynte për ca  
kohë premierën e re, kurse në qytet jo rrallë thoshin:

«Hë, po ç'bëjnë këta artistët tanë? Ka kohë që  
s'kanë nxjerrë gjë të re!»

Teatri mirë i paskësh punët, inisiativë kishte  
marrë, festa po vinte e premiera ishte gati, po s'je-  
pej dot. . .

Peçin s'po e nxinte vendi. Po i punonte mendja  
gjithë atje, i bëhej se ishte edhe ai i brendshëm në  
teatrin e qytetit dhe e ndiente shqetësimin e trupës.  
Së fundi s'u mbajt dot më e i vajti përgjegjësit në  
zyrë.

— Hë, ke ndonjë gjë të paqartë akoma?

— Jo, xhanëm, montimin e fillova, andej jemi  
në rregull.

— Atëherë?

— Nuk bëre mirë që i përcolle.

— Aha! . . . Nuk qe e mundur, Peçi. Fundja  
s'kemi për t'u merakosur për tërë hallet e qytetit  
ne! Mjaft i kemi tonat!

— S'jemi dhe aq të ngarkuar sa e bëre ti. Për ne  
ajo është një punë fare e vogël; ata kanë marrë edhe  
inisiativë. . .

— Nuk jua kemi fajin ne! Le t'i mendojnë me  
kohë, jo kur u vjen veza për të dalë!

— Po ti e dëgjove që e kanë marangozin të  
sëmurë?

— Ehu! Sa dëgjoj përditë këtu unë!

— S'bëre mirë! — këmbënguli Peçi.

Përgjegjësi e pa me vërejtje.

— E kemi punën të shtrënguar, po ti s'e di mi-  
rë — tha shkurt.

— Megjithatë. . .

— Si megjithatë?

— Bëhet! — tha Peçi me bindje të plotë. — Ç'është për ne ajo! Kurse atyre ua zgjidh problemin.

— Ti tetorëshin ke. Me popullin kam të bëj unë. Ty s'të dhemb koka kur unë s'di si t'u jap përgjigje klientëve, kur s'ua kemi plotësuar porosinë me kohë.

— Jo, xhanëm, kaq indiferentë s'jemi ne. Ti druhesh se priset plani, nuk them se s'do. Ama, po ta shohim më mirë, më thellë... Që të mos pengohet puna, unë e ca shokë mund të punojmë nga një orë më shumë.

— Këtë s'ma lejon njeri mua!

— E po të duam vetë ne?

— Do të rrini sot, s'jeni për punë nesër. Pranoni sot, nesër thoni që u shtrëngova unë. Jo, jo!

— Kot që e bën kaq të madhe. S'është për kaq ajo punë.

Tringëlliti zilja e telefonit. Përgjegjësi e mori e foli:

— Mirë, shoku Qemal, mirë... Kanë ardhur te ju? Unë ua thashë qartë që s'është e mundur... Çështje rregulli, thua? Edhe rregulli, edhe mundësie praktike. Jemi aq të zënë këtë muaj, saqë shtrëngohemi t'i kthejmë klientët pa ua plotësuar kërkesat... E shohim edhe një herë, meqë thoni ju, por...

Si e la telefonin, përgjegjësi mori ca fatura e shkresa e po i vërtitte në dorë njëlloj si kalemin. Peçi s'ia ndante sytë.

— Kot e sorollat, s'është ndonjë punë kushedi që — tha:

— E bën ti?

— E bëj! Më jep mundësinë dhe e bëj!

— Mirë. Kur është kështu... Çfarë do?

— Dy ditë kohë.

— Mirë, shko që tani!

«Kërkon të shesë mend ky!» tha me vete, duke qenë i bindur se nuk do t'ia dilte dot. «Po më mirë kështu, që të mos më çajë veshët më, le ta provojë një herë e të shohë»!

Një mendim të përafërt Peçi takoi te drejtori i teatrit, kur i tha se kishte vajtur të fillonte nga puna. Mos ishte hedhur si shumë? Dy ditë...

— Këto s'janë punë për drejtorë — vërejtji Peçi. — A do të më ndihmojnë këta shokët? — shtoi duke treguar piktorin dhe punëtorët e skenës.

— Po, po, të gjithë! — shprehu gatishmërinë drejtori.

Peçi e piktori Male i kontrolluan edhe një herë skicat e llogaritjet e bëra në to, duke i përqasur me skicën me ngjyra. Kur piktori u ngrit, sepse kishin mbaruar me llogaritjet, Peçi e boshatisi skenën e nxori nga xhepi i kominosheve një shkumës.

— Për ty mbase është i qartë përfytyrimi, po për mua jo; unë dua ta shoh ca më vendshe.

Ai zuri të hiqte ca vija të gjata të bardha kryq e tërthor skenës së gjerë. Kur e kur kruante kokën, shikonte vijat e bardha, skicat, vijoste përsëri. Piktori mori t'i ndihmonte.

— Më lër mua ti, dua të mbush mendjen vetë unë! Që të mos humbasim kohë, dërgoje lëndën dhe masat me punëtorët që t'i presin në makineritë tona.

Vetë vinte e vinte nëpër skenë, bënte vija të bardha, e shikonte duke kruar kokën e këndonte ngadalë:

*Nënë portokalle, moj  
rrinim të dy bashkë...*

Punëtori i skenës u kthye.

— Hë?

— S'pranoi. Sa ndihmësa do ai shoku Peçi? Apo doli nga dera e kërkon të hyjë nga dritarja? Kështu më tha.

— Ashtu, ë? Mirë!

Peçi u sul poshtë në sallë e drejt e te telefoni i dezurnit të teatrit. Formoi një numër i nervozuar.

— Shoku Telo? Peçi jam. Pse na pengon, me dorë do t'i sharroj unë? S'e kishim kështu fjalën. Ti do t'i presësh se s'bën! Ç'janë këto?..

— Është zemëruar me mua, po s'ka gjë, puna të ecë. Shko edhe një herë ti — i tha punëtorit që po priste.

Në mbrëmje arritën edhe dërrasat e sharruara sipas masave e përllogaritjeve.

— Tani po, tani na e jep atë kafënë, o djalosh, jo atëherë në valën e punës kur deshe ti!

Piktorit po i pëlqente ky punëtor me humor të mirë, po edhe disi i pakuptueshëm. Vala e punës? Çudi!

Drejtori erdhi edhe një herë kur filluan montimin e dekorit.

— S'ke besim, duket sheshit kjo! — gesëndisi Peçi.

— Jo, s'kam besim, por kam merak! — tha drejtori.

— Për këtë ke të drejtë, po edhe shumë shumë nuk para besoni ju, drejtorët, përgjegjësit... Tani fli i qetë.

— Po ju?

— Ne do të punojmë edhe ca.

— E sheh? Edhe ti vetë ke një farë dyshimi, më duket!

— Zotimi është zotim. Më mirë ta kemi punën përpara. Natën punohet më mirë, s'të bezdis njeri.

Peçi tha të shkonte dhe piktori, atij i duhej vetëm njëri nga punëtorët dhe tani për tani le të rrinte cili të donte, më pas të vinte tjetri e të ikte ky. Por as piktori e as punëtorët nuk pranuan të shkonin.

— Si të doni. Unë ju dola nga borxhi!

Ai montonte pjesë të dekorit, shkonte tutje në sallë e i shikonte që atje, shikonte skicat. Dhe gjithë këndonte lehtë:

*Nënë portokalle, moj,  
rrinim të dy bashkë...*

Aty nga mesi i natës dekori ishte ngritur si skelet.

— A shkojmë e marrim një sy gjumë tani?

Për të tre punonjësit e teatrit ai ishte bërë vetiu si komandant. Të tre bënin ç'u thoshte ai, pa u mër-zitur. Cili e cili t'i plotësonte kërkesën këtij njeriu të çuditshëm që po e kalonte natën duke punuar, i qeshur e duke kënduar, në skenën e tyre. I kishte bërë për vete tërësisht, si i thonë fjalës.

Të nesërmen, kur ai u kthye në skenë, ata i gjeti atje. Për të kjo s'qe ndonjë gjë e papritur, ata kështu duhej të bënin, por i erdhi e papritur që gjeti aty edhe përgjegjës in e tij.

— Ç'kemi, shoku përgjegjës? — e përshëndeti.

— Erdha t'ju shihja një herë.

— Faleminderit!

— Do ndihmë tjetër?

— Jo, jemi në mbarim.

— Çudi! Druhem se keni bërë punë me cilësi të dobët.



— Ja tek i ke, shih. Ca pjesë janë prapa perdes. Përgjegjësi erdhi rrotull, duke i parë me kujdes.

— Të lumtë! — tha.

— Edhe këtyre.

— Ju lumtë, ju lumtë! Mua s'ma merrte mendja që t'i bënit kaq shpejt.

— Sot njihemi, thua?

— Nuk thashë ashtu.

— The, si s'the. S'pate besim, ç'të thoshe më tepër? Bile, që të dilte fjala jote, nuk deshe t'i lejoje të sharronin në makineritë tona!

— Lëre tani. Unë e dija te teatri ka makineritë e veta.

— Ndoshta është kështu. S'mund të arrij në përfundimin se s'deshe të bëhej kjo punë, ama që s'e kuptova drejt e që s'ishe i prirur ta kuptoje, këtë e them me bindje të plotë.

— Më dukej punë e koklavitur, e them sinqerisht. Për këtë edhe më erdhi gudi kur ti u zotove ta bëje vetë.

Peçi ngriti kokën dhe e pa në sy. Përgjegjësi diçka murmuriti. Në fytyrën e tij zakonisht të qetë lëvizi një muskul. Lëvizi fort një herë, dy. Peçi e vuri re, qeshi e vijoi punën duke kënduar.

Atë çast në sallë po hynin aktorët. Hynin e s'u zinin besë syve të tyre. Ç'kishte sjellë kështu kjo natë. Regjisori tha i kënaqur se tani mund t'i bënin në skenë provat e fundit dhe se premiera do të realizohej patjetër në kohë.

## NJERIU YNË

*Shokut P.K.*

E shoh vazhdimisht. Herë më këmbë e herë me biçikletë a motokarro, duke shkuar në punë apo në ndonjë mbledhje, në dhomën e veteranëve a në ndonjë takim e bisedë me punonjës e nxënës, ai është gjithë në lëvizje e bën një jetë tepër aktive. E njohin të gjithë në qytet, të mëdhenj e të vegjël, këta ca më shumë. Me shtat mesatar, njeri i thjeshtë e gazmor e përshëndetin e përshëndet majtas e djathtas kudo që kalon.

Rrëfimet e tij janë të qarta e të thjeshta, të ngjeshura me aksion e ndjenjë. Gjithnjë ato më emocionojnë e, sapo ndahem prej tij, hedh në fletore mbresat e mia bashkë me copëza nga jeta e bëmat e tij...

Në fillim u dëgjua një krismë mortaje, pastaj dy radhazi më afër e më të forta. Kërcitën trarët e shtëpisë e u drodhën xhamet e dritareve.

«C'bëhet?» pyetën njëri-tjetrin me sy partizani Pano dhe infermieri që po ia lidhte kokën me fasho.

Disa ditë më parë Panoja ishte plagosur në për-

pjekje me gjermanët. Një predhë kishte plasur fare pranë tij dhe e kishte copëtuar shkëmbin, një mori ciflash guri e patën goditur në kokë e në fytyrë. Ai kishte sharë me inat e s'i ishte ndarë pozicionit. Ata që e kishin parë të gjakosur, ishin trembur, por ai ua kishte sqaruar ç'lloj plagosjeje që ajo duke i ardhur turp prej saj. Mjeku e kishte detyruar të mos e nënvleftësonte plagën, mbasi, siç thoshte ai, kokëkrisurit gjithnjë e pësojnë nga nënvleftësimi i gjërave të quajtura të vogla.

Në rrugën e fshatit u dëgjua zhurmë hapash të nxituar. Infermieri zgjati kokën në dritare.

— Pregatitje për marshim! — tha.

Dikush hyri në dhomë e gjithçka u sqarua menjëherë. Brigada do të kalonte përtej Ostrovicës. Një skuadër ishte caktuar për të siguruar tërheqjen. Ky short i kishte rënë skuadrës së Panos. Panoja rrëmbeu pushkën e vrapoi të bashkohej me shokët. Në rrugët takoi komandantin e komisarin e batalionit. Ata diç biseduan midis tyre. Panoja e mori me mend që folën për të.

— Ti je i plagosur e do të vish me ne — tha komisari.

— Si, me ju...

— Me forcat kryesore.

Panoja ia nguli sytë komisarit, pastaj komandantit. Ky tundi kokën në shenjë miratimi për sa kishte thënë komisari.

Të shkonte me forcat kryesore, ndërsa skuadrës së tij i që besuar një detyrë me aq rëndësi e me rrezik koke? T'u mënjanohet ai, Panoja, kësaj detyre, këtij rreziku?

— Ku janë tani shokët e mi? — pyeti.

— Tek ura.

— Unë e kam vendin tek ura!

Fjalët e tij genë kaq të prera, saqë eprorët nuk ngulën këmbë. Panoja u vërsul tatëpjetë drejt urës.

Ura! Dy trarë të gjatë hedhur mbi shkëmbinjtë masivë, të vetmet këmbëza e mbështetje. Pa parmakë, me ca pllakoma sipër trarëve, ura lëkundej edhe nga era e jo më të shkoje mbi të. Poshtë Devolli i egërsuar buçiste për tmerr, uji përplasej nëpër shkëmbinjtë, llokoçitej, s'gjente drejtim e shkumëzohej. Stërkala të ftohta ngjiteshin deri te trarët e urës; edhe që atje, edhe nga shkëmbinjtë vareshin krongjij akulli. Dëborën e kishte ngrënë lumi, por era qe e ftohtë.

Panoja zuri vend pas një guri të madh e s'ia ndante sytë urës e rrugës më tej.

«Urë e çuditshme, thoshte me vete, të shkojnë të ngjethura t'i afroresh, megjithatë kemi kaluar disa herë, bile edhe natën. Urë e guximit!»

Atij i pëlqeu ky emër që gjeti për urën. E guximshme vetë ura që kolovitej mbi atë lumë të shkumëzuar, të guximshëm ata që e përdornin, të guximshëm e të fortë, si shkëmbinjtë që e mbanin.

«Gjermanët do të kalojnë këtu se s'bën. Gjetkë zor se kapërcehet Devolli në këtë kohë.»

Papritur ai ndjeu dëshirën t'i shihte pushtuesit e huaj kur të shkonin me frikë në zemër e sharje në gojë në atë urë të çuditshme.

«Në rëntë ndonjëri, s'ka për të arritur i gjallë deri poshtë, do të vdesë nga llahtaria që në ajër!» tha.

Ndërkohë në xhade tek ura u dhanë gjermanët. Komandanti i skuadrës njoftoi që të bëheshin gati për zjarr. Urdhri u përcoll gojë me gojë.

Partizanët hapën zjarr të parët, pararoja gjermane u çorodit e pësoi humbje të menjëhershme. Gjermanët e morën veten shpejt e kundërsulmuan me

tërë llojet e armëve që kishin. Skuadra partizane s'u tund fare. Vendi që më se i përshtatshëm e skuadra u qëndroi për dy orë rresht dyqind e ca gjermanëve. Në atë mbrojtje ata s'kishin ç't'u bënin. Kur e kuptuan këtë, gjermanët iu ngjitën malit për-pjetë për të qëlluar nga një pikë më e lartë. Ndërkaq tërheqja e brigadës që siguroar e skuadra mund e duhej të tërhiqej edhe ajo.

Këtu filloi vështirësia. Nga pikat dominuese që zunë, gjermanët qëllonin dendur e mjaft saktë. U plagosën dy partizanë, pastaj edhe Lena, shoqja e mirë e Panos. Panoja u ndodh pranë dhe e kapi kur ajo për pak do të rrëzohej nga shkëmbi. E mbështetur tek ai, ajo u mbajt e eci më tej, sido që s'e pati të lehtë. Më tutje gjermanët sikur i harruan krejt. As krisma, as lëvizje. Ku vajtën? Ç'drejtim morën?

Skuadra tërhiqej ngadalë, me vështirësi, sepse mbarhte të plagosurit. Në errësirën që u dynd grykave, mezi arritën në një fshat në rrëzë të Ostrovicës. Trokitën në shtëpinë e parë që panë.

— Kush është? — u dëgjua një zë prapa portës.

— Partizanë.

— Shëëëët!

Llozi kërciti lehtë e porta u hap ngadalë, fare pak, sa për të nxënë një njeri. Doli një fshatar.

— Tungjatjeta! Vdekje fashizmit! — përshëndeti me zë të ulët. — Po si kështu, a nuk i shihni mortajat e mushkat në oborr? Gjermanët kanë pllakosur në fshat.

Paskëshin arritur këtu!

Panoja vetiu hoqi pushkën nga krahu. Kjo që një e papritur për ta.

— Në odat lart flenë disa syresh.

— Në shtëpinë tënde?

— Ëhë!

— Ç'na thua, bre! — tha komandanti i skuadrës.

Fshatari tha se, me t'u vendosur në fshat, erdhën edhe në shtëpinë e tij. U printe një ballist. Duke për-kthyer gjermanin, ballisti pati shpjeguar se, po të pësonin gjë ata, ai e familja do të fshiheshin me gjithsej nga faqja e dheut. Pas këtij kërcënimi, kishin rënë e tani flinin si të vdekur.

— Çudi! — tha skuadërkomandant Nafizi.

Nuk ua merrte mendja që gjermanët të kishin dalë përpara e t'ua kishin prerë rrugën e tërheqjes.

— Ne kemi edhe të plagosur.

— Sa?

— Një shoqe e dy shokë.

Fshatari u mendua një çast të vetëm.

— I lini këtu — tha.

— Te gjermanët?

— Jo, tek unë. Do t'i veshim teartil e të rrinë me ne. Nuk është e lehtë kjo punë, por as e pamundur s'është.

Mendimi i tij qe i guximshëm.

— Mirë — e miratoi e para Lena, pasi nuk deshë t'u bëhej barrë shokëve, megjithëse i pikonte në zemër të ndahej prej tyre.

— Jo — tha skuadërkomandant Nafizi. — Të dy ju kuptoj e ju lumtë për atë që merrni përsipër, po kjo s'bëhet, është me shumë rrezik. A na udhëheq dot për të çarë gjëkund?

— Pritni!

Ndërsa partizanët u mbështetën pas murit, ai ngadalë e pa u ndier hyri brenda e po ashtu shpejt u kthye me një tepsë me bukë misri. Buka qe e ngroh-

të, e porsanxjerrë nga zjarri. Partizanët e ndanë aty për aty.

— Duhet të mbahemi në stanet e Ostrovicës, — tha — nuk janë larg.

— Ti kthehu, se ngjall dyshime. Ne do të bëjmë si të bëjmë.

Dhe komandanti i skuadrës partizane kërkoi sqarime për drejtimin që duhej të ndiqnin për të vajtur atje.

Në errësirë e të lodhur, partizanët që siguruan për bukuri tërheqjen e brigadës, arritën në stanet aty nga mesi i natës. Stanet qenë ca mure guri me gjysmë çatie shkarpash. Brenda ishte thatë dhe era që pengohej nga muret, nuk kishte më fuqi.

Bënë zjarr me karthje të shkulura në çati. Në dritën e flakëve panë njëri-tjetrin, e buzëqeshën vetiu, sikur në këtë mënyrë të jepnin njëzëri përfundimin e qartë të suksesit. U ngrohën e u shkrifëruan e dremitën lehtë e ëmbël. Po të përjashtojmë rojën që ndërrohej shpejt dhe rënkimet e përmbajtura të të plagosurve, atë çast ata i ngjanin një grupi udhëtarësh që i kishte zënë nata në stanet.

Ka edhe në ditët më të ashpra të luftës copëza jete të zakonshme. Kjo ndodh sidomos pas kryerjes së një aksioni a detyre me rëndësi, kur mbledhesh në një strehë të mbrojtur, larg rrezikut e veçanërisht kur në mes brambullin zjarri, i cili të afron me jetën e familjes, me të afërmit, me shtëpinë.

Ndryshe nga përfytyrimet e natës rreth zjarrit, mëngjesi në Ostrovicë që i ashpër. Fërshëllente era, re kokrrizash dëbore rrafshonin gropa e boshllëqe. Në njërën anë të stanit dëbora e hedhur me erë kishte vajtur deri në lartësinë e murit.

Ku do të shkonin më tej? Çfarë do të bënin? Ku

qe tani brigada e qe nga mund të shkohej për ta arritur?

Poshtë, rrëzë malit, sigurisht kishte gjermanë. Ç'drejtim do të ndiqnin ata, vallë? Në krahasim me ta dëbora dhe të ftohtët e Ostrovicës qenë më të pranueshëm, më të afërt. Mirëpo buka e misrit që u dha fshatari në mbrëmje ishte vetëm një frymë. Fshatari s'po dukej... Pastaj... të plagosurit... Ç'do të bëhej me ta?...

— S'ka rrugë tjetër, shokë, veçse përpjetë Ostrovicës. Nga ana e kundërt do të takojmë me siguri brigadën — tha Nafizi.

Ky mendim nuk kishte pse të diskutohej.

— Mirëpo na duhet bukë, ndryshe do të ngelemi. Pa duhet edhe ndonjë gjë për të mjekuar shokët e plagosur. Me gjithë rreziqet e mëdha, disa duhet të zbresin në mbrëmje në ndonjë fshat xheç të sigurojnë.

Partizanët e miratuan mendimin e tij e shprehën gatishmërinë të gjithë.

— Do të shkosh ti, Selman, ti, Pano, e ti, Vatë! — tha komandanti.

Pa u errur mirë të tre partizanët e caktuar përcaktuan me afërsi drejtimin e bënë tatëpjetë. Në mbrëmje hynë në një fshat. Nuk e dallonin dot nëse qe po ai fshat ku ranë një natë më parë apo tjetër. Në dukje s'kishte asgjë shqetësuese. Drita të vogla, të zbeta, mezi çanin aty-këtu errësirën. Vetëm sa për të treguar bardhësinë e ftohtë, krongjijtë e strehëve e çatitë e ngarkuara rëndë. Ato dritëza dukeshin si të harruara diku e të futura thellë, thellë.

Tre shokët u afruan te njëra prej tyre. Selmani e Vata zunë vend në gatishmëri lufte. Panoja trokiti në portën e jashtme të një shtëpie. Trokitja e parë



u zhyt në errësirë e mezi e dëgjuan edhe ata vetë. E dyta qe më e fortë e disi këmbëngulëse. Si përgjigje erdhi një «Alt!» dhe një fashë drite nga ana tjetër e rrugës. Partizanët u shtrinë barkazi në dëborë. Alt-i u përsërit e pas tij vrapuan nga të gjitha anët gjermanë e ballistë duke qëlluar.

«U diktuan, tha me vete Panoja. Dhe u diktuan keq, pa bërë gjë prej gjëje!»

Nga zemërimi hapi zjarr. Këtë nuk duhej ta bënte. Në drejtim të tij u shkrehën disa batare. Në të dyja këmbët ndjeu pickime të forta, shau e qëlloi rishtazi.

— Tërhiq shpejt! — urdhëroi Selmani duke qëlluar edhe ai.

Panoja nxitoi pas Vatës.

Diku qëndruan e vunë re se krismat tanimë dëgjoheshin larg. Kishin shpëtuar! I ndihmoi mjegulla që e forconte edhe më errësirën e natës, i ndihmoi era që i mbulonte aty për aty gjurmët e tyre. Një copë herë shkuan në heshtje njëri pas tjetrit pa drejtim të caktuar, veç të largoheshin sa më shpejt e sa më shumë nga armiku. Panoja shtrëngonte dhëmbët. E kuptoi që qe plagosur, po nuk deshë të jepej e luftonte me veten me durim.

Kur u doli përpara një humnerë, qëndruan për t'u orientuar. Selmani bëri disa hapa në të majtë e në të djathtë, u kthye pas, gjithë duke kontrolluar me kujdes vendin. I bëhej se ngado qe njëlloj, bardhësi e shkretë, errësirë e mugët. Kërkoj në xhëp e ndezi një cigare. Befas u ndal i trembur. Atje ku ra eshka e ndezur, në gjurmët e porsabëra, dalloi kokrriza dëbore të përgjakura. U ul e ndezi një leckë për të parë më mirë. Po, ishin kokrriza të

spërkatura me gjak, që formonin një vazhdë në dëborën e hapur nga vetë ata.

— Kush është plagosur? — thirri.

S'mori përgjigje.

— Kujt i rrjedh ky gjak? — thirri edhe më fort.

Si s'mori përgjigje përsëri, eci i përkulur pas gjurmëve. Drita e dobët e leckës së ndezur u vu në ndjekje të vazhdës së gjakut, e cila diku skuqte e diku nxinte. Vazhda e çoi drejt e te Panoja. Atje ku qëndronte Panoja, ishte skuqur një goxha vend.

— Je plagosur, Pano? — e pyeti Vata duke e shkundur për krahësh. Panoja s'e hapi gojën fare.

— Ti je plagosur e s'na thua? Budalla! — e qortoi Selmani.

Me të thënë kështu, ia drejtoi dritën në fytyrë. Panoja qe zbehur e përpëliti sytë. Selmani kujtoi se ky qe refleksi i mbrojtjes nga drita dhe e hodhi atë leckë, po Panoja u epua e do të binte, po të mos e mbante Vata. Trupi i tij u bë krejt i plogët e si pa jetë. Vata s'arriti dot ta mblidhte veten e të dy u përplasën në dëborë.

— Të fikët? I ra të fikët? — pyeti i shqetësuar Selmani.

— Po, pa dyshim. Pikërisht të fikët! — tha Vata e psherëtiu, sepse një çast më parë edhe atij i kishte vajtur mendja për më keq.

Selmani u ul. Ia preku pulsin e ia fërkoji ballin të plagosurit.

— E ka duruar dhembjen tej masës — tha.

— Sedra. Ky është njeri me sedër të madhe — tha Vata.

Të dy mbushën grushtet me dëborë e i fërkuan me të fytyrën, zverkun, damarët e qafës, duart. Pa-

noja u përmend e kërkoi ujë. Vata bëri një shuk me dëborë e ia shkoi dy-tri herë në buzë. Selmani kërkoi dhe e gjeti vendin e plagës. Kur ia lidhi pulpën, Panos i ra sërish të fikët. Selmani bëri të ngrihej, po sytë i ngelën te një mballomë e ndragur me gjak në këmbën tjetër të të plagosurit.

— Qenka plagosur në të dyja! — tha e psherëtiu thellë.

Një krismë çau ajrin e ftohtë.

— Po na ndjekin! — tha Vata.

— Është e drejta e tyre. Maskarenjtë! — shau Selmani.

— Po të mbajmë parasysh që në dëborë krismat nuk para dëgjohet, do të thotë se s'janë larg.

— Dhe në dallofshin gjurmë gjaku... Mos u tremb! — i dha zemër vetes e shokut Selmani.

Një krismë tjetër. Pastaj një fjollë e zjarrtë aty poshtë dhe një breshëri edhe më e gjatë pas saj.

— Keq e kemi. Përpjetë s'mund të ikim, se na arrijnë.

Vata shikoi me vëmendje honin e errët pus.

— Ç'mendoresh?

— Them se ky rrëzimi na shpëton.

— Ç'do të thuash me këtë?

— Në rast se zbresim tatëpjetë, mund t'ua hedhim. E para, se fitojmë kohë, mbasi nuk do t'u shkojë mendja që jemi hedhur në humnerë; e dyta, ato vështirësi që marrim përsipër të kapërcejmë ne, si zor t'i hanë ata, veç të tjerash edhe sepse i ruhen ndonjë të papriture.

— Nuk e ke keq. Po Panon?

— Prit, — tha Vata — ta provoj një herë vetë. Në është pjerrësia e njëjtë, shkasim punë e madhe së bashku me të.

Atje poshtë, errësirës, mjegullës e të ftohtit u shtohet edhe buçima e potershme e një përroi. Në një hon të errët në vend të panjohur në fillim buçima e ujit është tepër e frikshme. Mirëpo njeriu mësohet shpejt me çdo gjendje.

Panoja erdhi në vete kur e kishin tërhequr nga njëqind metra tatëpjetë. S'po merrte vesh gjë prej gjëje.

— Po tani? — pyeti Vata.

— Përpjetë! S'ka rrugë tjetër! — tha Selmani. — Rrëzat janë zënë kudo nga gjermanët. Tani s'na mbetet veç të largohemi sa më tepër. Kur të hapë dita, do ta shembëllemë më mirë vendin. Atëherë shohim e bëjmë. Pano, si ndihesh, mor bir?

— Ujë! — rënkoi Panoja e lëpiu buzët.

— Vetëm për ujë nuk vuajmë!

Ia lagën sërish buzët me dëborë.

— Tani pa hip këtu kalibhoç! — tha Vata duke qeshur.

— Jo, jo, s'bën. Më mirë më mbani për krahësh, do të përpiqem të eci vetë.

— Hajde, hidhmi duart në qafë, mbahu fort e mos bëj llafe.

Dhe u nisën kështu, dy më këmbë e një ngarkuar.

Ik e ik nëpër natë, pa ditur se ku, gjithnjë rrëzë malit vezë nga dëbora, përbri përroit që i shoqëronte në të kundërt.

Panoja ndiente si diaste shoku e i vinte rëndë. E mbuluan djersë të ftohta.

— Vatë, qëndro, unë mund të eci vetë!

— Hajde, pusho!

Pastaj e mori Selmani. Selmani që shpinëgjërë e qafëtrashë.

— Te ti qenka si në dyshek! — bëri shaka Panoja.

— Ashtu, po ç'thoshe ti!

Panoja u habit me veten e tij. Disa çaste më parë i vinte rëndë, tani bënte edhe shaka duke qenë barrë mbi kurrizin e shokëve. Këtu natyrisht edhe përshtatja ka të bëjë, po edhe ngrohtësia shoqërore. Çdo njeri, ai që është në të keq ca më tepër, e ndien dhe e kupton fare mirë nëse diçka për të bëhet nga e keqja, si një farë angarie, apo me dëshirë e vullnet të plotë, si detyrë e mirëpranueshme shoqërore.

Duke e marrë më kurriz herë njëri e herë tjetri, ai vinte re se atyre jo vetëm që s'u rëndej, po bënin çmos t'ia hiqnin drojtjen.

Ishte ftohtë, por asnjëri s'ankohej prej saj. Udhëtimi dhe Panoja që kishte zjarrmi nga plagët i nxehën ata që ecnin. Uria kishte zënë të bëhej e bezdisshme, por akoma jo e padurueshme, nuk nxirrte kokë shumë, mbase sepse ia kishte zënë vendin tensioni i rrezikut gjerman.

I përkundur nga ecja e ngadaltë, nga zhurma monotone e hapave në dëborë si dhe nga zhaurima e përroit, Panoja u kot në një gjumë të butë e të çuditshëm. Ndiente hapa, ndiente zhaurimë e megjithatë flinte. Edhe se e dëgjonte bisedën, nuk merrte vesh se ç'thoshin. Zgjuar ishte a fjetur? Fjetur a në kllapi?

Dikur u përmend për një çast e diçka tha. Mabajti vesh si i trembur, po s'i kapi dot fjalët e veta; kishin fluturuar. Kishte folur, apo i bëhej se kishte folur? Shtrëngoi njëren dorë në supin e shokut dhe me tjetrën pickoi veten në qafë.

— Mos u mërzit, Pano — tha shoku dhe ngriti dorën lart, ia gjeti faqen e ia përkëdheli me dashuri,

ia gjeti dorën dhe ia shtrëngoi duke e fërkuar në të tijën.

Disa orë në kurriz e megjithatë shoku i kishte folur dhe e kishte përkëdhelur ëmbëlsisht.

«Eh, shpirti partizan, shpirti partizan!», tha me vete e zemra iu ngrit peshë. Në ato çaste shpirtërisht ndihej plotësisht i gatshëm të bënte çdo gjë, të jepte çdo gjë, edhe jetën, pa hezitimin më të vogël, madje me një ndjenjë të vërtetë kënaqësie për të shpërblyer mirësinë e sakrificën partizane, për të qenë edhe ai i denjë për këtë mirësi e sakrificë të pakrahasueshme.

Dalngadalë errësira po hollohej e paralel me të zhaurima e përroit zvogëlohej. Dita e re po agonte. Mugëtira e mëngjesit është kapitëse për ata që e kanë kaluar natën pa gjumë e me mundime, prandaj asnjëri s'po e vinte re. I pari që e ndjeu praninë e ditës së re, qe Panoja. Ai fërkoj sytë e vështroi rreth e rrotull afër, larg, duke u përpjekur të njihje kon-turet kryesore të vendit ku ndodheshin.

— Ej, po dalim në Çemerice! — tha.

— Çemerice?!

Shokët ndalën në vend menjëherë.

— Po, atë udhë ndjekim. Eh!

E zbritën me kujdes Panon, shtruan ca degë shkurrësh në dëborë e u ulën të tre mbi to.

— Brigadën, po të ecim në këtë drejtim, e arrijmë, ndërsa stanet i kemi lënë pas, larg, ndoshta më larg se brigadën.

Biseda e tyre s'ndahej kurrsesi nga shokët, veçanërisht nga ata të stanit të Ostrovicës, me të cilët i lidhte një detyrë më konkrete. Ç'bëjnë vallë ata? Presin akoma? Ç'hamendje mund të kenë sajuar për

tre partizanët e dërguar me shërbim që s'po u ktheheshin akoma?

— Punë e parë, ta shpiem Panon në një bazë të sigurt. Fshatarët këtej janë të gjithë me ne. Mirë, Pano?

Panoja u gëlltit e uli kokën. Ç'të thoshte. Që nuk pranonte? Që ia kishte qejfi të ishte me ta, kudo e në çfarëdo rrethanë? Këto tani s'hynin fare në punë; ai do të bënte atë që ta shihnin me vend shokët e shëndoshë, ata të cilët kishin mundësinë fizike ta vijonin kryerjen e misionit të ngarkuar. S'kishte të drejtë t'u rëndej me trupin e tij të plagosur e as me ankime e lutje. Kështu vetëm do t'i pengonte.

— Pastaj ne do të kthehemi te stanet. Gjallë a vdekur. Pa asnjë të dhënë, pa asnjë përgjigje, shokët do ta kenë keq, do të çoroditen. Mund të vihen për të na kërkuar e hasin në gjermanët që ne i alarmuam. Atje! Me çdo kusht! S'na lejohet të rrezikojmë një skuadër të tërë! — tha Selmani.

— Do të vdisja nga turpi sikur qoftë edhe njërit t'i shkonte mendja se i kemi braktisur, ca më keq sikur të kujtojë se i kemi tradhtuar — përforcoi Vata.

— Pano, ç'thuhet ti?

— Mirë. Vendim më i drejtë s'ka si bëhet!

Panoja uli kokën e trazoi me gisht dëborën përpara.

— Ti mos u mërzhit, Pano. Është e nevojshme të t'i mjekojnë këmbët e plagosura. Rrugë e pa rrugë kjo s'është e mundur. Do të të shërohen shpejt, ke për të parë. Ti je i ri e i shëndoshë dhe do të të shërohen fare kollaj. Atëherë do të takohemi se s'bën, tok me tërë brigadën. Kemi për të luftuar akoma mjaft ne deri në Çlirim!

Ndërkohë kishte dalë dielli. Dëbora shndritte e

të lbyrte sytë. Dielli që ngjitej lart ngrohnte disi. Dy shokët mblodhën këmbët nën vete, u shtrinë anash e i zuri gjumi. Panoja s'lëvizi fare. E kishte shpirtin të vrrarë, ishte në atë gjendje kur njeriut i vagëllohen ndjenjat e mendimet, trupi i liget e i plogështohet. Cili që shkaku kryesor? Ndonjëherë takohen disa shkaqe bashkë, të pleksura në mënyrë të pazgjijdhshme. Tani kënaqësia e vetme për të që se shokët po çlodheshin e po merrnin një sy gjumë pas një nate me aq peripeci. E vetmja gjë që ai mund të bënte, të mos lëvizte, që të mos zgjoheshin. Dhe ai s'lëvizi nga vendi, sido që këmbët, sidomos e majta, iu mpinë krejt.

Gërhitjet e shokëve qenë të lehta; çorapet e lesh-ta dhe fundet e palltove u qenë bërë kallkan, por ata flinin qetësisht.

«Eh, sa i fortë është njeriu! Shtrirë mbi dëborë, të pangrënë, të lodhur, flenë për shtatë palë qejfe!» mendoi Panoja.

Sido që mezi duronte pa i lëvizur këmbët e mpi-  
ra, as edhe një herë, as edhe për një grimë nuk pati dëshirën që ata të zgjoheshin sa më parë. Madje pro-  
vonte një farë kënaqësie të duronte sa më gjatë pa lëvizur për të mos i zgjuar, që shokët të pushonin ca e të merrnin veten për të kryer detyrën e mëtejshme.

Fërkonte kofshët deri te gjuri pa u ngutur.

«Duhet të kthehen te stanet, patjetër! Vata ka shumë të drejtë. Ç'do të mendojnë shokët për ne?... A do të kthehen dot te të plagosurit, vallë? Ç'tu them për...»

Selmani rënkoj, u shtriq e hapi sytë. Shkarpat e fërkua në dëborë prej tij zgjuan edhe Vatën.

— Sa fjetëm?

— As një orë.



— Po ti?

— S'më flihet.

— Mos u mërzit, Pano! Mos mendo për keq,  
o djalë!

Selmani u ngrit e çmpiu krahët.

\*

\* \* \*

U vunë sërish në udhë. Të duruarit pa lëvizur e kishte lodhur së tepërmi Panon. Sapo mbështeti kokën në supin e gjerë të Selmanit, ra prapë në gjumë-killapinë e mëparshme. Dikur dëgjoji krisma e një bisedë fare pranë, si brenda vetes së tij:

— Ramë keq, Selo!

— Ramë.

— Po do të qëndrojmë.

— Këtë as që e vë në dyshim.

— Ule ngadalë Panon dhe zër një vend.

Panoja u përmend dhe e kuptoi në çast të vërtetën me tërë ashpërsinë e saj. Kishin rënë në për-pjekje me gjermanët.

— Nga mbinë kështu papritur, kërmat? — tha e shtrëngoi dhëmbët sa i kërcitën.

Me një lëvizje të vrullshme e hoqi pushkën nga qafa, po me kondakun e saj e goditi padashur këmbën pikërisht te plaga e iu bë se u shemb diçka e madhe dhe e rëndë që e pllakosi të tërin.

Gjatë kohës së përleshjes nuk erdhi në vete. Kur u përmend prapë, përreth zotëronte një qetësi e kobshme.

— Ç'ndodhi? Ku janë shokët? Selman! Vatë!

Asnjë përgjigje. Zërin e tij e përpiu shkretëtira e bardhë e s'takoi në asgjë të përgjithshme. Ai u drodh.

«Të më kenë lënë?» mendoi. Pastaj u ngrit me zor në gjunjë për të parë e dëgjuar më mirë. Befasytë e tij u zgurdulluan e shikimi iu përshkëndit. Lëvizte ky shikim bashkë me kokën sa në një vend në një tjetër, gjithë në dy pika fikse. Disa hapa para tij të dy shokët të shtrirë, s'ndiheshin fare. Selmani kishte rënë përmbys; me njëren dorë shtrëngonte fort pushkën, tjetra kishte zhgërryer dëborën deri te dheu i zi dhe kishte mbetur aty e mbërthyer pas tokës. Vata ishte kthyer nga ana e Panos e kishte ngelur buzëqeshur, sikur të desh t'i tregonte ndonjë shaka.

— Vatë! Selman! — klithi Panoja.

Zëri s'pati jehonë

Panoja u ngrit rrëmbyer. Ndjeu një dhembje të madhe që ia përshkoi zemrën, ofshani fort, po shtrëngoi dhëmbët e për çudi nuk i ra të fikët. Pastaj, duke ecur më gjunjë, vajti te Selmani, i foli, e shkundi, po kot, një plumb e kishte marrë në kokë tejpërtej. Edhe i vrarë, i heshtur, dukej këmbëngulës e i paepur. Vata që akoma i ngrohtë. Me një shpresë të befasishme, Panoja e ktheu ngadalë, ia vuri dorën në zemër e i foli njëlloj si një të plagosuri. Por edhe Vata kishte mbaruar. Panos iu duk e habitshme një gjë: Kur po e lëvizte, ngado që kthehej, vështrimi i Vatës dhe buzëqeshja e tij e ngrirë mbeteshin të mbërthyera drejt tij.

— Vatë, vëlla! — tha Panoja e ra mbi të, i lodhur, i përhumbur.

Lotët i buruan vetiu e i shkisinin në faqe si ujë i ngrohtë. Për një çast iu bë se zemra po i kullonte butë-butë e ai lëng i ngrohtë i shkrinte tërë trupin. Lotët e tij njomën fytyrën e ngurosur të shokut që, edhe duke vdekur, kishte buzëqeshur.

Atje lart dielli i veshur me një napë resh të bardha qëndronte në rojë të kësaj skene të dhimbshme. Përreth dëbora ishte ndohtur nga shkëlja e dhjetëra gjurmëve.

— Ata u vranë për mua — tha Panoja e pshe-rëtiu thellë.

E përqëndroi vështrimin tutje si në pritje të diç-kaje.

— Pikërisht për mua! Po të mos isha unë, ata s'do të mbërtheheshin këtu, kishin mundësi të çanin duke luftuar. Dy vetë për gjysmë njeriu!

Pastaj se pse i shkoi në mendje një përfytyrim i llahtarshëm, lukuni bishash vërsulur mbi ta. U rrë-qeth nga ky përfytyrim. T'i mbulonte! T'i shpëtonte nga lukunia! Të paktën t'u bënte një shërbim të fun-dit shokëve. Në brez mbante një goxha thikë. E shku-li prej këllëfit dhe pastroi një copë vend nga dëbora. Dheu që i butë e dilte copa-copa si plis. Me thikën e madhe e me duar punoi me rrëmbim e pandërprerë derisa hapi varrin e përbashkët. I vuri pranë e pranë të dy shokët. Në atë pozicion ndenji e i shikoi gjatë. I puthi e filloi t'i mbulonte me dhe. Diçka iu kuj-tua, i puthi sërish e ua mbuloi fytyrat me kapelat e tyre, me yllin e kuq pranë ballit. Hoqi shaminë e kuqe nga qafa e tij e ua vuri sipër.

Prapë vijoi të hidhte dhe. Hera-herës bashkë me dheun binte në varr edhe ndonjë copë dëborë. Ai i hidhte tutje ato copa dëbore, a thua, po t'i linte, shokët, do të ngrinin.

Kur dheu i mbuloi krejt, u shtri i kapitur e lë-shoi një thirrje të gjatë e të rreptë. Iu bë sikur nga trupi iu shkëput një gjë e madhe, e fortë, dhe e ndjeu veten të vetmuar e si të humbur. Tani që të dy shokët ishin nën dheun e zi, tani që nuk i

shihte më, e ndjeu edhe më tepër atë që kishte ndodhur, e ndjeu edhe më tepër se ishte ndarë përgjithnjë prej tyre, se nuk do t'i shihte më kurrë dhe një lëmsh i madh i ngjit prej zemrës gjer te gryka e s'e linte të merrte frymë.

Me duar e rroba të ndragura me baltë u topit pranë varrit sikur vdekja po e rrëmbente edhe atë vetë.

Papritur diku feksën në mendje ca piketa kujtese: ura e guximit, stanet e Ostrovicës, Lena, shokët në pritje. Iu kujtua brigada dhe e përfytyroi në udhëtim njëshkolonë, në një varg të gjatë pa mbarim; mendoi skuadrën e vet dhe iu ngulën para syve dy pamje: Lena me duart e saj në të tizat dhe me vështrimin pyetës: «Do të vish? Vërtet do të vish?»; skuadërkomandant Nafizi me shokët e stanit në një pritje të ethshme duke thënë midis tyre: «Ç'u bënë? Si e patën hallin?» Dhe më tej: «Dikush duhet të zbresë në ndonjë fshat. Na duhen ushqime, na duhet ndonjë gjë për mjekim».

Ky përfytyrim i dha qartësi e i lindi shpresa:

«Unë duhet të rroj; duhet të mbaroj porosinë që s'e kryem dot bashkë, t'u tregoj shokëve se ç'na ndodhi. T'u tregoj si u ndeshëm me gjermanë e ballistë e natën dolëm në anën tjetër të Ostrovicës. T'u tregoj se si u vranë ata të dy për mua, gjysmë njeriu!»

Si tha këto, i dolëm para sysh Selmani i mbërthyer fort pas tokës, Vata, vështrimi e buzëqeshja e të cilit ishin tërësisht me të, miratuese për atë vendim.

«Ashtu, po, po!» — tha.

Aty në anë ishte automatiku i Vatës dhe pushka e gjatë e Selmanit. E hodhi krahaqafë automatikun, i vuri siguresën pushkës së gjatë të Selmanit dhe e

përdori si mbështetëse për t'u ngritur. U përpoq të ngrihej dhe qëndroi më këmbë. I mbështetur me një-rën dorë në pushkë, tjetrën e mblodhi grusht në ballë e u nguros për disa minuta pa i luajtur asnjë muskul me vështrim aty ku duhej të ishin kokat e shokëve të varrosur, mbuluar me shaminë e tij të kuqe që e kishte mbajtur kaq kohë pas qafe. Kishte lënë diçka të tijën tek ata e kishte marrë me vete diçka të tyren.

Ç'tha e ç'mendoj me vete në ato minuta nde-rimi të heshtur? Përse iu zotua shokëve të mirë? Një ide ishte në qendër të çdo mendimi e zotimi, të bënte gjithçka, edhe të pamundurën, veç të arrinte gjallë diku, të takonte patjetër shokë e t'u tregonte ç'kishte ndodhur. Shokët do ta kuptonin e do t'u vinin në ndihmë atyre të stanit. Vetëm kaq.

\*  
\*   \*  
\*

Pasi mori këtë vendim, e pa me vend të shkonte drejt fshatit Shtyllë. Në fshatrat e tjera më të afërta ishte i sigurt që do të haste në gjermanë.

E rrëmbeu pushkën e gjatë me të dyja duart, u mbështet mbi të dhe e tërhoqi me mundim së pari një-rën këmbë, pastaj edhe tjetrën. Dhembja qe shumë e madhe.

— Ooohoop! — ia bëri për të mposhtur dhembjen.

Bëri disa hapa të mundimshme. I jepte zemër mendimi së shpejt a vonë plagët do t'i nxeheshin, atëherë nuk do t'i ndiente kaq shumë dhembjet e do të mund të ecte më lirshëm. Duke u nisur nga kjo, sa po e mbështette këmbën në tokë, rëndonte

ngadalë po me këmbëngulje mbi të dhe, kur ia arrinte të rëndonte plotësisht, psherëtinte i lehtësuar.

Ky ushtrim i një vështirësie lënduese vijoi më se gjysmë ore. Në fillim iu nxehe trupi e djersiti. Panoja qëndroi e fshiu djersët me mëngë. Ktheu kokën prapa. Kishte bërë a s'kishte bërë nja dyqind hapa. Ai u dëshpërua. Me gjithë atë mundim, kaq kohë e prapë në vend? Të çuditshme ishin edhe ato gjurmët e tij dredha-dredha, që e kishin nxjerrë dëborën anash e kishin zbuluar tokën e zezë aty-këtu. Gjurmët zinin fill atje tek nxinte dheu, te varri i përbashkët i shokëve. Kjo udhë e mundimshme, porosi e shokëve të porsavarrosur qe? Sigurisht!

Panoja iu rivu udhëtimit. Ecte drejt një gryke mali përkundrejt Ostrovicës. Shtylla që aty s'mbante më shumë se dy orë. E kishte bërë dy a tri herë këtë udhë. Në mot të mirë e të keq. Nuk mbante më shumë, jo. Veçse, me këtë farë udhëtimi që bënte ai, natyrisht për dy orë s'arrinte dot. Po le ta bënte për tri, katër, megjithëse, kur t'i nxeheshin këmbët... Sa t'i nxeheshin plagët! Pastaj do të ecte shpejt. Dhe s'do të ndalej asnjëherë, aspak e asgjëkundi, derisa të arrinte në Shtyllë. Shtylla qe bazë e partizanëve, ai vetë njihje atje disa familje ku kishte bujtur e ishte kënaqur së tepërmi. Vetëm sa t'i nxeheshin këmbët!

Njeriu kurrë nuk i parashikonte dot plotësisht vështirësitë e një veprimi që ndërmerr. Zakonisht i përfytyron më të mëdha a më të vogla nga sa janë në të vërtetë. Sipas moshës e karakterit. Panoja ishte nëntëmbëdhjetë vjeç djalë dhe vështirësitë që parashikonte ai ishin larg së vërtetës, ishin shumë më të vogla. Po njeriu nuk i parasheh dot tërësisht as qëndruesën e forcat e veta. Edhe kjo ka të bëjë me ka-

rakterin e moshën e tij, ca më tepër me moshën. Panoja ishte djalë në vaktit, ai kishte rezerva forcash, më tepër nga vështirësitë e paparashikuara.

Më në fund dikur vërtet plagët iu nxehën. Panoja u habit së tepërmi kur vuri re se po ecte me goxha hap, ndërsa pushkën e gjatë të Selmanit e mbante shtrënguar me të dyja duart përpara pa e mbështetur në tokë, po në gatishmëri mbështetëse në rast nevoje. Kjo kishte qenë një masë mbrojtëse e vetvetishme. Ai pas kësaj u habit më tepër me një gjë tjetër: Ç'ishte, ku ishte, ku vente e si vente? Tani që trupi i ishte kthyer në gjendje të zakonshme, për të qe krejt e pazakontë, e habitshme dhe e frikshme pikërisht kjo vetmi e plotë. Si për të parën herë e papritur u kujtua që një ditë më parë Selmani, Vata, ai dhe tërë brigada ishin së bashkë në Moglicë. Pastaj iu kujtuan ura, tërheqja, fshati pllakosur nga gjermanët, lufta me ta, vrasja e shokëve, stani, Lena... A vërtet kishin ndodhur të gjithë këto brenda njëzet e katër orëve? Njëzet e katër orë? Çudi! Koha ecën shumë ngadalë, shumë më ngadalë se ngjarjet! Ç'ngjarje! Brenda një kohe kaq të shkurtër! Çudi!

Dhe mbi tërë këto ngjarje, ideja-porosi: Të tregonte ç'kishte ndodhur!

Kjo ide-porosi i mposhti mendimet e tij, i kthjelloi e u dha forcë.

«Po të rri kështu, do të më ftohen plagët përsëri e rrezik të mos vete dot në Shtyllë», tha e u nis me nxitim, natyrisht aq sa mund të nxitonte në atë gjendje që ishte.

Mandej gjykimi i tij u mpreh edhe më.

«Me kaq nxitim, vallë më arrijnë forcat. Dhe në më shtershin ato... Kujdes, Pano! S'ke të bësh vetëm me veten tënde. Po të qe për veten tënde...»

Ai fliste me vete. Kjo gjë i sillte kënaqësi, kënaqësinë e të gjallit, që flet e dëgjon. Po, po, fliste e dëgjonte! I dukej se kështu këmbente mendimet me dikë për të gjetur zgjidhjen më të drejtë.

Nëntëmbëdhjetë vjeç, djalë i shëndoshë fshatar, ishte i fortë, më të fortë e bëri mbetja vetëm e sidomos vendimi për të arritur me çdo kusht në Shtyllë. Urinë s'e ndiente thujse fare. Tanimë i bëhej se qe çmësuar me të ngrënë. Që kur s'kishte ngrënë? Një vit? Një muaj? S'mbahej mend! Dale... buka e ngrohtë e misrit! Një mbrëmje më parë, mbrëmjen e djeshme! Hej, ç'të ngatërruar që i bënte kohës! Kur e kishin ndarë atë bukë misri të ngrohtë, me ta qe edhe Lena. Lena s'kishte pranuar. «Merreni ju, ju do të çani natën e dëborën.»

Panos iu përtëri në kujtesë tërë rruga tek e mbante për krahu shoqen e plagosur. Ajo kishte dhembje, megjithatë e mbante veten, asnjëherë s'ishte ankuar, rënkonte lehtë si në të psherëtirë. Panoja i kishte thënë se do të takoheshin, patjetër do të takoheshin...

«Patjetër, po!»

Nuk duhej të kishte folur. Tërë përfytyrimet e këndshme të së kaluarës e të së ardhshmes u shuan aty për aty si të qenë flluska sapuni. Ç'qenë këto mendime të krisura në një kohë kaq të papërshtatshme? A ishte a s'ishte në vete ai? Pas tërë këtyre ndodhive, pasi kishte varrosur me duart e tij dy shokët që ishin vrrarë për të... A e kishte kokën mbi shpatulla, apo mos i kishte luajtur? Këtej e tutje jeta e tij s'do të qe e kuptimshme e me dobi veçse për një gjë: Të kryente detyrën që shokët së bashku me të, e kishin lënë në mes jo për faj të tyre.

U lodh. Qëndroi për të fshirë ballin e për t'u



mbushur me frymë. Po afronte muzgu i mbrëmjes. Tani nuk e shembëllente dot vendin. Ndoshta ishte afër Shtyllës. Ndoshta larg.

Shtrëngonte dhëmbët e çante më tej. Njërën këmbë e ndiente më të lehtë. Kur shkellte mbi të, ndiente një farë lehtësimi në trup, kur e lëshonte tjetrën, i dukej sikur i fundosej në dëborë e i rëndohej ajo e trupi i tërë. Dhe hiqte keq për ta shkukur e për ta ngritur përsëri.

Befas Panoja dalloi se po ecte tatëpjetë. U gëzua si fëmijë e i qeshi vetes. Meqë po ecte tatëpjetë, Shtylla s'qe larg. Ja, sikur kishte arritur. Do të arrinte së shpejti. Aty mbaronin detyra, mundimi. Përfytyrimi i tij i mirëfilltë për të ardhshmen s'shkonte më tej.

Bindjen e Panos e përforcoi një lehje qeni. Lehja qe e mprehtë e humbi sapo u dëgjua. Panoja mbajti vesh, mirëpo ajo nuk u përsërit. E kishte përpirë bardhësia e mugët, apo i kishin bërë veshët? Nuk qe e mundur. Panoja njihte mirë lehjen e qenit. Qe larg, me ta dëgjuar, veshi i tij e regjistronte atë lloj zëri dhe përcaktonte me saktësi ku ndodhej tufa.

Lehje apo pandehmë lehjeje. Sidoqoftë, Panos iu ngroh zemra e iu shtuan forcat e shpresat. Eci më shpejt, madje vrapoi. Atij ashtu i dukej.

Më në fund Panoja mbajti këmbët, mbasi nuhati erën e tymit.

— S'duhet të qëndroj, se më ftohen plagët. Do të qe qesharake të vija deri këtu e të mbetesh një-qind çapa larg fshatit. Se, në mbetsh këtu, askush nuk dëgjon, sado të thërresësh.

I da edhe një herë forcë vetes e eci nxitimthi.

Ja shtëpitë e para prej guri të Shtyllës! Kapelat e bardha të çative, strehët e tyre me hijet e zeza, krongjijtë e akullit e fjollat e tymit mbi oxhak...

Një aromë e njohur, e dashur. Më në fund!

Panoja provoi një gëzim të madh që ia përshtoi tërë trupin, i erdhi të thërriste me sa fuqi kishte. Le ta merrnin vesh të gjithë se ai kishte arritur atje pas aq mundimesh! Si rrinin kaq të qetë njerëzit, kur për të ishin vrarë dy shokë e ai i kishte mbuluar vetë, pa njeri fare, diku në mes të dëborës! Ai vetë as atëherë e as më vonë, nuk qe në gjendje të shpjegonte se si e kishte mbajtur veten pa bërë këtë veprim naiv, që atëherë i dukej me shumë rëndësi! Kjo qe një rastësi, e cila, siç do ta shohim, e shpëtoi pa rënë rob.

— Te Ferhati do të mbahem! — tha e u nis.

Fshati ishte fare i shkretë në dukje të parë. Ai u habit nga kjo kur, si një rrufe në qiell të kulluar, ia grisi dëgjimin një thirrje që e rrëqethi. Mos i bënë veshët?

— Alt! — u përsërit thirrja neveritëse.

Kështu na qenka!

Panoja shtrëngoi pushkën gati për të qëlluar. Ai vendosi që, nëse i thërrisnin përsëri, të mos e zgjatte më. Megë ky «alt» i mallëkuar s'po i ndahëj, s'kishte si të bënte ndryshe.

Ndërkaq vijoi të ecte. Në vend të thirrjes që priste, dëgjoi një të qeshur me të madhe. pastaj një të qeshur të dytë çjerrëse dhe ca fjalë gjermanisht midis të qeshurave.

Vijoi të ecte me nerva të tendosura. Askush s'e ndali. Askush s'e qëlloi. Panoja nxitoi sa mundi e si mundi. Doli nga fshati pa e ndërprerë aspak të ecuren e nxituar. Një psherëtimë lehtësuese i doli vetiu kur pa përpara një shkëmb. Shkëmbi kishte goxha strehë, e cila nxinte. Panoja dëgjoi zëra, zhurma hapash. Pa e bërë të gjatë, kësaj here u fut në strehën

e shkëmbit dhe drejtoi pushkën andej nga vinin zërat. Hoqi nga krahu automatikun dhe e vuri pranë vetes në gatishmëri luftimi. Tani, po, ai ishte plotësisht gati. Shkëmbi ia mbronnte shpinën, përpara mbrohej vetë, i gjallë s'do të binte në duar të tyre. Kurrë! Meqë do të luftonte, le të luftonte si trim e të vritej si trim.

Eh, sikur ta dinte tani ai Ferhati që Panoja ishte kaq pranë! Si do të vraponte ai çamarrok për t'i ardhur në ndihmë! Ferhati do të gëzohej kur ta shihte. Edhe Panoja do të gëzohej, do të gëzohej shumë. Se e donte atë djalë. Pa do t'i tregonte atë që ishte bërë qëllimi kryesor i jetës për të. Më pas le të bëhej ç'të bëhej. Ai do të ndihej i lehtësuar, i shkarkuar.

Cilido fshatar nga Shtylla, po ta dinte, do të vraponte tek ai, te një partizan i plagosur.

Ferhati do t'i sillte edhe një tas me qumësht të ngrohtë... Oh, qumësht i ngrohtë? Panoja u gëlltit. Po shpejt u kujtua se s'ishte koha e as mundësitë për dëshira të tilla të marra. Tani kishte tjetër hall. Ai ishte pothuaj i dëshpëruar që i kishte dalë përpara një vështirësi, e cila ndoshta do ta pengonte për të realizuar pikësynimin aq të dëshiruar t'u vinte në kohë ndihma atyre që ishin në malin vezë nga dëborra... të dihej ku kishin rënë e ishin varrosur dy shokët martirë...

Minutat kalonin. Gjermanët venin e vinin në fshat, po Panon s'e nganë. S'i kishte ndodhur kështu? Panoja tanimë i njihte zakonet e gjermanëve dhe për të qe e pakonceptueshme që, pasi e patën diktuar, s'po e ndiqnin më.

Lëvizje kishte, por asnjë potere. Në këtë mugëtirë të diktuarit e një partizani në fshat do të shkaktonte panik e rrëmujë. Patjetër! Kurse këta...

Edhe lëvizjet pushuan. Me sa duket ndonjë reparat i vonuar kishte hyrë në fshat.

Ç'bëhej kështu? Kudo gjermanë?

Panos iu kujtua se kishte dëgjuar nga komisar i një sqarim të situatës se gjermanët kishin nisur një operacion të madh me shumë bujë. Meqë kishin marrë malet në ndjekje të partizanëve, fshatrat e fushës mund të ishin lehtësuar disi. Edhe fshati i tij. Që atje edhe fshati më i afërt i fushës që shumë larg. Ç'bëhej vallë tani në fshatin e tij? Po me një-rëzit e tij? A mund ta merrnin dot me mend ata se ku ishte ai e në ç'gjendje ishte?

Panos i iku ai tensioni i çasteve të mëparshme. Tani e kuptoi që askush s'e kishte parë, askush s'e kishte ndjekur. Po si kështu?!

Një krismë! Pas saj një angullimë vajtuese që të rrëqethte. Gjithçka e qartë: gjermanët e dehur dë-frenin me qenin. Panoja u drodh; po ta kishin parë, me të ata nuk do të mjaftoheshin me një «alt» e me një krismë, por..., dhe u drodh përsëri.

U çlirua nga këto mendime e zemra i rrahu qetë-qetë. Madje një copë herë ai e pa veten aq të nge-shëm, saqë e dëgjoi edhe zemrën e vet si rrihte.

— E fortë dhe e papërtuar — tha për të.

Tani që ishte qetësuar, ndjeu aromë kakërdhie dhe e mori me mend se ajo strehë shkëmbi ishte vend ku mërzenite bagëtia. Toka ishte e thatë. Një vend i tillë është gjithnjë i ngrohtë.

«Shkëmbi të mbron edhe nga të nxehtët, edhe nga të ftohtët, edhe nga armiku», tha me vete Panoja.

Ai mendoi përsëri për Ferhatin e për fshatarët. Mendimet e tij s'kishin të sosur. U struk edhe më në pluhurin e thatë e pas pak u kot në gjumë.

Pa shumë ëndrra. Selmani, rojë në njërën anë të shkëmbit e Vata në tjetrën. Panoja hapi njërin sy. «Fli, fli, mos u mërzit», tha Selmani, duke e mbushur çibukun me duhan. «A duket gjë, o Vatë? Jo, thua? E po mirë!» Vata fishkëllen lehtë e ëmbël: «Po na vjen, po na vjen» dhe atje tej Lena e qeshur së bashku me dy shokët e plagosur. «Pse, ç'kujtonit ju? Ja tek jemi, gjallë e shëndoshë!» Po ky, skuadërkomandant Nafizi? «Ç'u bëtë? Na e ngritë gjakun, o të shkretën!» thotë e puth e puth të gjithë me radhë, ndërsa Vata s'pushon së fishkëllyeri «Po na vjen, po na vjen»... Më tej i bëhet se kalon një përrua zhurmëmadh me ujë të shumtë e të rrëmbyer. Panoja shket në një gur të lëmuar nga akulli e bie. I lagen këmbët, i laget kurrizi e i shkojnë mornica të ftohta nëpër trup. Guri i akullt befas rritet e rritet. «Gur a gjerman ky, xhanëm? Ç'është, ç'është?» Fishkëllima e Vatës largohet, largohet..

Panoja u zgjua e sërish ndjeu zhurmë e hapa. U shtriq e lëvizi krahët e belin. I kishte hyrë të ftohtët. Po kjo qe e keqja më e vogël. Pranë tij dikush po vinte duke dihatur. Jo një, po disa. Panoja mbajti frymën e vuri gishtin në këmbëzën e pushkës. Zhurma e hapave bëhej më e madhe, më e afërt. Një hije u dha para shkëmbit. Panoja e tërhoqi këmbëzën deri në mes e ndali disi i trembur. Po sikur të qe ndonjë fshatar?

«Do të pres. Në dhëntë shenjë se është gjerman a ballist, kam për ta marrë vesh më parë se të më diktojë ai mua.»

Pritja nuk qe e gjatë. Panoja kuptoi se ishte duke kaluar një grup gjermanësh. Kushedi ku shkonin ose kushedi që nga ktheheshin për ta kaluar natën në Shtyllë. Shkonin mu rrëzë shkëmbit.

Atje qenkësh rruga, xhanëm? Panoja qëndronte pezull. Lëvizja më e vogël, madje edhe frymëmarrja e shkujdesur mund ta zbulonte padashur. Një gjerman shkau e u mbështet te shkëmbi. Gryka e pushkës së Panos mend e çiku në kokë gjermanin e rrëzuar. Panos i rrahu zemra me shpejtësi.

Ai që në gatishmëri të plotë. Ishte përgatitur shpirtërisht për t'u ndeshur. Do të vritej, kjo s'kishte dyshim, vetëm të mos jepej shpejt, para se ata të paguanin shtrenjt për të e për shokët e tij. Me këtë mendim u familjarizua lehtë e menjëherë. Vrasjes s'i druhej e s'i trembej aspak dhe për të s'mendonte më. Këtej e tutje do ta mundonte frika se mos e kapnin, se mos binte i gjallë në duart e tyre të fëlliqura.

Kur rreziku u bë i madh, brenda disa sekondash i kaloi si në film tërë jeta e tij, krejt e gjallë e me shumë hollësi. Fytyra të afërmish, shokë, partizanë, të gjallë e të vrarë, ndodhi nga më të ndryshmet, njerëz e hollësira që me qëllim ndoshta kurrë nuk do t'i kishte sjellë ndër mend, sado që të mundohej. I kishte thënë një shok, dhe vetëm tani e besonte, që ëndrra më e gjatë zgjat vetëm disa sekonda. Pikërisht kështu.

Rreziku u largua përkohësisht, ashtu sikurse kishte ardhur.

Kur hapat e gjermanit të fundit po shuheshin, Panoja e lëshoi frymën dallgë-dallgë. Ziente nga inati. T'i urresh sa më s'i bëhet, t'i shohësh mu nën hundë, të kesh dëshirë t'i shuash nga faqja e dheut e megjithatë të heshtësh! Ky është kulmi i durimit! Ah, sikur të mos që ajo detyra që i kishte vënë vetes! Sikur të mos që i plagosur! Do të bënte një gjurulldi që t'ua sillte festen verdallë, maskarenjve!



Prova që sapo kaloi, e bëri të mendohej seriozisht për veprimet e mëtejshme. Për të hyrë në fshat, as që mund të mendohej. As për të takuar ndonjë fshatar. Të rrinte atje, ishte rrezik të diktohej me të hapur dita. Le që gjersa të hapej dita, nuk qe e mundur të qëndronte. Që tani dridhej së ftohti, këmbët s'i ndiente fare si të tijat.

«Duhet të shkoj sa s'është vonë. Ku? Nga të marr? Gjergjevicë-Vinçan? Vithkuq? Më afër është Vithkuqi!»

Rrugën e dinte mirë. Shkohej poshtë, kjo ishte rruga e rrahur e më e shkurtër. Shkohej edhe nga livadhet. Në rrugën e rrahur e të shkurtër mund të kalonin armiqtë, nga livadhet duhej kaluar përpjetë një pylli. Në një anë gjermanët, në tjetrën vështirësitë e natyrës e të vendit, ndoshta edhe të pakapërcyeshme. Njeriu ynë gjeti më të mirë rrugën e livadheve.

Me pushkën në dorë e automatikun në krah eci gjunjazi, derisa zbriti poshtë në udhën e rrahur. Atje ndenji pak në përgjim. Mugëtirë dhe heshtje.

«Kujt i shkon mendja se unë, partizani Pano, ndodhem këtu, mu nën hundën e gjermanëve? Askujt, sigurisht askujt. Ndërsa unë e di ku janë. Në Shtyllë sonte ka dy kategori njerëzish. Të dyja palët do të gëzoheshin ta dinin se unë jam këtu. Po sa i kundërt ky gëzim te të dyja palët!... Sido, shtyllarakët e kanë pisk me gjermanin në derë!»

Ishte një gjë e habitshme për të të përfytyronte Shtyllën, fshat krejt i lidhur me Lëvizjen, të ciaste nga gjermanët në këtë mbrëmje dhjetori. Panos i dukej sikur kjo qe një ëndërr e aq.

Poshtë, në rrugën e rrahur nga gjermanët, Panoja provoi të ushtrohej sërish për t'i nxehur këmbët. U mbështet me të dyja duart në pushkën e gjatë të Selmanit, ashtu si kishte bërë më parë. Ndjeu vetëm një dhëmbje therëse, po këmba s'i preku gjëkund. Këmbët, veçanërisht të majtën, i kishte të rënda si kërcunj, dhe të pavolitshme, si të pushtuara nga cërrma. Përpjekja e stërmundimshme s'po sillte dobi. Ai më tepër ecte me duar që zgjateshin nëpërmjet pushkës ku mbështeteshin e shtrëngoheshin me tërë peshën e trupit. Po kjo lloj ecjeje e lodhi shpejt. Provoi prapë të mbështette trupin mbi këmbët e tij, një herë dy, ato s'e mbanin peshën, ishin si të huaja e s'i bindeshin fare.

«Ç'gjëra të çuditshme i ndodhin njeriut në luftë! tha me vete Panoja. Janë a s'janë këmbët e mia këto?»

I vinte inat që s'i bindeshin. Gati po e linin shpresat se mund të ecte më tutje. A vihej në Vithkuq me ato këmbë — kërcunj që s'i bindeshin? Pofrika se do të agonte e atëherë do të diktohej e do të binte rob te gjermanët e urryer, ia përtëriu forcat e këmbënguljen dhe mori një vendim prej kokëkrisuri: Do të ecte gjunjazi, këmbadorazi. Vetëm sa më parë e sa më shpejt. Në mëngjes duhej të arrinte Vithkuqin. Ndryshe që i humbur. Sa të hapej dita, do të dukej si një udhërrëfyese vazhda që ai do të linte në dëborë.

Duke e parë çështjen me logjikën e luftës, arriti në përfundimin se në Vithkuq s'duhej të kishte gjermanë. Meqë kishin zënë Shtyllën, s'kishte pse të gjendeshin në Vithkuq. Shumë shumë atje mund të ndodhej ndonjë repart, i cili, me t'u hapur dita, do të nisej udhës së rrahur për në Shtyllë. Ishte e qartë:



që gjermanët do të shkonin edhe më thellë në malësi, ashtu si e patën shpallur qysh në fillim të Operacionit. Pra, për çdo të papritur, i duhej mënjanoar udhës së përdorshme e në Vithkuq të vinte që sipër në mugëtirën e sabahut.

Me të thënë e me të bërë. U nis gjunjazi duke i hapur shalët sa mundte. Këmbët pas, gjithë si kërcunj. Minutat e parë të këtij udhëtimi gjunjazi ishin të lodhshme e të pavolitshme. Ndodhej te përroi i Shtyllës. Përroi kishte zënë akull. Ky ishte një akull i hollë, që, me goditjen e parë të qytës së pushkës, u ça tejmatanë.

— Edhe kjo duhet, të lagem këtu tani. Në qoftë se futem në ujë gjunjazi, do të ngrij e s'do të eci dot as edhe një kilometër të vetëm. Kurse për në Vithkuq rruga është disa kilometra. Të paktën këtu të më hyjnë në punë këmbët. Ato s'ndiejnë që s'ndiejnë.

Duke u mbështetur në pushkë, Panoja u përpoq të ngrihej më këmbë e të kapërcente përroin. Prova qe fare e pasigurt.

— Ç'do të bie i tëri në ujë! — tha i dëshpëruar. — Të kisha dy pushkë si kjo, po, mbase edhe mund të kaloja si me paterica.

Në të keq njeriu gjen mënyra e mjete aspak të përfillshme në gjendje normale. Sa i shkoi mendja te patericat, ai këputi një degë shelgu dhe e bëri sa gjatësia e pushkës. Me mbështetje të dyanshme në këto mjete kaq të kundërta midis tyre, jo vetëm që e kapërceu përroin, po bëri edhe nja dyqind metra udhë. Tek e përpyeta e pyllit kjo mënyrë s'pinte më ujë. Tërheqja osh e këmbëve në pyll s'qe e mundur. Panoja u lodh dhe e hodhi shkopin për të vijuar rishtazi më gjunjë. Po sa ngadalë, sa ngadalë!

— Ky është hap breshke! — qesëndisi veten.

Pylli sa vinte dendësohej. Aty dëbora ishte e imtë e kishte zënë vend më mirë, në një trashësi më të madhe se gjetkë. Gjunjazi s'ceej më. Panoja tanimë kishte dhembje në të dyja këmbët e munduara. Vetëm se dhembjet tanimë po i bëheshin një gjë e zakonshme, e rëndomtë. Ai po mësohej edhe me to e u bënte ballë. Të mos i kishte kaq të rënda këmbët e si të huaja! Le t'i dhembnin, por, ama, t'i hynin në punë! Jo t'i mbante edhe ato në kurriz!

Është e çuditshme, por edhe e vërtetë: Panoja bënte shaka me veten e tij. Ecte disa hapa, ndalej për t'u mbushur me frymë. Qëndronte aq sa zemra ta ngadalësonte vrapin, që ia pengonte frymëmarrjen. Atë kohë gjente rastin të fliste me vete, të mendohej a të bënte shaka.

Diku rrëshqiti. Vetiu zgjati dorën e lirë e u kap në një ahishtë. Mbeti ashtu si i varur. E kaloi rripin e pushkës në krah dhe zgjati dorën tjetër, i mblodhi krahët, e tërhoqi trupin përpara e doli nga gropa.

— Pa shih, edhe kështu u ecka! — tha.

Duke kapur herë një ahishtë e herë një tjetër, hë këtu e hë atje, me të gjithë mënyrat e mjetet që i hynin në punë, aty nga mesi i natës iu ngjiti pyllit. Këtej e tutje në çdo dy-tri hapa çlodhej. Çlodhjet po bëheshin gjithnjë më të gjata, kurse hapat e përshkuar më të shkurtër.

«Kurajë, Pano! Hë, sa të dalësh te livadhet! Pastaj është rrafshirë e më tepër tatëpjetë. Të përpjetën tani e hëngrel!» i jepte zemër vetes.

Kurrë s'e shkoi ndër mend se mund të mbetej. Pikën më të largët të dyshimit e fundoste thellë në vete. Gjersa kishte arritur që nga rrëza e Ostrovicës deri këtu, që këtu e në Vithkuq do të vinte si vdekja. Shkundej dëbora nga ahishtat e i binte në qafë, i

hynte në mëngët kur zvaritej, ai e pastronte me kujdes dhe mjaftohej me një të sharë.

— Mirë që është edhe kjo mugëtira. Të qe nata me hënë, do të isha bërë kallkan!

Tani s'bënte dot pa folur me vete. Fliste e mban-te vesh për të dëgjuar. Zëri ishte si një qenie e dytë pranë tij, një provë e të qenit gjallë. Në një farë vendi i ngrinë duart. Ai i huhati për një copë herë. Pastaj i fërkoj me njëra-tjetrën, mbështeti bërrylat në dëborë e i fërkoj edhe pas fytyrës së ngrohtë. Fytyrën e kishte të djersitur e të nxehtë. Në fillim pati një të ftohtë drithërues, pastaj fresk e rehat. Duart e përcollën të ftohtët në fytyrën e nxehur, morën prej saj të nxehtët e tepërt e u ngrohën edhe ato.

Akoma qe plotësisht në vete, kur ndjeu të ftohtë në gjunjët. E mori me mend se pantallonat ishin grisur nga fërkimi.

— Gjunjët s'janë për të ecur, ashtu sikurse pantallonat s'janë këpucë, po ç'ti bësh — tha, qeshi e psherëtiu thellë.

Forcat po i pakësoheshin, po guximi e besimi jo, as humori.

Kur shkau e u gremis një herë tjetër, dhembja e mëparshme e këmbëve iu përsërit e shumëfishuar dhe i ra të fikët. Mirë që të fikëtit nuk zgjati shumë.

— Gjallë jam. Ku jam, në tokë a në varr? — tha duke zgurdulluar sytë, derisa e kuptoi ç'kishte ngjarë. — Mirë, pra, këtej e tutje u dashka ca më tepër kujdes. Do të kem kujdes, ç'të bëj tjetër!

Panoja nuk e kishte në natyrë të kujdesurit. Trim i çartur, me forcën e një djali të shëndetshëm fshati, ai s'e përfillte fare kujdesin, veçanërisht për

trupin e tij. Ndaj i dukej se tani po bënte një lëshim duke u treguar i kujdesshëm.

Mirëpo dora-dorës po e linin forcat, i shtoheshin dhembjet. I dhembnin e i digjin hidhur edhe gju-njët. Panoja psherëtiu përsëri e kjo tregonte se e kishte pisk.

— Eh, ç'm'u qep ky të fikëtit si dreqi! Po duhet të arrij se s'bën!

Tani trembej, sepse, duke qenë shpesh me ndjenja të humbura, mund të binte rob. Kjo frikë po bëhej preokupimi i tij kryesor dhe pikë mbështetëse e përtëritjes së forcave.

Më pas s'merrte vesh kur udhëtonte e kur flinte, ku udhëtonte e si. Zvaritej pa pushim me përdredhje të sforcuara, binte më gjunjë a i binte të fikët, vinte në vete dhe përsëri zvaritej. Këto forma të gjendjes së trupit të tij ishin në luftë ndërmjet tyre e s'i linin shumë kohë njëra-tjetrës. Midis tyre forma e vetme e vetëdijshme ishte zvaritja. Tërë aftësitë mendore e fizike të atij trupi të përçudnuar ishin përqëndruar krejt te zvaritja.

Hera-herës kërcenin para tij bisha të pyllit, ujç, dhelpira, shpesh edhe njerëz. Këto ishin përfytyrime jashtëzakonisht të ndezura.

Ecën, zvaritet rishtazi. Përfytyrimi dalldisës rikthehet.

Dikush i rri përballë dhe e shikon me dashuri. Dhimitri ky? Komandanti i tij i kompanisë? Ai i tëri! Dhimitri qesh, qesh. Një kënaqësi e madhe në atë të qeshur. Ia ngroh zemrën Panos kjo e qeshur, ia shkrin trupin ngadalë, ëmbëlsisht. Gjersa Dhimitri qesh kësisoj, s'ka asnjë rrezik, asnjë të keqe. Panoja qorton veten që rri si guak shtrirë, ndërsa komandanti, me të cilin ka kohë që s'është takuar, është aty, e shi-

kon e qesh. Bën të ngrihet, po këmbët ia ka zënë një shkëmb i rëndë e ai s'leviz dot të çohet e ta përqafojë komandantin.

«Pano, shko! Të urdhëroj!» thotë komandanti dhe vetë largohet, largohet gjithë duke qeshur krenar.

Panoja hap sytë se i bëhet që s'e kuptoi mirë për çfarë e urdhëroi.

— Ah, ah! Po, pikërisht kështu më tha atëherë!

Vërtet kështu i kishte thënë Dhimitri, kur u nis për të kryer një mision me rëndësi që i kushtoi jetën. Panoja deshi të vinte me të, po komandanti përdori të drejtën e tij dhe s'e la. Që atë ditë nuk e pa më.

«Duhet të eci, të eci!»

Dhe zvaritet në një gjendje të habitshme. Ku është e vërteta e ku përfytyrimi? Zor se ka një kufi të caktuar. A është a s'është gjallë? Çudi, vazhdon të zvaritet! Në çastet e shkurtra, të qartësisë mendore truri i punon intensivisht.

— Vetëm mos më hidhet ndokush përsipër befasisht!

Shikon rreth e rrotull. Asnjë frymë gjallëse.

Për një çast e përfytyron veten rob, rrethuar nga gjermanët, përmes qytetit, duarlidhur.

«Ç'është, ç'ka ngjarë?» pyesin njerëzit.

«E kanë zënë rob Panon!»

«Mos, moj! Po si bëri kështu? Pupu, turp të ketë, ka rënë rob, ditëziu!»

«Rob im bir? S'është e vërtetë!»

Babai i tij ky! Ai, babaxhani i tij. Si u mburrej fshatarëve për Panon! Se Panoja kishte bërë ca akcione e trimëri me njësitin e fshatit edhe pa dalë në mal partizan.

Më tej kujtime vegjëlie. Pastaj kujtime lufte.

Shokë, partizanë, të gjallë e të rënë, Lena... ç'u bë  
Lena, vallë? Sa larg mbeti! Po shokët e stanit?

— Vatë! Selman!

Thirri me zë, psherëtiu i vrarë në shpirt.

A nuk do të qe më mirë ta kishin zënë vendshe  
ata plumbat e mallëkuar? Shokët do të ishin gjallë,  
ai vetë s'kishte për të hequr gjithë këto sfili. Kurse  
tani? Vetëm të mos binte rob!

Prapë në kllapi e prapë përfytyrime. «Sahan me  
petka ky? Ç'avull që lëshon! Lugë? Jo, or vëlla, s'ka  
ç'duhet luga! Plastë ai që ka aq durim!» E rrëmbeu  
sahanin, petkat derdhen lumë në gojë, provon shijen  
e tyre, shije gruri e vezë, e ngrohin, po poshtë asgjë  
s'kapërdihet. I bëhet se e ka gurmazin të çarë e ato  
rrjedhin e bien në tokë, s'venë në stomak. Trembet  
e hap sytë. Egërsi, dëborë e natë dimri, mugëtirë e  
vetmi e padurueshme, dhembje e uri. Mezi gëlltitet,  
sikur i është tharë pështyma.

Sa shpejt ndërrohet gjendja e trupit dhe e trurit  
të tij! Sekonda ndan dy jetë. Zvaritet.

Përsëri përfytyrim? Kllapi? S'është e mundur!  
Dy qenie si njerëz vijnë drejt tij. Njerëz vërtet? Fla-  
sin. Ai s'e ndërpret të zvariturën me spërdredhje e  
sforcim, që tanimë është kthyer gati në refleks. Qe-  
niet si njerëz i tërheqin vëmendjen njëri-tjetrit e  
qëndrojnë.

— Ndal! — thirri njëri.

Panoja hapi gojën e u ndeh për të parë e për të  
dëgjuar më mirë.

«Ndal, thotë? Ama s'më kapi në befasi?»

Dale... sikur ka zhgabonjë. E pa apo dëgjoi pa-  
rullën e tyre? Panoja çapëleu sytë e pickoi veten në  
faqe. S'është aspak në kllapi «Shqipëria e shqiptarë-  
ve...» — dy ballistë përpara!

«U venë shtatë, sigurisht, megjithëse s'do shumë mend për të kuptuar në ç'gjendje jam unë.»

Ja një dëllinjë që e ka shkundur dëborën. Panoja zë vend pas saj. Nxjerr përpara pushkën e gjatë të Selmanit. Si s'e paskësh venë re? Dëborë e akull rreth e përqark, shuli s'lëviz. Ama kujdes paskësh treguar për armët! Kishte vendosur kushedi ku e qëkur që të mos i linte kursesi të dyja armët, edhe se do të mund t'i duheshin, siç e solli rasti tani, por edhe sepse me to ecnin së bashku me të Selmani e Vata, dy të flijuarit për jetën e tij. Kishte gjetur diçka simbolike që e lidhte me shokët nëpërmjet armëve të tyre e s'deshi të ndahej nga ato.

Po automatiku? Panoja e zhvari automatikun e Vatës. Edhe ai njësoj, i veshur fund e krye me akull. E kapi shulin. Duart e tij këto? Të mëdha, të enjtura, të skuqura e të përgjakura. Çudi! Provoi rishtazi me dhëmbë të shtrënguara. Duart i dhëmbin, shuli s'lëvizi aspak.

«Do të më zënë!»

Mjaftoi ky mendim për t'i dhënë qartësi e forca që kurrë s'do t'i kishte marrë me mend në rrethana të tilla. Çastet e rrezikut janë të papërsëritshme. Iu kthjellua truri, kjo që kryesorja. E goditi automatikun në trungun e dëllinjës, rrëzë tokës, atje ku ai ishte më i trashë e më i stabilizuar, një herë, dy. Akulli u shkërmoq në disa vende. Me dhëmbë hoqi copa të tjera, pastaj edhe me dorë çeptoi krongjijtë që e pengonin shulin. Në një lëvizje të dytë të fortë shuli lëvizi.

«Shpëtova!» sa s'thirri.

— Or ti, hidh armët, cilido qofsh! — tha ballisti.

S'u dha përgjigje. Panoja rrinte sy e veshë, me gishtin në këmbëz. Ballisti u ngrit.

— Dorëzohu, të them!

Panoja shkrehu mbi të dhe e pa të palosej. Tjetri u ngrit dhe ia dha vrapit. Panoja qëlloi edhe atë. Në fillim ca rënkime e sharje, pastaj asgjë. Pasi një pushim i gjatë, i heshtur e krejt i pabesë.

Njeriu ynë priti gjatë. Pastaj vijoi punën e tij. Tani zvaritej me shumë kujdes sa më ngadalë e pa zhurmë që të qe e mundur, me të dyja armët gati për zjarr.

Dikur një tjetër figurë përpara. Panoja mori shenjë. Rrëmbeu edhe armën e dytë që ta kishte pranë.

— Dale, bre, je ndër mend ti?

Instiktivisht Panoja qëndroi e priti. Kështu s'mund të të drejtohet, veçse një njeri pa qëllime të këqija.

— Kush je ti?

— Jam një fshatar, ore! Po ti?

— Partizan! — u përgjigj Panoja.

— Si?

— Partizan, të thashë!

— Ashtu, thuaj! Po thirr një çikë, jo sikur flet për vete! Ti je yni!

Panoja priti jo i shkujdesur. Vërtet një fshatar po vinte drejt tij, pa i bërë tërr syri. Qëndroi dy hapa larg dhe e pa Panon gjatë me vëmendje.

— Cili je ti?

— Partizan, të thashë! S'të dëgjokan veshët!

— Po... eh, eh!

Fshatari e mbajti veten e s'i tha përse qe habitur. Panoja shpejtoi e i tregoi sa munda e si munda.



— Mjaft, mjaft, se të dëmton. Më fol më pas, kemi kohë.

Fshatari psherëtiu.

— Me sa më thua e me sa shoh unë, s'më vjen të besoj se je njeri. Ti qenke hero, o vëlla, për besë hero!

Fshatari u ul dhe e mori ndër duar.

— Po gjene mirë që të eci! Le që do t'ia dilje ti. O Vaso! Eja, eja, është yni ky!

Një fshatar tjetër u afrua me të shpejtë.

— Ne u ishim qepur atyre maskarenjve, se kanë një mision me rëndësi për gjermanët. Hë, hë e s'po i arrinim dot. Ti na i pakësove vuajtjet. I jashtëzakonshëm, për nder! Në këtë gjendje dhe ç'të qëlluar! Mirë që të fola me kohë, se ma veshe edhe mua ti! — vazhdonte të fliste i pari.

Panos iu lëshua trupi pjesë-pjesë, ata të dy u shndërruan në avuj bashkë me trupin e tij. Ai i humbi ndjenjat kushedi për të satën herë. Mirëpo tani nuk qe më në gji të natyrës së egërsuar e me rrezikun e bishave naziste mbi kokë.

Pas kaq peripecish, që s'qenë të fundit për të, Panoja, njeriu ynë, kishte rënë te njerëzit tanë.

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Në pranverën e hershme .....	3
Djalë nëne .....	16
Isuf Arapi .....	30
Kumbimi i një krisme .....	44
Një hap i nevojshëm .....	56
Kërcimi teknik .....	72
Bardhësi në ditë të bardha .....	90
Jehonë thellësie .....	101
Duke pritur autobusin .....	111
Plotësimi i kurës .....	118
Para premierës .....	128
Njeriu ynë .....	138